



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Shkencor në
“Teknik Laboratori”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Mjekësisë Tiranë”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Asoc. Dr. Admir JANÇE

2. Prof. Asoc. Dr. Rezarta LALO

Mars/2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Shkencor në “Teknik Laboratori” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Mjekësisë Tiranë”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
2	Njësia bazë që e ofron:	- Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; - Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; - Departamenti i Lëndëve Paraklinike.
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1184, datë 03.12.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	–
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MAS Nr. 51, datë 06.02.2017
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	–
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	–
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	–
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	–
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	7 PAE / 12 PAK v.a. 2023-2024 7 PAE / 12 PAK v.a. 2022-2023 8 PAE / 12 PAK v.a. 2021-2022
18	Numri i studentëve:	39 studentë v.a. 2023-2024 37 studentë v.a. 2022-2023 34 studentë v.a. 2021-2022
19	Komente / të tjera:	–

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Mjekësisë Tiranë është një institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me VKM Nr. 48, më datë 23.01.2013. Ai është ri akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 03, më datë 27.01.2023, për një periudhë prej 6 (gjashtë) vitesh, e cila do të vazhdojë deri më 26.01.2029.

Në vitin akademik 2010-2011, u hap Programi i Ciklit të Dytë të Studimeve, Master i Shkencave në "Teknik Laboratori", i cili ofrohet nga të tre Departamentet pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Licencimi i programit është bërë me Urdhërin e VKM Nr. 1184, më datë 03.12.2009, nga Ministri i Arsimit dhe Sportit. Ky program ka filluar aktivitetin akademik në vitin 2010-2011 dhe aktualisht diplomon brezin e katërmbëdhjetë të studentëve.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Mjekësisë të Tiranës, përgjegjës për këtë program, përbëhet nga tri njësi bazë:

1. "Departamenti Diagnostikës dhe Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristika në Kirurgji dhe Obstetrikë Gjinekologji".
2. "Departamenti i Lëndëve Klinike, Infermieristikës së Përgjithshme, Infermieristikës në Sëmundjet e Brendshme dhe në Kirurgji".
3. "Departamenti i Lëndëve Paraklinike".

Aktualisht, në këtë program studiojnë 76 studentë dhe janë angazhuar rreth 25 pedagogë si personel akademik. Po ashtu, janë në zbatim disa marrëveshje bashkëpunimi.

Programi i studimit Master i Shkencave në "Teknik Laboratori" është organizuar në përputhje me Udhëzimin e MAS dhe VKM 41 të ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të Universitetit të Mjekësisë. Ai ofrohet sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe kërkon 120 kredite për diplomimin. Kohëzgjatja e studimeve është dy vite akademike, në formë me kohë të plotë, dhe përfundimi i tij rezulton me lëshimin e Diplomës së Ciklit të Dytë "Master i Shkencave" në "Teknik Laboratori". Ky program është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe aktet nënligjore përkatëse.

Sipas informacionit nga institucioni, ky program bazohet në shembuj konkretë nga institucione ndërkombëtare, me qëllim kryesor përgatitjen dhe formimin e specialistëve dhe teknikëve të laboratorit, duke ofruar njohuri të avancuara teorike dhe praktike, si dhe përvojën e nevojshme për të shërbyer në qendrat diagnostike në pozicioni "Teknik Laboratori". Gjithashtu studentët e diplomuar në këtë cikël studimi, kanë të drejtën të vazhdojnë më tej kualifikimin e tyre shkencor duke ndjekur Ciklin e Tretë të Studimeve në "Doktoratë".



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm përfaqëson një dokument të hartuar në kuadër të akreditimit të parë të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, që ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.

Vlerësimi filloi me marrjen e dokumentacionit të ofruar nga institucioni dhe ndarjen e punës për përgatitjen e pyetjeve dhe kërkesave për dokumentacion shtesë. Bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ASCAL përzgjedh dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit të Mjekësisë në Tiranë, për të realizuar vizitën në institucion dhe për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm përkatës.

Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, ASCAL përgatiti një agjendë dhe realizoi vizitën më 11-12 Mars 2024. Dy ekspertët e përzgjedhur u shoqëruan nga një specialist i ASCAL. Sipas agjendës, në ditën e parë u zhvilluan takime me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe të Njesisë Bazë, grupin e vlerësimit të brendshëm, anëtarë të stafit akademik dhe studentët. Paralelisht, u vizitua sekretaria mësimore dhe ambientet e Fakultetit, ku u vëzhguan auditorët, laboratorët dhe biblioteka. Kohëzgjatja e takimeve ishte në përputhje me agjendën, pa ndonjë ndryshim.

Në ditën e dytë, grupi i vlerësimit të jashtëm zhvilloi takime me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, duke diskutuar çështje të ndryshme. Pas kësaj, u organizua një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, si dhe me përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe të NJSBC.

Në përfundim të takimeve, grupi i vlerësimit të jashtëm vizitoi edhe bibliotekën qendrore të Universitetit të Mjekësisë. Pas përfundimit të vizitave, si proces të fundit GVI takoi Dekanin e Fakultetit dhe Drejtuesit e Departamenteve dhe eksperti i ASCAL informoi koordinаторin institucional mbi kërkesën për dokumente shtesë.

Pasi shqyrtuan dokumentacionin e dorëzuar, bazuar edhe në takimet e zhvilluara dhe vizitën në ambientet e institucionit, ekspertët hartuan Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Me datë 19.02.2025 GVI dërgoi draft raportin në Universitetin e Mjekësisë Tiranë nëpërmjet sistemit të ASCAL dhe zyrtarisht. Me pas, me datë 04.03.2025, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, nëpërmjet një shkrese drejtuar ASCAL, shprehu dakordësinë e tij me përmbajtjen e draft raportit dhe nuk kishte asnjë koment. Raporti në vijim është forma përfundimtare ku GVI shpreh mendimin e saj në lidhje me këtë program studimi.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Institucioni ofron programin Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” me synim sigurimin e njohurive të thelluara në këtë fushë, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor ose ciklin e dytë Master Profesional në “Teknik Laboratori”. Njohuritë e fituara në këtë program i shërbejnë interesit kombëtar dhe kontribuojnë në fushën e mjekësisë rehabilituese në vend. Programi bazohet në studime të avancuara në diagnostikën laboratorike dhe mjekësinë rehabilituese dhe përmbush objektivat strategjike të Universitetit të Mjekësisë, me fokus të veçantë në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 2: Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” është në përputhje me strategjinë e Institucionit të Universitetit të Mjekësisë si edhe me strategjinë e Njesisë Kryesore duke zbatuar objektivat specifike në lidhje me fushën e studimit të Teknikut Laborant. Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” realizon plotësisht objektivat strategjike të institucionit, të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike si dhe të Departamenteve që e ofrojnë këtë program studimi. Institucioni evidenton, përmes studimeve të tregut të punës, rëndësinë dhe vlerën që ky program ka në përgatitjen e specialistëve të nevojshëm për këtë fushë.

	<i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 2: Rregullore e Universitetit te Mjekesise Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Plani Strategjik i Zhvillimit të UMT përcakton se programet e studimeve janë krijuar për të nxitur zhvillimin ekonomik. Në përputhje me këtë vizion dhe për të përmbushur objektivat strategjike të këtij programi studimi, FSHMT ka prioritet progresiv zhvillimin dhe fuqizimin e studentit. Pas përfundimit me sukses të ciklit të dytë të studimeve, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” dhe aftësohet për të kryer shërbime profesionale të specializuara në teknikat diagnostikuese laboratorike, si në spitale ashtu edhe në ambiente ambulatorie. Gjithashtu, studenti është i përgatitur për punësim në sektorin publik dhe privat, ku kërkohet menaxhimi dhe përdorimi i sistemeve bashkëkohore, duke iu përshtatur teknologjive inovative të kohës. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 34: Pranimet dhe Regjistrimet _UMT</i> <i>Evidencë 107: Manuali i keshillimit te karrieres fshmt</i> <i>Evidencë 136: Praktike per miratimin e kriterëve te pranimi cikli i parë dhe integruar</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare dhe vizionin për arritjen e objektivave strategjike të këtij programi studimi. FSHMT ka si prioritet kryesor zhvillimin e mëtejshëm të studentëve, të cilët, pas përfundimit të ciklit të parë Bachelor në “Teknik Laboratori”, pajisen me diplomën “Master i Shkencave” në “Teknik Laboratori”. Studenti aftësohet për të ofruar shërbime profesionale të specializuara në teknikat diagnostikuese laboratorike, si në ambiente spitalore ashtu edhe ambulatorie, dhe është i përgatitur për punësim në sektorin publik apo privat, aty ku kërkohet menaxhimi

	dhe përdorimi i sistemeve moderne, duke u përshtatur optimalisht me teknologjitë inovative të kohës. Programi Master i Shkencave në "Teknik Laboratori" dhe strategjia e zhvillimit të tij është hartuar në përputhje me ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", duke realizuar vizionin dhe strategjinë e interesat kombëtare si dhe përqasjen globale të zhvillimit kombëtar. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>			
Konkluzione	Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Teknik Laboratori" ofrohet në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe strategjinë e zhvillimit të UMT. Programi bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe në aktet e hartuara dhe miratuara nga UMT dhe FSHMT. GVJ vlerëson se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UMT përfaqëson një Institucion të Arsimit të Lartë të kategorisë universitare licencuar në vitin 2013, duke u shkëputur nga Universiteti Shtetëror i Tiranës (1957). UMT dhe FSHMT deklarojnë se zotërojnë burimet e nevojshme në fushën akademike, veçanërisht për këtë sektor të specializuar në diagnostikën laboratorike. Sipas dokumentacionit të paraqitur dhe pas vizitës së realizuar nga GVJ në institucion, si dhe informacionit të detajuar të mbledhur për këtë program studimi, rezultoi se institucioni disponon kapacitetet mjedisore dhe burimet akademike e administrative të nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi në fushën akademike të teknikëve të laboratorit.

	<i>Evidencë 25: VKM licensimi Msc Teknik laboratory</i> <i>Evidencë 26: Urdher_Emertimi i diplomave_fshmt</i> <i>Evidencë 56: Procedura, afatet dhe dok. per hapjen e programeve te reja, riorganizimin dhe miratimin periodik te planeve</i> <i>Evidencë 77: Vendimi 69, dt.21.09.2017 për Akreditimin Inst. të UMT nga Bordi i Akreditimit + Certifikata</i> <i>Evidencë 82: Raporti vjetor FSHMT 2023</i> <i>Evidencë 95: Tabela e personelit akademik te angazhuar ne MSc 23-24</i> <i>Evidencë 96: CV e personelit akademik</i> <i>Evidencë 118: Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies, Universiteti i Mjekesise, Tirane</i> <i>Evidencë 119: Lista e asetave infrastrukturore te UMT dhe planimetrite</i> <i>Evidencë 187: Vendimi nr.3, date 27.01.2023 i Bordit te Akreditimit, ASCAL</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësise kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Në lidhje me programin e studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, FSHMT thekson se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësise kryesore, përgjegjëse për këtë program. Ky program ofrohet me 120 ECTS për dy vite akademike, dhe pas përfundimit të tij, studentët pajisen me Diplomën Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, e cila korrespondon me nivelin 7 të EQAF ose Kornizën e Kualifikimit të Diplomave (KSHK) dhe është në përputhje me direktivat evropiane, si dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane për profesionet e rregulluara. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në harmoni me fushën akademike dhe kërkimore të UMT, duke synuar të formojë teknikë mjekësorë profesionistë me kompetencë të lartë në njohjen e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe në ruajtjen e sekretit profesional. Teknikët laborant të formuar do të jenë të aftë të njihen me kompetencat e nevojshme për tu punësuar në klinika spitalore, poliklinika, etj. Studentët e diplomuar nga ky program studimi perfeksionohen në minimizimin e gabimeve mjekësore duke rritur cilësinë e shërbimit shëndetësor në gjithë gamën e ekzaminimeve diagnostike. Ata zotërojnë njohuri të mira shëndetësore dhe të higjienës spitalore, gjithashtu kanë njohuritë e duhura mbi teknikat, protokollat dhe aparataturat mjekësore bashkëkohore si edhe në organizimin e punës në laborator, gjithashtu janë të aftë në mirëmbajtjen e pajisjeve.

	<i>Evidencë 2: Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i> <i>Evidencë 190: Udhezim-Nr.31-date-15.11.2022 Kodifikimi-i-programeve -te-studimit-IAL</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” është i hartuar për t’iu përgjigjur fushës specifike dhe të jetë në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Fusha e studimit duke qënë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, ka si qëllim të formojë teknikë profesionistë që kanë njohuri të thella ndaj shërbimit shëndetësor dhe higjienës spitalore, të aftë në minimizimin e gabimeve mjekësore dhe rritjen e cilësisë të shërbimit spitalor që i ofrohet pacientit me gjithë gamën e ekzaminimeve laboratorike. Studentët e diplomuar zotërojnë kompetencat e duhura profesionale mbi përdorimin dhe mirëmbajtjen e aparaturave mjekësore bashkëkohore, përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike, si edhe në kërkimin dhe hulumtimin shkencor, duke i bërë të aftë për tu punësuar ne poliklinika, qendra spitalore, etj. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master i Shkencave” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	FSHMT nuk ofron një rast të tillë.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	FSHMT ofron informacione për mundësitë e punësimit për studentët e programit "Master i Shkencave" në Teknik Laboratori, si gjatë periudhës së studimeve ashtu edhe pas diplomimit. Pas përfundimit të studimeve, studentët përfitojnë shërbim këshillimi për karrierën, i cili ndihmon në procesin e integritimit në tregun e punës.

	Zyra e Karrierës dhe Alumni, përmes projektit GRADUA, siguron komunikim të vazhdueshëm për aktivitetet në bashkëpunim me partnerët e tregut të punës, në nivel fakulteti e universiteti për studentët e diplomuar. <i>Evidencë 44: Lista e projekteve nderkombetare te aplikuara dhe te fituara</i> <i>Evidencë 45: Lista e projekteve kombetare te aplikuara dhe te fituara</i> <i>Evidencë 46: Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS</i> <i>Evidencë 47: Shembull-Marreveshje per diploma te perbashketa-Univ.Bologna</i> <i>Evidencë 48: Shembull marreveshje bashkepunimi me IAL nderkombetare</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 107: Manuali i keshillimit te karrieres fshmt</i> <i>Evidencë 108: Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT</i>			
Konkluzione	FSHMT disponon përvojën, kapacitetet dhe burimet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Teknik Laboratori". Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij program studimi janë në përputhje me fushën kërkimore të Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e	Institucioni thekson se, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, UMT siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësive e personelit. Aktiviteti akademik dhe administrativo financiare e institucionit pasqyrohet në analizën vjetore institucionale. Sipas takimit të zhvilluar me Drejtuesit e Njësive Kryesore dhe Bazë, bashkëpunimi dhe asistimi janë disa nga themelet kryesore të funksionimit të këtij institucioni.

personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	GVJ rekomandon dhe vlerëson si të domosdoshme, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, caktimin e Përgjegjësit të Grup-Lëndëve dhe Koordinatorit të programit të studimit. Ky pozicion luan një rol shumë pozitiv në ndihmën për koordinimin efikas midis personelit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 79.1: Raporti Vjetor_UMT_2021-2022</i> <i>Evidencë 82: Raporti vjetor FSHMT 2022-2023</i> <i>Evidencë 85: Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 152: Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT2</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidencë 169: Raporti i Vleresimit te Brendshem Institucional UMT 2022</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Bazuar më dokumentacionin e dorëzuar dhe takimeve të realizuara me drejtuesit e fakultetit, lidhur me realizimin e procesit mësimor, për kryerjen e praktikave dhe arritjen e objektivave, UMT ka nënshkruar marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi me institucione arsimore dhe shëndetësore, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare. Këto marrëveshje shërbejnë për të ofruar mundësi shkëmbimi të dijeve dhe bashkëpunimi me institucione si QSUT, Spitali Universitar i Traumës dhe Spitali Universitar "Shefqët Ndroqi", etj. Në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe marrëveshjet e nënshkruara, realizohen praktikat profesionale të studentëve, kryesisht në qendrat spitalore në Tiranë. <i>Evidencë 46: Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS</i> <i>Evidencë 47: Shembull_Marreveshje per diploma te perbashketa-Univ.Bologna</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 101: Lista e bashkepunime me institucione te tjera_FSHMT</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve te QSU</i> <i>Evidencë 151: Marrëveshje me RASH per sherbime ne fushen e IT</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>

Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Rregullorja e programit të studimit parashikon kryerjen e praktikave profesionale dhe klinike në institucione me të cilat UMT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Në këtë kontekst, UMT dhe FSHMT kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe private. Praktikrat realizohen në spitale, klinika diagnostike dhe laboratorë mjekësorë, të cilat ofrojnë pajisjet e nevojshme spitalore dhe diagnostike. Gjatë kryerjes së praktikës, studentët mbikëqyren prej stafit akademik të institucionit dhe nga drejtuesi i praktikës në institucionin përkatës. Përveç kësaj, duke shfrytëzuar të dhënat sasiore dhe cilësore klinike të marra nga raste konkrete gjatë zhvillimit të praktikave spitalore, si dhe duke përfituar nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, realizohen kërkime shkencore dhe mobilitete të personelit akademik, por edhe të studentëve. <i>Evidencë 10: Revista shkencore FSHMT 2022,2023</i> <i>Evidencë 15: Aktivitete_studente_libri_i_abstrakteve_konferenca_e_shkencave_mjekesore</i> <i>Evidencë 16: Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve. FSHMT</i> <i>Evidencë 18: Konferenca vjetore_libri_i_abstrakteve_FSHMT</i> <i>Evidencë 30: Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-ne-bashkepunim-me-UV-dhe-UIISH</i> <i>Evidencë 101: Lista e bashkepunime me institucione te tjera_FSHMT</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve te QSU</i> <i>Evidencë 122: Udhezues i praktikës profesionale Msc teknik laborator</i> <i>Evidencë 144: VKM Për miratimin e strukturave shendetesore universitare</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	UMT, FSHMT dhe tre Departamentet përkatëse të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, zbatojnë marrëveshjet e lidhura me homologët dhe institucionet e huaja dhe vendase kryesisht për realizimin e praktikave profesionale. <i>GVJ vëren një aktivitet të kufizuar në lidhje me veprimtaritë e tjera akademike dhe shkencore që lidhen me partnerët.</i>

	<i>Gjithashtu, vërehet mungesa e një dokumenti analitik që vlerëson përfitimet nga këto marrëveshje, çka pengon ofrimin e informacionit të detajuar për aktivitetet e organizuara, pjesëmarrjen në programet e mobilitetit dhe organizimin e veprimtarive të tjera në bashkëpunim me partnerët, veçanërisht në fushën e programit të studimit Master i Shkencave në "Teknik Laboratori" si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve.</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkëpunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 85: Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGj</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve te QSU</i> <i>Evidencë 144: VKM Për miratimin strukturave shendetesore universitare</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i>			
Konkluzione	- UMT dhe FSHMT kanë lidhur një sërë marrëdhëniesh bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm të institucioneve arsimore dhe shëndetësore, si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare, për të ofruar mundësi shkëmbimi dijeshe e bashkëpunimi, ku realizohen praktikat profesionale të studentëve. - GVJ rekomandon caktimin e një anëtarit të stafit akademik në pozicionin e Përgjegjës të Grup-Lëndëve dhe një tjetër personel në pozicionin e Koordinatorit të programit të studimit, si elemente të rëndësishëm dhe të domosdoshëm, në përputhje me udhëzimet e MAS. Këto pozicione do të luajë një rol pozitiv duke ndihmuar në koordinimin efektiv ndërmjet personelit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme. - GVJ gjithashtu rekomandon hartimin e një dokumenti analitik periodik për vlerësimin e përfitimeve nga zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerët në fushën e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit për ciklin e dytë Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” është i strukturuar në lëndë dhe module të cilat vlerësohen me kredite, në përputhje me ligjin 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program përfshin 120 kredite ECTS dhe 3000 orë të angazhimit. Lëndët janë organizuar në pesë kategori (A, B, C, D, E). Plani mësimor përmban leksione, seminare, praktikë profesionale dhe provime të ndërmjetme dhe përfundimtare. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen në: 1. Kategoria A: Lëndë bazë/përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme, 5%-10% (13 kredite), 5 module lëndësh. 2. Kategoria B: Lëndë karakterizuese/përgatitje për disiplinën shkencore, 50%-60% (66 kredite), 14 provime. 3. Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje, 12%-20% (11 kredite), 5 module lëndësh. 4. Kategoria D: Lëndë plotësuese/gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale, 10% (12 kredite), 1 provim. 5. Kategoria E: Detyrime përmbyllëse, 10%-15% (18 ECTS). <i>GVJ vlerëson që të rishikohet shpërndarja e lëndëve-moduleve në kategoritë përkatëse, “Kategoria A – Lëndë bazë dhe Kategoria C – Lëndë ndërdisiplinore/integruese” në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar për këto dy kategori. Konkretisht në kategorinë A, ka një devijim me afër 1% më shumë se maksimumi i lejuar (10%). në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar 5%-10%. Dhe në kategorinë C, ka një devijim me afër 4% më pak se minimumi i lejuar (12%). në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar 12%-20%.</i>

	<i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Qëllimi kryesor i programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” është të formojë teknik laborator me kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional, të aftë që të punojnë në klinika diagnostike, qendra spitalore, poliklinika, etj., si në sektorin publik dhe atë privat duke qënë të aftë në organizimin e punës në drejtimin e rritjes së kosto-efektivitetit, të minimizojnë gabimet mjekësore dhe të rrisin cilësinë e shërbimit shëndetësor në të gjithë gamën e ekzaminimeve laboratorike diagnostike dhe analitike. Të gjitha lëndët klinike në këtë program pasohen nga ato të specialiteteve, duke u dhënë studentëve njohuri diagnostike, njohuri mbi aparaturat mjekësore bashkëkohore dhe mirëmbajtjen e tyre, si edhe mundësuar vlerësimin analitik të patologjive, duke përfshirë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës diagnostike. Lëndë të tilla si “Komunikimi Profesional”, “Bioetika”, “Psikologjia e Shëndetit”, “Organizim, Menaxhim dhe Promocion Shëndetësor”, “Dietologji”, “Antropologji Mjekësore”, etj. përfshihen me qëllim përgatitjen sa më të mirë të mundshme të studentëve. <i>Evidencë 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, në planin mesimor të tij ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale, ku është parashikuar një ngarkesë prej 12 ETCS për praktikën profesionale, dhe në fund të vitit të dytë akademik studentët testohen me provim për praktikat profesionale të realizuara gjatë vitit nëpër spitalet dhe qendrat spitalore universitare. Në planin mesimor gjithashtu është përcaktuar finalizimi i studimeve me provimin e diplomës me Mikrotezë, me ngarkesë 18 ECTS. <i>Evidencë 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i>

Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Nuk aplikohet.

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton që FSHMT si njësi përgjegjëse, është kujdesur që programi i ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, ka përmbajtje të ngjashme në nivelin 70% me programet ekuivalente që ofrohen me të njëjtën emërtesë dhe i përkasin të njëjtës fushë studimi dhe cikli studimi, si brenda edhe jashtë vendit. <i>Evidencë 25: VKM licensimi Msc Teknik laborator</i> <i>Evidencë 56: Procedura, afatet dhe dok. per hapjen e programeve te reja, riorganizimin dhe miratimin periodik te planeve</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe shoqërohet me kodin përkatës (72MS0914S në ISCED 2011), sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Gjithashtu është realizuar kodifikimi i lëndëve të programit të studimit (KSHK) [25, 86, 91.2, 190]. <i>Evidencë 25: VKM licensimi Msc Teknik laborator</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 190: Udhëzim Nr.31 date. 15.11.2022 Kodifikimi i programeve te studimit IAL</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohet.
Konkluzione	- Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” i cili i takon nivelit 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, përmban të gjithë elementët e strukturës së programit të studimit të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, dhe në aktet e brendshme rregullatorë. - Ky program ka ngjashmëri mbi 70% me programe të tjera të njëjta që ofrohen brenda dhe jashtë vendit, ndërsa çdo lëndë ka një numër kreditesh të përcaktuara.

	- GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarja së lëndëve-moduleve sipas kategorive përkatëse në përputhje me përqindjen e paracaktuar të lejuar në VKM Nr. 41. Datë 21.01.2018, ku konkretisht: 1. Kategoria A (Lëndë Bazë) ka tejkalim kreditesh nga 5%-10% (1 ECTS) 2. Kategoria C (Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese) ka mosplotësim të numrit minimal të Krediteve 12%-20% (4 ECTS)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, pjesë e UMT, ka përgjegjësi për programet që ofrohen në tre Njësitë bazë/Departamentet e saj, njësi të cilat përmbushin detyrimin ligjor për numrin e personelit e titujve akademikë. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është njësia kryesore përgjegjëse, si edhe në të njëjtë kohë përmbush detyrimet ligjore për të ofruar programin e studimit Master i Shkencave në "Teknik Laboratori". Në përbërje të tij FSHMT ka gjithsej sipas viteve akademike: Viti Akademik: 2022-2023: PAE 27 Prof. Dr. 1, Prof. As 8, Dr. 15, Msc. 3. PAK 93 Prof. Dr. 1, Prof. As 0, Dr. 20, Msc. 72. Viti Akademik 2021-2022: PAE 22 Prof. Dr. 1, Prof. As 6, Dr. 13, Msc. 2. PAK 100 Prof. Dr. 1, Prof. As 0, Dr. 21, Msc. 78. Viti Akademik 2020-2021: PAE 28 Prof. Dr. 2, Prof. As 4, Dr. 17, Msc. 5. PAK 79 Prof. Dr. 1, Prof. As 0, Dr. 18, Msc. 60. GVJ konstaton një shmangie nga standardi i kërkuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas të cilit personeli akademik efektiv (PAE) duhet të përbëjë 70% të stafit akademik kundrejt stafit të angazhuar me kohë të pjesshme. dhe rekomandon të reflektohet mbi këtë raport ku konkretisht për vitet akademik 2020-2024, ky raport është afërsisht në masën 29% PAE - 71% PAK.

	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike si njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit në fushën e mësimdhënies ka për detyrë: - Përgatitjen e profileve dhe përmbajtjeve të lëndëve për diplomat e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit, si dhe për programet me karakter profesional që ndodhen nën administrimin e saj. - Administrimin dhe organizimin e profileve të kërkimit shkencor për diplomat e ciklit të dytë, veçanërisht për projektet kërkimore. - Bashkëpunimin me departamentet e tjera të Universitetit për realizimin e planeve mësimore. <i>Evidencë 2: Rregullore e Universitetit të Mjekësisë Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 95: Tabela e personelit akademik të angazhuar në Programin MSc Teknik Laboratori 23-24</i> <i>Evidencë 97: Tabela përmbledhese ASCAL Msc Teknik laborator</i> <i>Evidencë 165: Te dhena statistikore_stafi akademik 2019-2024.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, përmbush me sukses të gjitha detyrimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. FSHMT siguron angazhimin e personelit të duhur ndihmës akademik, aktualisht 9 personel i punësuar në këtë cilësi, i cili kontribuon në realizimin efektiv të praktikave klinike profesionale dhe laboratorike. Departamenti përbëhet nga nëntë personel ndihmës akademik dhe katër personel akademik të jashtëm, të cilët zhvillojnë lëndët dhe ndihmojnë në zhvillimin e praktikave profesionale. Kryesisht për zhvillimin e praktikave profesionale, angazhohet personel akademik me kontratë, që vjen nga Qëndrat Spitalore Universitare, Poliklinikat, ISHP, dhe QKTGJ. Përgjegjësi i njësisë bazë, organizon ndarjen e punës për koordinatorët që mbikëqyrin praktikat profesionale në të gjitha institucionet me të cilat Universiteti ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i>

	<i>Evidencë 95: Tabela e personelit akademik te angazhuar ne Programin MSc Teknik Laboratori 23-24</i> <i>Evidencë 101: Lista e bashkepunime me institucione te tjera</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve te QSU</i> <i>Evidencë 122: Udhezues i praktikës profesionale Msc teknik laborator</i> <i>Evidencë 144: VKM Për miratimin e strukturave shendetesore universitare</i> <i>Evidencë 165: Te dhena statistikore_stafi akademik 2019-2024</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<i>Dekani i FSHMT-së duhet të caktojë një personel efektiv në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e tij.</i> Koordinator i programit gjithashtu duhet të informojë vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse dhe të shqyrtojë cilësinë e syllabuseve përpara miratimit, të miratojë temat e eseve dhe tezat e provimeve, si dhe të vlerësojë ecurinë e praktikave profesionale. <i>Megjithatë, GVJ nuk ka mundur të identifikojë evidencë për një pozicion të tillë.</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 97: Tabela permbledhese ASCAL Msc Teknik laborator</i>			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike i cili ofron këtë program studimi, përmbush të gjitha kriteret ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke u bazuar në numrin e personelit dhe titujve akademikë.</i> <i>FSHMT për programin e studimit MSc në "Teknik Laboratori", përbëhet nga 120 anëtarë, ku 27 janë me kohë të plotë dhe 93 të tjerë janë personel akademik me kontratë. Po ashtu, është angazhuar edhe nëntë personel ndihmës akademik i nevojshëm për realizimin e praktikave laboratorike dhe atyre klinike profesionale.</i> <i>– GVJ rekomandon emërimin e koordinatorit për programin e studimit, i cili do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e përcaktuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	FSHMT si njësi kryesore përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, ka të disponueshëm dokumentacionin e plotë për këtë program, i cili përfshin: Kurrikulën e Programit të Studimit, Planin Mësimor dhe Syllabuset e Lëndëve. Informacioni për programin është gjithashtu i aksesueshëm në sistemin EasyWeb LMS dhe në faqen e internetit të UMT. Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese është e përshkruar në detaje në planin mësimor të programit, në përputhje me kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për Elementët e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, e ndryshuar. GVJ rekomandon që të përgatiten dokumentet dhe syllabuset edhe në gjuhën angleze, për të lehtësuar transferimin e studentëve dhe për t’i ndihmuar ata në gjetjen e materialeve shtesë online dhe shfrytëzimin e literaturës ndërkombëtare. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 147: Pershkrim i funksionaliteteve te platformes E-UMT</i> <i>Evidencë 148: Pershkrim funksionaliteteve te platformes EasyWeb LMS</i> <i>Evidencë 170. Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i> <i>Evidencë 191: VKM-nr.41-date-24.1.2018</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknik si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, ka për detyrë organizimin dhe administrimin e tij. Ky program përbëhet nga gjithsej 120 kredite, përkatësisht 3000 orë të ndara në katër semestra. Lëndët janë strukturuar në module të ndryshme, të kategorizuara sipas natyrës së disiplinës (A-E). Nga 3000 orët totale, 534 orë janë leksione, 132 janë seminare, 475 orë janë dedikuar praktikës profesionale zhvilluar në auditor dhe 300 orë praktika profesionale jashtë institucionit,

	për përgatitjen e diplomës janë në dispozicion 108 orë; pjesa tjetër e ngarkesës është shpërndarë për studim individual dhe jashtë auditorit. Informacioni i detajuar gjendet gjithashtu në syllabuset e çdo moduli. Njësia kryesore është përgjegjëse për ndarjen e ngarkesës mësimore dhe monitorimin e realizimit të saj. Për çdo lëndë/modul përcaktohen detyrimet përkatëse, si seminare, ushtrime, detyra kursi, projekte dhe praktika. Syllabuset e lëndëve/moduleve përmbajnë gjithashtu metodat e kontrollit të dijeve. Emërtimi i lëndëve/moduleve sipas kategorive përfshin kreditet përkatëse, të ndara në orë brenda dhe jashtë auditorit. Planifikimi i krediteve për çdo lëndë/modul dhe raporti i orëve (leksione, seminare, laboratorë) janë dhënë në detaje në planin mësimor. <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 97: Tabela permbledhese ASCAL Msc Teknik laborator</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit mbështetet në strategjinë institucionale të UMT, duke synuar konkretisht përgatitjen në fushën e Teknikut të Laboratorit dhe përmbushjen e objektivave strategjike të Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Në përfundim të ciklit të studimeve 2-vjeçar, studentët pajisen me diplomën universitare Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”. Rregullorja e programit të studimeve përfshin informacion të plotë mbi politikat dhe procedurat e pranimit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, si dhe detaje për transferimin, njohjen dhe ekuivalentimin e studimeve. Po ashtu, vendimi i Senatit Akademik mbi kriteret e pranimit përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin në këtë program studimi të nivelit të dytë. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 131: Nderfaqë Publikimi i listës së aplikuesve dhe fituesve për program studimi</i> <i>Evidencë 132: Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes së aplikanteve ne prog. E ciklit I dhe te integruar</i> <i>Evidencë 134: Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, II, III (SPA)</i> <i>Evidencë 135: Praktike per miratimin e kriterëve te pranimit cikli i parë dhe integruar</i>

	<i>Evidencë 137: Praktike per miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar</i> <i>Evidencë 138: Raporti i grupit te punes per verifikimin e kapaciteteve pritesë 23-24</i> <i>Evidencë 139: Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave te pranimit ne c1, PICD dhe te ciklit te dyte ne UMT</i> <i>Evidencë 170. Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në syllabuset e programit të studimit pasqyrohen informacionet e nevojshme për çdo lëndë sipas kërkesave të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Plani mësimor i përpunuar sipas këtyre përcaktimeve ofron informacionin e nevojshëm për studentët dhe personelin akademik. <i>GVJ vëren se disa syllabuse nuk përfshijnë seminarët ose orët e praktikës, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara.</i> <i>Evidencë 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 191: VKM-nr.41-date-24.1.2018</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Institucioni deklaron se përmbajtja e programeve të studimit është në proces të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi. Në fillim të çdo viti akademik, miratohen ndryshimet e mundshme dhe arkivohet dosja e plotë. Programi i studimit, plani mësimor, lëndët dhe aktivitetet formuese të ofruara në program, si dhe kreditet për secilën prej tyre, rishikohen periodikisht. Ndryshimet propozohen nga Departamentet, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni, si dhe nga anëtarët e personelit akademik, në konsultim me aktorët e tregut të punës, si përgjigje ndaj kërkesave të tregut dhe dinamikave të brendshme. Propozimet për ndryshime paraqiten të argumentuara nga pala e interesuar dhe shqyrtohen nga Departamentet përkatëse dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Këshillimit të Karrierës, Alumni. Më pas ato dërgohen për miratim në mbledhjen e Dekanatit dhe përcillen në Senat për miratimin përfundimtar të tyre.

	Megjithatë, GVJ vëren se nuk është konstatuar dosja e plotë e arkivuar mbi ndryshimet eventuale të përmbajtjes së programit të studimit Master i Shkencave. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 6.1: Fillimi i praktikës për rishikimin e planeve mesimore</i> <i>Evidencë 6.2: Propozimet për ndryshim të planeve mesimore</i> <i>Evidencë 6.3: Vendim Senati Akademik nr.79 date 07.10.2022 për miratimin e planeve mesimore FSHMT</i> <i>Evidencë 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori</i>			
Konkluzione	<i>Të gjithë informacionet e nevojshme për programin e studimit janë të disponueshme nga Njësia Bazë. Ky program përmban të gjitha elementët esenciale, duke përfshirë planin mësimor, kurrikulën e programit të studimit dhe syllabuset, etj.</i> <i>Programi ofron gjithashtu informacionin dhe dokumentacionin procedural të nevojshëm për pranimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në "Teknik Laboratori", si dhe për transferimin e studimeve dhe procedurat përkatëse.</i> <i>Megjithatë, nuk janë konstatuar ndryshime eventuale dhe nuk është paraqitur dokumentacion konkret që dëshmon për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit Master i Shkencave në "Teknik Laboratori" ndër vite.</i> <i>GVJ rekomandon që të përgatiten dokumentacioni dhe syllabuset edhe në gjuhën angleze, me qëllim të lehtësimit të transferimit të studentëve, si dhe për t'u orientuar në gjetjen e materialeve shtesë dhe shfrytëzimin e literaturës online.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë,	Duke marrë në konsideratë faktin që studentët e këtij programi studimi kanë një formim të përgjithshëm në ciklin e parë të studimeve Bachelor në "Teknik Laboratori", vihet re se shpërndarja moduleve nuk ndjek ndonjë kriter specifik varësie midis moduleve.

thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Modulet/lëndët janë organizuar në një mënyrë që ofrojnë një formim të logjikshëm për studentët, duke filluar me modulet klinike dhe praktike. Emërtimi dhe aktivitetet formuese të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” janë konceptuar dhe hartuar me qëllimin e thellimit të njohurive dhe aftësive për një kujdes më të avancuar për pacientët, si dhe për studime më të thelluara, si në auditor, ashtu edhe në praktika profesionale. Programi i studimit i jep një rëndësi të veçantë formimit shkencor profesional të studentit. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 122: Udhezues i praktikës profesionale Msc teknik laborator</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Lëndët/modulet e programit të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” janë të shpërndara në katër semestra dhe dy vite akademik, ku formimi teorik dhe ai praktik kontribuojnë në zhvillimin profesional dhe shkencor të studentëve. Plani mësimor lejon realizimin e objektivave formuese të programit të studimit dhe arritjen e kompetencave të studentëve në njohuri më të thelluara e avancuara. Ndarja e orëve mësimore në auditor, përfshirë orët për leksione dhe seminare, përcaktohet në planin mësimor të programit, në përputhje me kreditet e secilës disipline. Për disa lëndë, në varësi të specifikave të tyre, mund të aplikohen seminare klasike, detyra/projekte kursi, ose praktikë lëndore, për të nxitur studentët të punojnë në mënyrë të pavarur. Në lëndë të tjera, mund të ketë një fokus më të madh në orët laboratorike ose praktike. Kjo mbetet pjesë e analizës dhe përmirësimeve të mundshme të programit në të ardhmen, duke reflektuar gjithashtu propozimet e studentëve të diplomuar. <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 97: Tabela permbledhese ASCAL Msc Teknik laborator</i>

Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master i Shkencave”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, rezulton se raporti teori-praktikë është në përputhje me programet ndërkombëtare, gjë që vërehet edhe në njehsimin e diplomave dhe planit mësimor, në përputhje me profilin e studentëve që arrijnë të punësohen në vende të ndryshme të botës. Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik, u konstatua se programi është i ngjashëm me programe të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare, me disa ndryshime të vogla në numrin e ECTS për lëndë. Ky program siguron aftësi, kompetenca dhe një formim të thelluar profesional dhe shkencor, duke i paraprirë avancimit për studime në ciklin e tretë të studimeve. Në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” ofrohen njohuri të thelluara teorike dhe praktike, që u japin mundësinë studentëve që të jenë autonomë në vendimmarrje si edhe analiza të situatave të ndryshme që mund të ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit. <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laboratorori</i> <i>Evidencë 107: Manuali i keshillimit te karrieres fshmt</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” përfshin veprimtaritë formuese përkatëse, duke përcaktuar lëndët bazë, karakterizuese e ndërdisiplinore/integruese. Natyra e moduleve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS sigurojnë një integrim të aspekteve teorike dhe praktike, duke mundësuar arritjen e objektivave formues. Për më tepër, hartimi i këtij programi studimi rrit mundësitë për transferimin apo mobilitetin e studentëve, si dhe për mundësitë e punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laboratorori</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laboratorori 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 97: Tabela permbledhese ASCAL Msc Teknik laboratorori</i> <i>Evidencë 107: Manuali i keshillimit te karrieres fshmt</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike analizon ecurinë e programit të studimit duke përfshirë mendimin e opinionet e lektorëve dhe studentëve për çdo modul.

mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.

Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program janë në përputhje me këto përcaktime dhe përfshijnë pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimin, kontrollin e vazhdueshëm, literaturën dhe vërejtjet përfundimtare nga pedagogu, gjithashtu sikurse në syllabuset e disa lëndëve të tjera konstatohen parregullsi dhe devijime nga formati i sipërpërmendur me të gjithë komponentët e duhur.

Në fillim të çdo semestri, syllabuset rishikohen nga titullari i lëndës dhe më pas konsultohen nga Drejtuesi i Departamentit përkatës, i cili miraton ato në mungesë të Përgjegjësit të Grupit Mësimor.

GVJ konstaton se në shumicën e syllabuseve, standardi i vendosur nga udhëzimet e MAS nuk respektohet. Literatura bazë e detyrueshme dhe ajo ndihmëse nuk përmbajnë botime të pesë viteve të fundit dhe shpesh nuk janë në gjuhën angleze apo nga shtëpi botuese të njohura si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, Pearson, Sage, etj. Madje në rastin më të keq janë leksione të përgatitura nga lektori i lëndës.

Konkretisht nga shqyrtimi i syllabuseve të viteve akademik 2022-2024 ka shumë lëndë që nuk ndjekin dhe zbatojnë këtë standard për caktimin e një literature bazë të detyrueshme të pesë viteve të fundit (aq më tepër nga shtëpi botuese ndërkombëtare), si p.sh.:

- Në pjesën më të madhe të lëndëve literatura bazë e detyrueshme është më shumë se 10 vjeçare si:

2000 – Psikologji Shëndeti

2002 – Metodologji e Kërkimit Shkencor

2008 – Testet Laboratorike në Geriatri

2010 – Shkrim Akademik

2011 – Imunologji e Avancuar dhe Diagnostike

2015 – Bioetikë

- Ndërsa në të paktën dhjetë lëndë, si:

✓ Gjenomika

✓ Biologji Molekulare

✓ Diagnostikë Molekulare

✓ Komunikim Profesional

✓ Algoritma Diagnostikë dhe Laboratorikë

✓ Organizim, Menaxhim dhe Promocion Shëndetësor

✓ Ekzaminimet Laboratorike në Aparat Kardiovaskular/ Pulmonar

✓ Testet Laboratorike në Obstetrikë – Gjinekologji

✓ Ekzaminimet Laboratorike në Toksikologji

	✓ Citologjia e Lëngjeve Biologjike, konstatohet që si literaturë bazë e detyrueshme shërbejnë “Leksione të Përgatitura nga Pedagogu i Lëndës”, “Cikël Leksionesh” ose “Leksione PPT”. - GVJ rekomandon përdorimin e literaturës së huaj si pjesë të literaturës bazë dhe të rekomanduar. Meqënëse ka mangësi me botime në gjuhën shqipe, studentët shpesh mbështeten në përmbledhje të leksioneve të përgatitura nga lektorët. - GVJ sugjeron që njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të mundësojë përkthimin në shqip të disa botimeve kryesore në fushën e Teknikut Laborant për të ndihmuar studentët në thellimin e njohurive të tyre. - GVJ gjithashtu rekomandon përfshirjen e dy teksteve si literaturë bazë të detyrueshme, me qëllim marrjen e kompetencave të duhura shkencore, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe ciklin e dytë të studimeve që i përket program Master Shkencor në “Teknik Laboratori”. <i>Evidencë 11: Praktike per miratimit e planeve mesimore.</i> <i>Evidencë 14: Shembull formulari i performances 2023</i> <i>Evidencë 67: Shembull Pyetesor Vleresim i studentëve per lendet e programit te studimit formular</i> <i>Evidencë 68: Shembull Pyetesor Vleresim i studentëve per UMT formular</i> <i>Evidencë 70: Lista e publikimeve_Keshilli i botimeve 2022-2023</i> <i>Evidencë 85: Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGj</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 110. Analize vjetore zyra e finances.</i> <i>Evidencë 111: Analize vjetore Zyra e burimeve njerezore</i> <i>Evidencë 113: Biblioteka FSHMT</i> <i>Evidencë 114: Bibliotekat online - lista dhe pershkrim</i> <i>Evidencë 115: Komunikimi zyrtar per U-Library</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” është e dizajnuar për të ndihmuar studentët në përftimin e njohurive të avancuara dhe zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të nevojshme për përmbylljen e ciklit të dytë të studimeve. Ky program garanton që studentët të fitojnë dije të thelluara dhe specifike në fushën e Teknikut të Laboratorit.

	Përveç aftësimin praktik të studentëve (<i>zhvillimi i seancave laboratorike dhe praktikave profesionale</i>), programi gjithashtu fokusohet në përfitim të njohurive teorike shkencore të avancuara. Si rezultat, synohet që studenti të përvetësojë aftësi praktike dhe klinike, si edhe të përfitojë njohuritë e duhura shkencore, duke u përgatitur kështu për të përballuar sfidat e karrierës në këtë fushë. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” është në përputhje me vizionin dhe misionin e Universitetit të Mjekësisë dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, si një institucion bashkëkohor për studim, kërkim dhe transferim njohurish. Ky program mbështet nevojat dhe kërkesat për diplomant të fushës së shkencave mjekësore teknike dhe u ofron studentëve të diplomuar njohuritë e nevojshme për të ndjekur më tej ciklin e tretë të studimeve. Programi ofron mundësi për studentët për të vazhduar njohuritë e tyre nëpërmjet trajnimeve të mëtejshme, konferencave specifike në këtë fushë, si dhe mundësinë për të ndjekur studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve në Doktoratë. Niveli i njohurive të fituara nga lëndët e programit krijon një bazë solide profesionale e shkencore për studentët, duke i përgatitur ata për t'u angazhuar në tregun e punës në përputhje me pritshmërinë dhe kërkesat e tij. <i>Evidencë 2: Rregullore-e-Universiteti te Mjekesise Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 15: Aktivitete_studente_libri_i_abstrakteve_konferenca e shkencave mjekesore</i> <i>Evidencë 16: Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve. FSHMT</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laborarori</i> <i>Evidencë 22.2: Format diplome msc teknik laborator</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 107: Manuali i keshillimit te karrieres fshmt</i> <i>Evidencë 108: Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT</i>

	<i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>			
Konkluzione	<i>Emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive formuese të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” janë konceptuar dhe hartuar për të thelluar njohuritë shkencore dhe aftësitë profesionale të studentëve, duke u mundësuar atyre studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve dhe mundësi punësimi në fushën e teknikut laborant. Lëndët/modulet janë të shpërndara në katër semestral / dy vite akademike, secila me kreditet specifike.</i> <i>- Rekomandimet e GVJ:</i> <i>1. Përditësimi i syllabuseve: Rishikimi i literaturës bazë të detyrueshme dhe literaturës së rekomanduar, me përfshirjen e teksteve dhe botimeve të pesë viteve të fundit në gjuhën angleze nga shtëpitë botuese të njohura si Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, Pearson, Sage, etj.</i> <i>2. Caktimi i një Përgjegjësi të Grupit Mësimor: Emërimi i një anëtarit të stafit në rolin e përgjegjësit të grupit mësimor, i cili mund të drejtojë procesin e konsultimit të syllabuseve në mënyrë periodike.</i> <i>3. Përfshirja e dy teksteve si literaturë bazë të detyrueshme: Rekomandohet që të përfshihen dy tekste pjesë e literaturë bazë dhe të detyrueshme për programin Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, me qëllim që të sigurohet marrja e kompetencave të duhura shkencore. Kjo do të ndihmojë në përputhjen e programit me kërkesat e tregut të punës dhe me standardet e ciklit të dytë të studimeve, duke ofruar një bazë më të fortë për formimin e studentëve në këtë fushë. Këto tekste duhet të jenë të përditësuara dhe relevante për temat dhe kërkesat aktuale në fushën e teknikës laboratorike.</i> <i>Këto rekomandime synojnë të përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe të sigurojnë që studentët të kenë akses në materiale të përditësuara dhe të dobishme për formimin e tyre profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike deklaron se për të përmirësuar dhe përshtatur programin e studimit në përputhje me politikat që mbështesin punësimin e studentëve, merr parasysh mendimet, propozimet dhe zhvillon konsultime me anëtarët e stafit të departamenteve ose fakultetit. Kjo bëhet me synimin e përmirësimit të mëtejshëm të programit të studimit, në mënyrë që të rritet aftësimi profesional i studentëve dhe të lehtësohet përfshirja e tyre në tregun aktual të punës. Në të njëjtën kohë, memorandumet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit që UMT dhe FSHMT kanë lidhur me institucionet partnere synojnë realizimin e praktikave të studentëve dhe lehtësimin e punësimit të tyre. <i>Megjithatë, GVJ vëren se mungon si strukturë Bordi i Tregut të Punës ose një Strukturë tjetër e ngjashme, të cilët do të ishin instrumente tejet të rëndësishëm për këshillimin e karrierës së studentëve si edhe për propozimet që do ndihmonin për përmirësimin e kurrikulave.</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 11: Praktike për miratimit e planeve mesimore</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laborator</i> <i>Evidencë 46: Memorandume bashkëpunimi UMT me MShMS</i> <i>Evidencë 47: Shembull Marreveshje për diploma të perbashketa-Univ.Bologna</i> <i>Evidencë 48: Shembull marreveshje bashkëpunimi me IAL nderkombetare</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkëpunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione të tjera</i> <i>Evidencë 85: Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 107: Manuali i keshillimit të karrierës fshmt</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve të QSU</i> <i>Evidencë 122: Udhezues i praktikës profesionale Msc teknik laborator</i>

Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Përfshirja e studentëve në struktura të ndryshme dhe në komisionet që ngrihen është një detyrim ligjor. Pjesëmarrja e tyre në Senatin Akademik u ofron studentëve mundësinë të propozojnë përmirësime në programin e studimeve. Studentët gjithashtu kanë si strukturë të vetën Këshillin Studentor, i cili ka të hartuar qartësisht edhe rregulloren që përcakton organizimin dhe funksionimin e tij. Kontributi e mendimet e studentëve për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit mundësohen gjithashtu përmes pyetësorëve të zhvilluar nga strukturat e FSHMT apo Departamenteve. Pyetësorët, të cilët shërbejnë si instrumente për mbledhjen e mendimeve e sugjerimeve të studentëve, ndihmojnë në identifikimin e problematikave dhe sugjerimeve për përmirësimin e programit të studimit. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 27: Pyetësi i studentëve_fshmt_23</i> <i>Evidencë 28: Rezultatet_pyetësorit_studentet_23</i> <i>Evidencë 33: Sherbimet per studentet_FSHMT</i> <i>Evidencë 67: Shembull_Pyetësor Vlerësim i studentëve per lëndet e programit te studimit_formular</i> <i>Evidencë 68: Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve per UMT_formular</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 124: Lista e aktivitetëve Keshilli Studentor UMT</i> <i>Evidencë 127: Statuti i Keshillit Studentor UMT</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	FSHMT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe shkencore, që synojnë përveç shkëmbimit të stafit e studentëve për module të ngjashme, edhe ndarjen e eksperiencave për përditësimin e përshtatjen e programit të studimit. Marrëveshjet e bashkëpunimit përfshijnë organizimin e leksioneve të hapura mbi tema specifike dhe angazhimin e personelit akademik nga institucionet partnere me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet. Një rol të veçantë luan veçanërisht stafi mjekësor i spitaleve publike, i cili jep një kontribut të rëndësishëm në fushën e diagnostikës dhe ndihmon në krijimin e lidhjeve me një rrjet më të gjerë profesionistësh të fushës, shoqatave të ndryshme, urdhrit të infermierit, etj.

	<i>Evidencë 48: Shembull marreveshje bashkepunimi me IAL nderkombetare</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 56: Procedura, afatet dhe dok. per hapjen e programeve te reja, riorganizimin dhe miratimin periodik te planeve</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve te QSU</i> <i>Evidencë 165: Te dhena statistikore _stafi akademik 2019-2024</i> <i>Evidencë 166: Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni raporton se programi i studimit perditësohet dhe permirësohet në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke përfshirë mendimet dhe propozimet e institucioneve partnere dhe studentëve të diplomuar, me synimin për të lehtësuar përfshirjen e studentëve në tregun aktual të punës.</i> <i>Studentët, përmes përfaqësimit të tyre në Senatin Akademik dhe Këshillin Studentor, marrin pjesë në procesin e përmirësimit të programit të studimit. Kontributi i tyre përmes reflektimeve është i rëndësishëm në këtë proces, duke ofruar ndihmesën e tyre edhe pas diplomimit në kuadër të aktiviteteve të vazhdueshme edukative.</i> <i>GVJ vëren se një element i rëndësishëm për përmirësimin, perditësimin dhe përshtatjen e programit të studimit është bashkëpunimi me institucionet kërkimore e shkencore, si dhe me stafin mjekësor të spitaleve publike dhe private. Këto marrëveshje bashkëpunimi kanë mundësuar angazhimin e personelit mjekësor si staf akademik me kontratë.</i> <i>GVJ rekomandon krijimin e Bordit të Tregut të Punës ose të një strukture tjetër të ngjashme, të cilat do të shërbenin si një faktor dhe kontribues i rëndësishëm për këshillimin e karrierës së studentëve dhe për propozimet lidhur me përmirësimin e kurrikulave.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

33

Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Prioriteti i programit të studimit është përgatitja e studentëve të aftë dhe kompetentë në fushën e tyre. Programi përcakton qartë prioritetet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e situatave komplekse, jo vetëm në aspektin profesional, por edhe me vlera të larta humane. Misioni i këtij programi është të përgatisë specialistë ose profesionistë teknikë me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të punuar në klinika spitalore, poliklinika, laboratorë klinikë dhe biokimikë, publikë dhe privatë. Ky formim synon organizimin efektiv të punës për të rritur kosto-efektivitetin, për të shfrytëzuar më mirë burimet njerëzore, për të minimizuar gabimet mjekësore dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit shëndetësor që u ofrohet pacientëve me një gamë të gjerë ekzaminimesh laboratorike. Programi Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” ka për qëllim të zhvillojë kompetencat profesionale dhe të pajisë studentët me aftësi të avancuara për organizimin e punës në laborator. Studentët përvetësojnë plotësisht protokollat e punës, teknikave laboratorike, njohjen dhe mirëmbajtjen e aparaturave mjekësore, si dhe aftësinë për të interpretuar analizat diagnostike dhe për t'u përshtatur me teknologjinë moderne. Synimi është që studentët të zhvillojnë një kompetencë të lartë në etikën dhe deontologjinë profesionale, legjislacionin mjekësor, ruajtjen e sekretit profesional dhe aftësitë e komunikimit me kolegë, eprorë, vartës, pacientë dhe familjarë. Programi gjithashtu ka si objektiv nxitjen e kërkimit dhe hulumtimit shkencor. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	FSHMT kryen kërkime shkencore në përputhje me fushën përkatëse që përfaqësojnë, duke respektuar gjithashtu etikën e kërkimit shkencor. Pedagogët e UMT gëzojnë prioritetet lehtësuese e inkurajuese në mësimdhënie dhe veprimtari kërkimore shkencore. FSHMT me anë të tre Departamenteve që ka në përbërje të vet, organizon dhe administron procesin akademik, duke inkurajuar dhe bashkërenduar këtë veprimtari dhe duke respektuar lirinë akademike të stafit, e cila shprehet në zgjedhjen e tematikave të lëndës, literaturës, etj. Dekani i Fakultetit monitoron progresin e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi zhvillimin dhe organizimin e programit. Shpërndarja e orëve të teorisë, projekteve kërkimore dhe praktikave gjatë vitit akademik bën të mundur ndërthurjen e

	njohurive dhe siguron respektimin e lirisë akademike të pedagogut. Kjo qasje ndihmon studentët në mbledhjen e të dhënave klinike dhe prezantimin e rasteve konkrete të hasura në fushën e studimit në projektet e tyre lëndore. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 2: Rregullore-e-Universiteti te Mjekesise Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 156: Formular raport per realizimin e veprimtarise akademike</i> <i>Evidencë 164: Praktika për planifikimin dhe realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Sipas rregullores së Departamentit, studentët kanë të drejtë të përdorin, në përputhje me rregullat përkatëse, të gjitha mundësitë dhe pajisjet që ofron institucioni (FSHMT) për të përmbushur programin mësimor dhe për të kryer aktivitetin e planifikuar shkencor. Institucioni raporton se Departamentet inkurajojnë studentët të marrin pjesë në konferenca, seminare dhe workshop, si dhe të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore përmes përgatitjes së detyrave të kursit bashkë me profesorët përkatës, për projektet kërkimore në UMT me anë të punimit të tezës së diplomës. Produktet shkencore, temat e kursit dhe temat e diplomës së studentëve depozitohen në mënyrë elektronike ose në formë të printuar pranë departamenteve dhe shërbejnë si të dhëna kërkimore. Pedagogët kanë inkurajuar studentët të publikojnë dhe botojnë këto punime, si dhe i kanë përfshirë ata në punën e tyre kërkimore, duke i angazhuar në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, si dhe në publikime në Buletinin e UMT. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 9: Udhezues per hartimin e temes se diplomes</i> <i>Evidencë 10: Revista shkencore FSHMT 2022,2023</i> <i>Evidencë 15: Aktivitete_studente_libri_i_abstrakteve_konferenca_e_shkencave_mjekesore</i>

	<i>Evidencë 16: Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve. FSHMT</i> <i>Evidencë 18: Konferenca vjetore libri i abstrakteve FSHMT</i> <i>Evidencë 19: Aktiviteti dt 14 Nentor 2023 në FSHMT</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laboratorit</i> <i>Evidencë 44: Lista e projekteve nderkombetare te aplikuar e te fituara</i> <i>Evidencë 85: Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGj</i> <i>Evidencë 124: Lista e aktiviteteve Keshilli Studentor UMT</i> <i>Evidencë 152: Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT2</i> <i>Evidencë 153: Model formular i aktivitetit shkencor</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Institucioni raporton se mbështet financiarisht aktivitetet studimore, kërkimore dhe shkencore, sipas buxhetit të miratuar. Organizimi i konferencave shërben si një metodë për të mbështetur këto aktivitete. Gjatë takimeve me stafin akademik u theksua se është ofruar mbështetje financiare nga Institucioni për pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe për publikimin e artikujve shkencorë. Njësia bazë merr mbështetje financiare nga institucioni dhe nuk administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. <i>Evidencë 5.1.: Praktike Rimbursimi per stafin akademik</i> <i>Evidencë 5.2.: Lista e personelit te rimbursuar FSHMT</i> <i>Evidencë 10: Revista shkencore FSHMT 2022,2023</i> <i>Evidencë 52: Praktike per miratimin e buxhetit vjetor UMT</i> <i>Evidencë 88: Te dhena Financiare per alokim buxheti FSHMT</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i>			
Konkluzione	<i>Prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit Master i Shkencave në "Teknik Laboratori" janë të përcaktuara qartë. FSHMT angazhohet në kërkimin shkencor në përputhje me fushën përkatëse dhe duke respektuar etikën e kërkimit shkencor. Studentët janë të përfshirë në aktivitete kërkimore, ndërsa stafi raporton mbi mbështetje financiare për këto iniciativa shkencore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

36

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	FSHMT raporton se mbledhja e të dhënave kërkimore nga studentët për detyrat e kursit dhe temave të diplomës, mbështet projektet dhe kontribuon në arritjen e objektivave të programit të masterit. Projektet kërkimore-shkencore realizohen në struktura mbështetëse dhe departamente të tjera, duke siguruar bashkëpunim me institucione të tjera kërkimore për realizimin e qëllimeve të programit të studimit. Pedagogët theksojnë se studentët mund të mbledhin të dhëna në qendrat spitalore me të cilat institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi. Gjithashtu, FSHMT ka projekte kërkimore të financuara nga AKKSHI, si dhe nga institucione ndërkombëtare. <i>Evidencë 44: Lista e projekteve nderkombetare te aplikuar dhe te fituara</i> <i>Evidencë 45: Lista e projekteve kombetare te aplikuar dhe te fituara</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve te QSU</i> <i>Evidencë 116: Projekti i Qëndres se Biosimulimit klinik dhe Edukimit ne vazhdim UMT</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i> <i>Evidencë 180: Rregullore per hartimin, zbatimin, menaxhimin e Projekteve UMT</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike është i angazhuar për të zhvilluar marrëveshje të reja bashkëpunimi me aktorë të rinj në fushën shkencore, duke u përgjigjur kërkesave për analiza, studime dhe projekte kërkimore shkencore. Personeli akademik realizon modele bashkëpunimi që mund të jenë afatshkurtra, afatmesme ose afatgjata. FSHMT gjithashtu bashkëpunon me institucione homologe për të promovuar kërkimin shkencor. Pedagogët e huaj angazhohen në mësimdhënie dhe organizojnë leksione të hapura, aktivitete që rrisin mundësitë për zhvillimin e kërkimit shkencor. FSHMT inkurajon gjithashtu pedagogët të marrin pjesë në mobilitete afatshkurtra jashtë vendit përmes programit Erasmus+. Ky program ka lejuar një numër të konsiderueshëm të stafit

	akademik të zhvillojë mobilitete jashtë shtetit, duke kontribuar në aktivitetet e tyre kërkimore. FSHMT aplikon periodikisht në projekte kërkimore shkencore si me partnerë të brendshëm ashtu edhe me ata ndërkombëtarë. <i>Evidencë 39: Njoftim per thirrje mobiliteti</i> <i>Evidencë 44: Lista e projekteve nderkombetare te aplikuara dhe te fituara</i> <i>Evidencë 45: Lista e projekteve kombetare te aplikuara dhe te fituara</i> <i>Evidencë 46: Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS</i> <i>Evidencë 48: Shembull marreveshje bashkepunimi me IAL nderkombetare</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 101: Lista e bashkepunime me institucione te tjera_FSHMT</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidencë 167: Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore UMT</i> <i>Evidencë 171: Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore FSHMT</i> <i>Evidencë 180: Rregullore per hartimin, zbatimin, menaxhimin e Projekteve UMT</i> <i>Evidencë 182: Rregullore mbi botimet mesimore-shkencore ne UMT</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike mbështet organizimin e konferencave ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale, si dhe aktivitete të ndryshme që ndihmojnë personelin akademik dhe studentët në arritjen e objektivave të vendosura. Studentët kanë marrë pjesë në aktivitete trajnuese të ndryshme, ndërsa personeli ka mundësi të angazhohet në konferenca dhe aktivitete të tjera me karakter kërkimor dhe shkencor. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 10: Revista shkencore FSHMT 2022,2023</i> <i>Evidencë 15: Aktivitete_studente_libri_i_abstrakteve_konferenca e shkencave mjekesore</i> <i>Evidencë 16: Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve. FSHMT</i>

	<i>Evidencë 18: Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT</i> <i>Evidencë 30: Konferenca-vjetore-2023-FSHMT-ne-bashkepunim-me-UV-dhe-UISH</i> <i>Evidencë 85: Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGj</i> <i>Evidencë 152: Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT2</i> <i>Evidencë 153: Model formular i aktivitetit shkencor</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” ka si qëllim përgatitjen e profesionistëve dhe specialistëve teknikë laborantë që disponojnë njohuritë e kompetencat e nevojshme për të punuar në klinika spitalore e në laboratorë klinikë e biokimikë, publik e privat. Programi i studimit Master i Shkencave në Teknik Laboratori synon të rrisë kompetencat profesionale të teknikëve laborantë përmes njohjes më të plotë të protokolleve të punës në laborator, interpretimit diagnostik të analizave dhe përshtatjes me teknologjitë moderne dhe bashkëkohore. Gjithashtu ky program fokusohet në përmirësimin e minimizimit të gabimeve mjekësore dhe rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor që ofrohet pacientëve përmes një gamë të gjerë ekzaminimesh laboratorike, duke përgatitur kështu kandidatë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	FSHMT merr parasysh dhe angazhohet për të zbatuar rekomandimet nga shoqatat profesionale mjekësore dhe rrjetet profesionale me të cilat ka ndërtuar një bashkëpunim të konsoliduar, në lidhje me kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së teknikut të laboratorit. Në këtë kontekst, përmendim bashkëpunimin e suksesshëm me UISH për anëtarësimin e studentëve të diplomuar, koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin e praktikës profesionale, si dhe organizimin e provimit të shtetit në QSHA, procesin e licencimit. <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe	FSHMT ka si qëllim përshtatjen e programeve në përputhje me kornizën ligjore dhe direktivat e rregulloreve të Bashkimit Evropian për profesionet e rregulluara. Si pjesë e Universitetit të Mjekësisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike bashkëpunon në mënyrë

rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	të koordinuar me MAS për të realizuar përshtatjen e programeve sipas direktivës " <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ". <i>Evidencë 1: Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>			
Konkluzione	FSHMT angazhohet të inkurajojë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e vazhdueshme të stafit akademik dhe studentëve në aktivitete kërkimore shkencore që zhvillohen në mënyrë periodike, duke i përgatitur ata për të qënë konkurrues në tregun e brendshëm dhe të jashtëm të punës. FSHMT gjithashtu angazhohet për të krijuar marrëveshje të reja për zhvillimin e veprimtarisë shkencore dhe mbështet organizimin e konferencave dhe aktiviteteve të tjera kërkimore e shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qëndër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për të siguruar një përvetësim sa më të mirë të njohurive, format e mësimdhënies, mësim nxënies dhe transmetimit të dijeve parashikojnë, siç është përshkruar në VKM 41 të ndryshuar, leksione, seminare, laboratorë, projekte, praktika profesionale e klinike, leksione të hapura dhe konferenca studentore, të cilat realizohen në përputhje me planin mësimor. UMT dhe FSHMT ndjekin një politikë të qartë dhe hartojnë udhëzues institucional për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, të cilat bazohen në fushën e studimeve dhe lëndët/modulet. Gjatë ciklit të dytë të studimeve,

	studentët janë të inkurajuar të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në fushën përkatëse. Orët e mësimit janë të përshtatura sipas natyrës së lëndëve, me qëllim angazhimin e të gjithë studentëve për arritjen e një nxënie efektive. Çdo syllabus përcakton qartë format e metodologjinë e mësimeve, e cila ndryshon nga lënda në lëndë dhe respekton lirinë akademike. Kontrolli i dijeve është një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit. <i>GVJ rekomandon që institucioni të hartojë një udhëzues për unifikimin e veprimtarive akademike në nivel institucional, për të siguruar që kontrolli i dijeve të jetë i vazhdueshëm dhe të lejojë studentët të identifikojnë e plotësojnë mangësitë e tyre para përfundimit të semestrit.</i> <i>Evidencë 18: Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT</i> <i>Evidencë 86: Programi Msc Teknik Laboratori 2020-2022</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 191: VKM-nr.41-date-24.1.2018</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimit dhe mësimit.	Duke u bazuar në programin e studimit për Masterin e Shkencave në "Teknik Laboratori" dhe feedback-un e marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme mësimesh dhe mësimit, përveç metodave tradicionale, si referimet verbale të studentëve, projekte studimi në grup, mjete audio-vizuale, metodat e simulimit dhe role-play. FSHMT raporton se personeli akademik respekton diversitetin dhe nevojat e studentëve duke përdorur forma, mënyra e metoda alternative të mësimit për të siguruar gjithë përfshirjen. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime të organizuara nga personeli akademik, që i ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve themelore të lëndëve, njohurive dhe aftësive praktike. Në përfundim të çdo lënde/moduli, parashikohet zhvillimi i provimit përfundimtar përkatës. Gjithashtu, janë përcaktuar format e kontrollit të dijeve përmes testimeve ndërmjetëse, punëve laboratorike, mbrojtjes së detyrave dhe projekteve të kursit, mbrojtjes së praktikave profesionale, etj. <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>

Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	FSHMT thekson se ofron mbështetje dhe mundësi për mobilitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik në universitetet partnere, me qëllim përmirësimin e kompetencave didaktike. Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, personeli akademik aplikon forma të ndryshme, të cilat priten mirë nga studentët. Kjo mbështetet gjithashtu nga infrastruktura që ka në dispozicion, e cila lehtëson përdorimin e teknologjisë dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies. UMT ofron sistemin LMS, i cili gjatë pandemisë Covid-19 e bëri më të lehtë kalimin në mësimdhënie online. Po ashtu, personeli akademik merr trajnim të vazhdueshëm nga institucioni, me qëllim që të përmirësojë aftësitë e stafit në fusha që lidhen me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. <i>GVJ konstaton se institucioni nuk ka ndonjë udhëzues apo plan specifik për përmirësimin e kompetencave didaktike të stafit akademik.</i> <i>Evidencë 60: Pyetesor mbi mundësinë e zhvillimit të provimeve online gjatë pandemisë covid19</i> <i>Evidencë 118: Infrastruktura në funksion të mesimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë</i> <i>Evidencë 147: Pershkrim i funksionaliteteve të platformes E-UMT</i> <i>Evidencë 148: Pershkrim funksionaliteteve të platformes EasyWeb LMS</i> <i>Evidencë 154: Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT</i> <i>Evidencë 156: Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike.</i>
---	--

Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	FSHMT përcakton kriteret e detajuara për rekrutimin e personelit të angazhuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme në mësimdhënien akademike. Sipas CV-ve të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, ata zotërojnë kompetencat e nevojshme për të shpjeguar njohuritë në këtë nivel studimi. Personeli akademik është i hapur ndaj aplikimit të formave, metodave dhe mënyrave alternative të mësimdhënies, duke u përshtatur me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi, si dhe me modulet dhe aktivitetet formuese në veçanti. Zhvillimi i orëve interaktive stimulon angazhimin intensiv të studentëve, duke i shoqëruar ata me diskutime, studime rastesh, punë në grupe dhe prezantime. Studentët vlerësojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorëve. Rezultatet e anketimeve të realizuara nga NJSBC me studentët, si dhe konsultimet ndërmjet stafit akademik të programit, ndihmojnë personelin akademik për të përmirësuar aspektet e mësimdhënies, duke përfshirë edhe mendimet e studentëve. Këto mendime lidhen kryesisht me ndryshimet në programet e lëndëve të caktuara dhe në kurrikulën e programit. <i>Evidencë 40: Nderfaqë sistemi PITAGORA</i> <i>Evidencë 42: Nderfaqë EasyWeb (per lenden)</i> <i>Evidencë 67: Shembull _Pyetesor Vleresim i studentëve per lendet e programit te studimit _formular</i> <i>Evidencë 96: CV e personelit akademik</i> <i>Evidencë 114: Bibliotekat online - lista dhe pershkrim</i> <i>Evidencë 148: Pershkrim funksionaliteve te platformes EasyWeb LMS</i> <i>Evidencë 163: Praktikë e punësimit të personelit akademik në UMT</i> <i>Evidencë 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, duke qënë njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” në bashkëpunim edhe me NJSBC, realizon kontrole periodike mbi planin e aktiviteteve të personelit akademik duke qënë në gjendje të vlerësojë dhe përmirësojë rregullisht format dhe metodat e mësimdhënies. Në këtë proces bazuar në pyetësorët e plotësuar nga studentët, janë integruar gjithashtu edhe reflektimet e studentëve. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti _DDRSHIKIOGJ</i>

	<i>Evidencë 11: Praktike per miratimit e planeve mesimore</i> <i>Evidencë 14: Shembull_formulari i performances 2023</i> <i>Evidencë 67: Shembull_Pyetesor Vleresim i studentëve per lendet e programit te studimit_formular</i> <i>Evidencë 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	NJSBC e cila është edhe njësi përgjegjëse në nivel institucional, por edhe në bashkëpunim me njësitë e tjera të UMT, si Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, kanë si detyrë promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Ajo gjithashtu kryen vlerësime periodike dhe analitike të veprimtarive mësimore dhe kërkimore dhe propozon ndryshime për përmirësime. UMT dhe FSHMT angazhojnë stafin e tyre përmes organizimit të eventeve të ndryshme, si promovimi i librave dhe revistave, organizimi i tryezave të debatit me aktorë të ndryshëm të biznesit për çështje aktuale, dhe ftesa për personalitete të njohura nga fusha të caktuara të shkencës. Një nga prioritetet kryesore të strategjisë së zhvillimit të UMT është kualifikimi i mëtijshëm i stafit akademik. UMT dhe FSHMT në mënyrë të vazhdueshme nxisin kualifikimin e stafit akademik, me fokus në organizimin e konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, promovimi i personelit akademik mbështetet financiarisht për aktivitete të ndryshme shkencore dhe trajnuese, si edhe për hartimin e teksteve mësimore akademike. Studentët e Programit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” organizojnë takime dhe orë të hapura për të implementuar në praktikë zhvillimet më të fundit të teknologjisë, si dhe për të promovuar projekte dhe praktika inovative. <i>Evidencë 5.1: Praktike Rimbursimi per stafin akademik</i> <i>Evidencë 18: Konferenca vjetore libri i abstrakteve_FSHMT</i> <i>Evidencë 19: Aktiviteti dt 14 Nentor 2023 në FSHMT</i> <i>Evidencë 76: Plan veprimi 21-23 per Rritjen e Cilesise Arsimit te Larte</i> <i>Evidencë 108: Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidencë 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i> <i>Evidencë 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i>

Konkluzione	UMT dhe FSHMT ndjekin një politikë të qartë dhe zhvillojnë udhëzues në nivel institucional për përdorimin dhe zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Një komponent kyç në këtë proces është infrastruktura që ka në dispozicion personeli akademik, e cila mundëson përdorimin e teknologjisë dhe metodave bashkëkohore të mësimdhënies. FSHMT si njësi kryesore përgjegjëse për programin e studimit, vlerëson e përmirëson në mënyrë periodike format e metodat e mësimdhënies përmes planit të aktiviteteve të personelit akademik, kontrolleve të vazhdueshme dhe pyetësorëve të studentëve, duke bashkëpunuar gjithashtu me “NJSBC”, “Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave” dhe “Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin”. GVJ rekomandon: 1. Hartimin e një plani specifik ose udhëzues për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit. 2. Hartimin e një udhëzuesi për unifikimin e veprimtarive akademike në nivel institucional, në mënyrë që kontrolli i dijeve të jetë i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe metodat për testimin dhe vlerësimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” përcaktohen në rregulloren e programit, në syllabuset e lëndëve dhe në metodikën e zhvillimit të veprimtarive akademike. Këto kriteret përfshijnë vlerësimin e studentëve gjatë gjithë vitit, përmes punës në auditor, përgatitjes së detyrave të kursit, punëve laboratorike, praktikave profesionale dhe provimit përfundimtar. Mënyrat e vlerësimit paraqiten në mënyrë të detajuar në syllabuset e secilës lëndë, në përputhje me specifikimet e tyre. Informacioni është i disponueshëm edhe në LMS dhe në web-faqen e UMT.

	UMT dhe FSHMT gjithashtu përdorin dhe zbatojnë një sistem të automatizuar për testimin e vlerësimit të njohurive, dhe për korrigjimin e provimeve përmes aplikimit të projektit CleanScore. <i>Evidencë 2: Rregullore-e-Universiteti te Mjekesise Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti _DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i> <i>Evidencë 145: Relacion cleanscore</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të çdo semestri, studentët prezantohen me syllabusin përkatës nga titullari i lëndës/modulit, ku janë përcaktuar në detaje temat që do të zhvillohen, metodat e kontrollit dhe format e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe njohurive shkencore. Studentët gjithashtu informohen edhe për afatet e plotësimit të secilit detyrim deri në përfundimin e zhvillimit të lëndës. <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Sylabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve realizohet sipas rregullores së programit të studimit, përmes detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike, praktikës profesionale, provimeve të ndërmjetme dhe provimit përfundimtar (mbrojtje teme diplome). Kjo mënyrë vlerësimi e njohurive i ofron studentëve mundësinë të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Metodat e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve për secilën lëndë/modul përcaktohen sipas një modeli të detajuar nga departamenti, me gjithsej 100 pikë. Megjithatë, përcaktimi i peshës specifike për secilin komponent të mësimdhënies (si leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike dhe provimi përfundimtar) mbetet në kompetencën e pedagogut përgjegjës të lëndës. <i>GVJ rithekson paqartësinë që ka evidentuar në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së ngarkesës mësimore sipas veprimtarive formuese.</i>

Konkretisht nisur nga shqyrtimi i syllabuseve për vitet akademik 2022-2024 konstatohen lëndë që nuk ndjekin të njëjtin standard për mënyrën e kontrollit të dijeve në detyrimet respektive, si p.sh.:

- Në pjesën më të madhe të lëndëve si: Psikologji Shëndeti / Menaxhim, Organizim dhe Promocion Shëndetësor / Testet Laboratorike në Geriatri / Imunologji e Avancuar dhe Diagnostike, etj, vlerësimi me Provim të Ndërmjetëm (në disa raste mungon) 15% / Seminar ose Praktikë 5% / Provimi Përfundimtar 80%.
- Komunikim Profesional – mungon vlerësimi në të gjitha detyrimet respektive dhe pesha e kontrollit të vazhdueshëm shkon 100% për Provimin Përfundimtar.
- Testet Laboratorike në Obstetrikë dhe Gjinekologji / Ekzaminimi Laboratorik në Aparatin Kardiovaskular dhe Pulmonar / Biokimi Klinike e Avancuar / Gjenomikë, etj., totalisht një formë ndryshe e vlerësimit të kontrollit të vazhdueshëm, Provimi i Ndërmjetëm 15% / Frekuentimi 5% / Aktivizimi 5% / Detyra e Kursit 5% / Provimi Përfundimtar 70%.
- Algoritma Diagnostikë dhe Laboratorikë / Epidemiologji, etj., Provim të Ndërmjetëm ose Praktika dhe Detyrë Kursi 10% / Provimi Përfundimtar 90%.
- Bioetikë / Ekzaminimi Laboratorik në Toksikologji / Biologji Molekulare - mungon vlerësimi me Provim të Ndërmjetëm (në disa raste) – Seminar 10% / Praktikë / Detyrë Kursi 10% / Provimi Përfundimtar 80%.
- Diagnostikë Molekulare - mungon vlerësimi me Provim të Ndërmjetëm – Seminar 20% / Provimi Përfundimtar 80%.
- Një formë totalisht e re e vlerësimit të kontrollit të vazhdueshëm konstatohet në lëndët: Shkrim Akademik – Provimi i Ndërmjetëm 30% / Seminar 10% / Provimi Përfundimtar 60%, ndërsa në lëndën Metodologji e Kërkimit Shkencor - Kolokiume 10% / Seminare 10% / Detyrë Kursi 20% / Provim Final 50% (90% në total).
- Ekzaminimet Laboratorike në Pediatri dhe Urgjencë Pediatrike, etj., nuk paraqitet fare vlerësimi i kontrollit të vazhdueshëm.

Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ

Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve

Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur

Konkluzione	<i>Kriteret dhe metodat për testimin dhe vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore janë të përcaktuara qartë në rregulloren e departamentit dhe atë të programit të studimit. Studentët janë të informuar mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, ndërsa pedagogët aplikojnë metoda alternative të vlerësimit në përputhje me syllabuset.</i> <i>GVJ rekomandon unifikimin e shpërndarjes së veprimtarive akademike në nivel institucional, duke përfshirë mësimdhënien, mësim nxënien dhe vlerësimin e njohurive. Kjo do të sigurojë që kontrolli i dijeve të jetë i vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit dhe që shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas veprimtarive formuese të jetë e unifikuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët e Master Shkencor “Teknik Laboratori” testohen vazhdimisht gjatë vitit akademik përmes projekteve, detyrave, punëve laboratorike, provimeve të ndërmjetme dhe atij final. Format dhe metodat e vlerësimit u bëhen të njohura studentëve që në fillim të lëndës. Nota përfundimtare përbëhet nga Aktivizimi në Seminare, Frekuentimi, Punët e Labororit e Detyrat e Kursit, Provimi i Ndërmjetëm (jo gjithmonë) dhe Provimi Përfundimtar (por jo të unifikuar midis syllabuseve). <i>GVJ konstaton se ka mungesë të një formati të unifikuar të vlerësimit midis lëndëve të ndryshme dhe se provimi i ndërmjetëm nuk zhvillohet gjithnjë. Ky proces do të lehtësonte mësim nxënien e studentëve dhe do të ofronte një kontroll të vazhdueshëm të dijeve gjatë semestrit ose vitit akademik.</i> <i>Për këtë arsye, GVJ rekomandon që institucioni të hartojnë një udhëzues për unifikimin e procesit të vlerësimit, duke përfshirë të gjithë komponentët e nevojshëm në nivel institucional. Kjo do t'i lejojë studentët të identifikojnë mangësitë dhe t'i adresojnë ato para përfundimit të lëndës.</i>

	<i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UMT ka implementuar për disa vite një sistem të automatizuar për korrigjimin e provimeve, me qëllim që të minimizojë abuzimin dhe subjektivizmin në vlerësimin e studentëve, falë projektit CleanScore të financuar nga AADF. Po ashtu, për të rritur transparencën dhe për të shmangur forma të ndryshme abuzimi gjatë procesit të vlerësimit, institucioni përdor edhe platformën Pitagora. <i>Evidencë 36: Platforma_eUMT_VSA</i> <i>Evidencë 40: Nderfaqë sistemi PITAGORA</i> <i>Evidencë 42: Nderfaqë EasyWeb (per lenden)</i> <i>Evidencë 145: Relacion cleanscore</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Institucioni ka lejuar që vlerësimi përfundimtar i lëndës të realizohet me anë të testimit përfundimtar, proces që zhvillohet në përputhje me syllabusin si dhe sipas rregullores së studimeve të FSHMT, rregullores së Departamenteve dhe rregullores së programit të studimit. Testimi dhe vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga një komision provimesh i përbërë nga të paktën 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit të zhvilluar dhe anëtari tjetër është staf efektiv i departamentit me gradë shkencore apo titull akademik. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve</i> <i>Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, stafi akademik i ofron studentëve komente gjatë orëve të seminarit, lidhur me performancën e tyre në përvetësimin e njohurive gjatë seminareve dhe testeve të ndërmjetme, si dhe në nivelin e përgatitjes dhe prezantimit të detyrave dhe projekteve të kursit, si edhe punëve të laboratorit. Po ashtu, ata ofrojnë këshilla dhe orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Pas korrigjimit të provimit, organizohen seanca sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje tezën e korrigjuar dhe të marrin komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre prej pedagogut.

	<i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve</i> <i>Evidencë 61: Procedurë ankimi i studentit për vlerësimin</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Institucioni dhe stafi akademik raportojnë se nuk kanë akses në sisteme dhe platforma që mundësojnë kontrollin e plagjiaturës. UMT gjithsesi ka miratuar një kod etike për kërkimin shkencor. Mjedisi ku zhvillohet testimi monitorohet nga dy ose më shumë pedagogë, të cilët emërohen me miratim nga Departamentet përkatëse, dhe këta anëtarë të stafit akademik janë përgjegjës për menaxhimin e procesit të provimit. Pas dhënies së tezës, nuk lejohet që studentë të tjerë të kursit të futen në provim. Anëtarët e komisionit të provimit të modulit mbikëqyrin zhvillimin e saktë të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e tij. Një student nuk lejohet të marrë pjesë në dy provime të ndryshme në të njëjtën ditë. Hyrja në provim e personave të jashtëm, përfshirë anëtarë të stafit akademik nuk lejohet, përveçse për drejtuesit e Departamenteve, drejtuesin e Fakultetit ose individëve të autorizuar me shkrim nga Dekani i FSHMT për të siguruar rregullsinë e zhvillimit të provimeve. Rregulla të rëndësishme dhe të detajuara për zhvillimin e provimeve janë përcaktuar në rregulloren përkatëse. Studentët e dinë se kopjimi është kategorikisht i ndaluar dhe ndëshkohet. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve</i> <i>Evidencë 72: Kodi i Etikes-UMT 2022</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në rregulloren e programit të studimit është e përcaktuar procedura e testimit, kontrollit të dijeve dhe vlerësimit. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet nëpërmjet sistemit të notave, ku nota kaluese më e ulët është nota pesë. Rezultatet e provimit bëhen të njohura për studentët nga komisioni përkatës pas përfundimit të provimit, brenda dy javëve. Për riprovimet, rezultatet shpallen pas një jave. Pas zhvillimit të seancave sqaruese dhe ankimuese me studentët, pedagogu i lëndës ose modulit vazhdon me regjistrimin e vlerësimit përfundimtar në sekretari dhe në sistemin Pitagora. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i>

	<i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 40: Nderfaqë sistemi PITAGORA</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pedagogët regjistrojnë rezultatet e provimit në sistemin Pitagora brenda një jave, bazuar në Rregulloren e FSHMT. Pas shpalljes së rezultateve paraprake, studentët kanë obligimin të kontrollojnë notën e tyre në sistem dhe të paraqesin një ankesë të mundshme brenda 48 orëve (<i>periudhë që mund të bëjnë kontestimin e rezultatit</i>). Ankesa duhet të jetë me shkrim dhe t'i drejtohet Drejtuesit të Departamentit përkatës, i cili e vlerëson atë dhe merr vendimin përkatës, duke ngarkuar një komision për rivlerësimin e provimit dhe përballje me studentin. Në takimet me Drejtuesit e Njësive Kryesore/Bazë, pedagogët dhe studentët raportuan se nuk ka pasur asnjëherë ankesa, ndaj nuk ekziston një dokumentim i kësaj procedurë. Në përfundim të këtij procesi, nota merret si përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të mbyllë përfundimisht procesverbalin përkatës. <i>Evidencë 2: Rregullore-e-Universiteti te Mjekesise Tirane</i> <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve</i> <i>Evidencë 40: Nderfaqë sistemi PITAGORA</i> <i>Evidencë 61: Procedurë ankimi i studentit per vleresimin</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Studenti ka të drejtë të kontestojë vlerësimin e tij, nëse e konsideron atë të pamërituar. Ankesa duhet të dorëzohet me shkrim brenda 48 orëve pas shpalljes së rezultateve, drejtuar drejtuesit të Departamenteve dhe Dekanit. Drejtuesit e Departamenteve shqyrtojnë nëse ankesa është e justifikueshme dhe ngarkon një komision për të rivlerësuar provimin dhe për të organizuar një përballje me studentin. Ky vendim është përfundimtar dhe duhet të depozitohet në njësinë bazë dhe sekretarinë mësimore. Procesverbalet e rivlerësimit nënshkruhen dhe dorëzohen në sekretarinë mësimore për arkivim, ndërsa procesi shoqërohet me regjistrimin e rezultatit të ri në sistem. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 61: Procedurë ankimi i studentit per vleresimin</i>

Konkluzione	<i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale kryhet gjatë gjithë vitit akademik. Vlerësimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin përmes provimit përfundimtar të lëndës/modulit.</i> <i>UMT ka implementuar një sistem elektronik për kontrollin e dijeve, duke përfshirë korrigjimin automatik CleanScore dhe përdorimin e platformës Pitagora, me qëllim minimizimin e abuzimit dhe subjektivitetit në vlerësimin e studentëve.</i> <i>Në rastet e ankesave, studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të tezës dhe të marrin komente pas procedurës së ankimit.</i> <i>GVJ sugjeron hartimin dhe ndjekjen e një formati të njëtrajtshëm vlerësimi për lëndët e ndryshme, për të lehtësuar procesin e të nxëniet të studentëve dhe për të siguruar një kontroll të vazhdueshëm të dijeve gjatë gjithë semestrit ose vitit akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” përfshin lëndë dhe module që i mundësojnë studentëve të thellojnë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale. Plani mësimor i këtij programi përfshin 24 lëndë, duke përfshirë praktikën profesionale dhe provimin përfundimtar me mikrotezë, ku studentët thellojnë njohuritë dhe përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale dhe specifike në profilin e teknikës laboratorike (<i>me fokus kryesor në aspektet klinike, biokimike, mikrobiologjike dhe histobiopatologjike</i>), si dhe synojnë përparimin e studentëve në kërkimin shkencor. Ky program studimi gjithashtu nxit aplikimin e njohurive praktike dhe zhvillimin e aftësive kërkimore shkencore, duke përgatitur të diplomuarit me aftësitë e nevojshme për një integrim të suksesshëm në tregun aktual të punës. Kjo sigurohet përmes zhvillimit të lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbushjes së detyrimeve përfundimtare. <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i>

	<i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Institucioni deklaron se, bazuar në planin mësimor, programi i studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” përfshin kredite të dedikuara për lëndët sociale dhe ato të komunikimit. Kjo kurrikulë siguron zhvillimin e aftësive të veçanta, përveç atyre specifike për profilin, duke ofruar module në fushat e shkencave sociale dhe ndërveprimit. Në kuadër të kurrikulave të programit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, studentët ndjekin lëndë në fusha të specializuara si “Komunikimi Profesional”, “Bioetika”, “Psikologjia e Shëndetit”, “Organizim, Menaxhim dhe Promocion Shëndetësor”, “Dietologji”, “Antropologji Mjekësore”, të cilat kontribuojnë në formimin e tyre të përgjithshëm. <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i> <i>Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Gjatë javës së fundit të semestrit, pedagogët e moduleve përkatëse realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që studentët pritej të arrijnë deri në fund të modulit. Gjithashtu studentët orientohen për çështjet kryesore që do të jenë në fokus gjatë përgatitjes për provimin final, duke përfshirë strukturën dhe natyrën e pyetjeve të provimit si dhe peshën që ato mbajnë në vlerësimin përfundimtar. Në syllabuset e çdo lënde, studentët kanë paraprakisht akses në informacionin mbi kompetencat dhe aftësitë që ofrohen në modulin përkatës. <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 92: Syllabuse MSC TEKNIKE LABORATORI_firmosur</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të	Mësimdhënia bazohet në kombinimin e njohurive të fituara në auditor, laborator dhe gjatë praktikave profesionale, me qëllim arritjen e kompetencave të synuara. Kjo qasje didaktike u mundëson studentëve të zhvillojnë aftësitë e tyre. Për disa module të veçanta të kurrikulës, pasi studentëve u jepet informacioni teorik për grupet e kompetencave, ata testohen për zbatimin praktik të këtyre kompetencave në laboratorët ku zhvillohet praktika. Punët laboratorike dhe praktikat profesionale realizohen me grupe të vogla studentësh. Siç është theksuar, infrastruktura laboratorike e dedikuar për teknikun e laboratorit në institucion është e kënaqshme.

përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Duke qënë se shumica e personelit akademik është gjithashtu e angazhuar në shërbime spitalore dhe ka njohuri të gjera për teknikat dhe teknologjitë më të fundit të përdorura në diagnostikë, ata vazhdimisht mbështesin, udhëzojnë dhe drejojnë studentët në realizimin e detyrave të caktuara apo në zbatimin praktik të njohurive teorike. Institucioni dhe stafi akademik bashkëpunojnë me partnerët për të mundësuar dhe përmirësuar mobilitetin e studentëve. Gjithashtu, është vërejtur një rritje e pjesëmarrjes së stafit akademik në mobilitete jashtë vendit në kuadër të projektit Erasmus+ KA1 gjatë viteve të fundit. <i>Evidencë 44: Lista e projekteve nderkombetare te aplikuara dhe te fituara</i> <i>Evidencë 44.1: Projekte nderkombetare te fituara</i> <i>Evidencë 45: Lista e projekteve kombetare te aplikuara dhe te fituara</i> <i>Evidencë 47: Marreveshje per diploma te perbashketa Univ Bologna</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 97: Tabela permbledhese ASCAL Msc Teknik laborator</i> <i>Evidencë 117: Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet - UMT.</i> <i>Evidencë 118: Infrastruktura ne funksion te mesimdhënies, Universiteti i Mjekesise, Tirane.</i> <i>Evidencë 119: Lista e aseteve infrastrukturore te UMT dhe planimetrite.</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i> <i>Evidencë 167: Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore UMT</i> <i>Evidencë 184: Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për stafin akademik</i> <i>Evidencë 185: Udhëzues për plotësimin e planit të mobilitetit për studentët</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë	FSHMT organizon orë të hapura për studentët e interesuar për zhvillimet më të fundit në fushën e Teknikës së Laboratorit. UMT fton pedagogë nga universitete dhe institucione shëndetësore partnere në kuadër të projekteve ose konferencave të ndryshme që organizohen, të cilët mbajnë leksione për studentët me përmbajtje të dakordësuar paraprakisht me departamentin.

brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Qëllimi është që leksionet jashtë programit të studimit të përfshijnë zhvillimet më të fundit në shkencë dhe/ose teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e saj në mjekësi, duke u fokusuar në zhvillimet më të reja të teknologjisë brenda strukturës së programit të studimit. <i>Evidencë 37: Shembull Kerkese miratim aktiviteti fshmt staf</i> <i>Evidencë 108: Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT</i> <i>Evidencë 153: Model formular i aktivitetit shkencor</i> <i>Evidencë 154: Analize per aktivitetin kerkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik te UMT</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni dhe pedagogët e fakultetit mbështesin studentët në idetë e tyre inovatore dhe në kërkimet shkencore, duke i përfshirë ata në realizimin e projekteve kërkimore, rezultatet e të cilave, në disa raste, publikohen në Buletinin e UMT. Gjithashtu, institucioni u ofron studentëve mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete shkencore të financuara nga UMT, si për shembull konferenca studentore. <i>Evidencë 10: Revista shkencore FSHMT 2022,2023</i> <i>Evidencë 16: Info-Session për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve. FSHMT</i> <i>Evidencë 18: Konferenca vjetore libri i abstrakteve FSHMT</i> <i>Evidencë 152: Lista e botimeve të revistes shkencore të FSHMT2</i>			
Konkluzione	FSHMT, si njësi përgjegjëse për këtë program studimi, organizon orë të hapura për studentët e interesuar në zhvillimet e fundit të diagnostikës laboratorike. UMT vazhdimisht fton pedagogë nga universitete/institucione shëndetësore partnere për të marrë pjesë në projekte ose konferenca, duke zhvilluar leksione me studentët. Programi i Masterit Shkencor në "Teknik Laboratori" ofron thellimin e njohurive dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe shkencore të studentëve. Gjithashtu vazhdimisht studentët angazhohen në kërkime shkencore nën mbikëqyrjen e pedagogëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	UMT ka përgatitur në rregulloren e studimeve procedurën për detyrimet përmbyllëse para realizimit të tyre dhe publikimin e këtyre procedurave për studentët e FSHMT. Këto rregulla janë gjithashtu të përfshira në rregulloren e FSHMT, në rregulloren e programit të studimit, si dhe në suplementin e diplomës. Studentët informohen për këto rregulla në fillim të studimeve. Për të marrë diplomën në Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, studenti duhet të kalojë me sukses provimin përfundimtar me anë të mbrojtjes së “Temës së Diplomës”, në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor. Për të pasur të drejtën për të hyrë në provimin përfundimtar, studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët dhe në praktikën profesionale, duke përmbyllur kështu kreditet e nevojshme. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidencë 9: Udhezues për hartimin e temës së diplomes</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laboratorori</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas rregullores së programit të studimeve, Dekani, Drejtuesit e Departamenteve dhe stafi akademik ofrojnë mbështetje për studentët gjatë periudhës së studimeve. Drejtuesi i Departamentit është përgjegjës për sigurimin e informacionit, udhëzimeve dhe materialeve të nevojshme për të garantuar një proces të suksesshëm gjatë provimit të përgjithshëm përfundimtar me “Temë Diplome”. Departamentet sigurojnë që studentët të informohen dhe të pajisen me të gjitha detyrimet përmbyllëse. Dokumentacioni udhëzues lidhur me përmbylljen e këtyre detyrimeve paraqitet në rregulloren e programit të studimit për Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”. Gjithashtu, Drejtuesi i Departamentit disponon evidencën përkatëse me temat specifike të miratuara për mbrojtjen e diplomës të studentëve në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës. FSHMT ka përcaktuar në rregulloren e saj që një pedagog efektiv nuk mund të udhëheqë më shumë se pesë student.

	<i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 9: Udhezues per hartimin e temes se diplomes</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studenti ka të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar vetëm nëse ka marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët dhe në praktikën profesionale, duke përmbushur kështu kreditet e nevojshme. Për të marrë diplomën në Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, studenti duhet të kalojë me sukses provimin përfundimtar me anë të mbrojtjes së temës së diplomës. Komisioni i propozuar nga Departamenti dhe miratuar nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore është përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e të gjithë procesit të zhvillimit të mbrojtjes së diplomës, shpalljes së rezultateve dhe trajtimit të ankesave. Vlerësimi final i studentëve realizohet përmes administrimit të provimit të mbrojtjes së temës së diplomës, i cili fokusohet në vlerësimin e punimit shkencor në tërësi dhe referimit të temës së diplomës. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 9: Udhezues per hartimin e temes se diplomes</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve</i> <i>Evidencë 91.2: plani mesimor teknik laborator 2022 -2024</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, orienton studentët në fund të vitit të parë duke u vendosur në dispozicion evidencën përkatëse me temat specifike të miratuara (si raste klinike ashtu edhe rishikim literature) për mbrojtjen e diplomës të studentëve në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës. Në mënyrë të vazhdueshme, pedagogët udhëheqës asistojnë studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin statistikor të tyre, si edhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve miratuar në rregulloren e FSHMT. Në fund pedagogu udhëheqës bën një vlerësim paraprak të punimit duke garantuar cilësinë e rezultateve dhe jep dakordësinë për prezantimin oral të punimit shkencor para komisionit. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 9: Udhezues per hartimin e temes se diplomes</i>

	<i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 31: Procedura e provimeve dhe kontrollit te dijeve</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Gjatë zhvillimit të punimit të diplomës pedagogu udhëheqës përkatës jep udhëzimet dhe asistencën e nevojshme, ku studenti merr trajnimin e duhur për aspektet metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore, punën në klinika, shkrimin dhe nxjerrjen e rezultateve. FSHMT vendos në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës teorike dhe praktike të punimit shkencor të temës së diplomës, infrastrukturën dhe mjetet e nevojshme didaktike, si edhe bazën materiale të laboratorëve, si edhe bibliotekën fizike dhe online të FSHMT. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 9: Udhezues per hartimin e temes se diplomes</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 24: Udhezues_biblioteka_online</i> <i>Evidencë 113: Biblioteka FSHMT</i> <i>Evidencë 114: Bibliotekat online - lista dhe pershkrim</i> <i>Evidencë 115: Komunikimi zyrtar per U-Library</i> <i>Evidencë 117: Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet - UMT</i> <i>Evidencë 118: Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies, Universiteti i Mjekesise, Tirane</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Teknik Laboratori”, parashikohet që studentët pas përfundimit të provimit të përgjithshëm përfundimtar vlerësohen me notë, ku nota 5 është kaluese dhe nota 10 paraqet vlerësimin maksimal. Në suplementin e diplomës shënohen edhe kreditet respektive. <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laborarori</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion	Në rregulloren e përgjithshme dhe atë të programit të studimit, është përcaktuar qartë se studentët që përfundojnë të gjitha detyrimet e programit të studimit pajisen me Diplomën Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” e me suplementin/certifikatën e notave. Diploma përmban të dhënat e sakta të studentit në përputhje me formatin e miratuar nga MAS. Ajo nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i UMT.

kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në çdo diplomë shënohen emri, mbiemri, grada dhe titulli shkencor i Drejtuesit UMT. Nënshkrimi i Rektorit është i shoqëruar me vulën e institucionit. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 6: Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidencë 21: Rregullore Msc Teknik Laboratori</i> <i>Evidencë 22: format suplementi Msc teknik laborarori</i> <i>Evidencë 22.1: Format liste notash Msc Teknik laborator</i> <i>Evidencë 22.2: Format diplome msc teknik laborator</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	UMT arkivon dokumentacionin në përputhje me legjislacionin aktual, ku njësia përgjegjëse është sekretaria mësimore. Kjo e fundit mban regjistrat bazë të studentëve me të dhënat personale, regjistrin e vlerësimeve të marra gjatë studimeve, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave apo certifikatave të lidhura me diplomën ose diplomat e marra, të gjitha të formatuara sipas akteve nënligjore në fuqi. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, u vërtetua se aty arkivohen edhe dokumentet e plota të studentëve të diplomuar, përfshirë listat e notave dhe dokumentacionin e aplikimit, etj. Regjistrat e studentëve plotësohen në format të shkruar dhe elektronik, duke u mbajtur në ruajtje të përhershme. Çdo student që regjistrohet në UMT merr një numër unik matrikullimi, i cili e shoqëron deri në marrjen e diplomës. Të dhënat ruhen gjithashtu në format elektronik në sistemin e brendshëm të institucionit. <i>Evidencë 5: Rregullore FSHMT</i> <i>Evidencë 36: Platforma_eUMT_VSA</i> <i>Evidencë 109: Analize vjetore sekretaria mesimore</i> <i>Evidencë 188: Rregullore e sekretarise mesimore</i>
Konkluzione	UMT ka përgatitur procedurën e nevojshme për provimin përfundimtar të mbrojtje së diplomës me anë të temës së diplomës, duke u dhënë studentëve të drejtën për t'u diplomuar pas përfundimit me sukses të ciklit të studimeve. Departamentet përkatës dhe udhëheqësit shkencorë ofrojnë asistencë për studentët duke siguruar udhëzime, informacione dhe materiale të nevojshme për të garantuar zhvillimin e suksesshëm të procesit të përgatitjes e deri në paraqitjen finale të punimit të temës së diplomës.

	Në rregulloren e programit të studimit, është përcaktuar qartë se studentët që përfundojnë të gjitha detyrimet pajisen me diplomën dhe suplementin përkatës, në përputhje me formatin e miratuar nga MAS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master i Shkencave” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni referon se Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike bashkëpunon me aktorë të rëndësishëm për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe për të ofruar njohuri, duke siguruar gjithashtu mjedise të përshtatshme jashtë institucionit për realizimin e praktikës profesionale. Brenda institucionit, laboratorët janë tërësisht të dedikuar për studentët, duke mundësuar një praktikë laboratorike efektive. <i>Evidencë 38: përshkrimi i laboratoreve</i> <i>Evidencë 49: Lista e bashkëpunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione të tjera</i> <i>Evidencë 117: Lista e laboratoreve didaktike në të 3 Fakultetet – UMT</i> <i>Evidencë 118: Infrastruktura në funksion të mesimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë</i> <i>Evidencë 119: Lista e aseteve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë</i> <i>Evidencë 122: Udhezues i praktikës profesionale Msc teknik laborator.</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të	FSHMT ka nënshkruar marrëveshje institucionale për realizimin e praktikave klinike dhe stazheve, në bashkëpunim me institucione publike si QSUT, SUT, etj. Vlerësohet pozitivisht prania e mbikëqyrësit klinik në çdo repart spitalor, i cili është gjithashtu personel akademik me kontratë pranë FSHMT. Detyra e mbikëqyrësit përfshin monitorimin, orientimin, vendosjen në pozita pune dhe vlerësimin e studentëve gjatë praktikës profesionale.

njohurive dhe kompetencave profesionale.	<i>Evidencë 49: Lista e bashkepunimeve me IAL kombetare, nderkombetare dhe institucione te tjera</i> <i>Evidencë 101: Lista e bashkepunime me institucione te tjera_FSHMT</i> <i>Evidencë 112: Liste e Sherbimeve te QSU</i> <i>Evidencë 122: Udhezues i praktikës profesionale Msc teknik laborator.</i> <i>Evidencë 144: VKM Për miratimin e strukturave shendetesore universitare</i>			
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale ka vlerën e 12 krediteve dhe realizohet gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë akademik. Pas përfundimit të saj, orët e praktikës ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohet, duke përfshirë gjithashtu dhe mendimin e vlerësimin e mbikëqyrësit klinik të praktikës profesionale. <i>Evidencë 13: ditari i praktikës profesionale teknik laborator msc</i> <i>Evidencë 122: Udhezues i praktikës profesionale Msc teknik laborator.</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron mjedise të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale përmes bashkëpunimit me institucione të tjera publike, ndërkohë që shfrytëzon edhe ambientet e veta për punët laboratorike.</i> <i>GVJ konstaton që si pjesë e rëndësishme e përmirësimit, përditësimit dhe përshtatjes së programit të studimit shërben bashkëpunimi me institucione kërkimore e shkencore si edhe stafi mjekësor i spitaleve publike e private me të cilët është lidhur marrëveshje bashkëpunimi, ndërkohë ky staf është i angazhuar edhe si personel akademik me kontratë.</i> <i>Praktika profesionale dhe klinike e zhvilluar gjatë studimeve, ekuivalentohen në 12 kredite dhe dokumentohet duke e shoqëruar me mendimin e mbikëqyrësit klinik dhe vlerësimin përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master i Shkencave në Teknik Laboratori është Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT). Përbërja e personelit akademik dhe ndihmës akademik që angazhohet në mësimdhënie në këtë program studimi është si vijon: STAFI PËRGJEGJËS 2023 – 2024 PAE 7 Prof. Dr. 1, Prof. As 2, Dr. 4, Msc. - PAK 12 Prof. Dr. 1, Prof. As 1, Dr. 4, Msc. 5 SPA 1 STAFI PËRGJEGJËS 2022-2023 PAE 7 Prof. Dr. 1, Prof. As 2, Dr. 4, Msc. - PAK 12 Prof. Dr. 1, Prof. As 1, Dr. 4, Msc. 5 SPA 1 STAFI PËRGJEGJËS 2021-2022 PAE 8 Prof. Dr. 2, Prof. As 2, Dr. 4, Msc. - PAK 12 Prof. Dr. 1, Prof. As 1, Dr. 4, Msc. 5 SPA 1 GVJ konstatoi se raporti PAE/PAK është 8/12 për vitin akademik 2021-2022 dhe 7/12 për vitet akademike 2022-2023 dhe 2023 – 2024 në favor të PAK. Mosha e stafit akademik të përfshirë në program është mesatare, ku pjesa më e madhe e tij i përkasin grup moshës 46/55 vjeç (9 staf PAE) dhe 36/45 vjeç (7 staf PAE). Gjatë shqyrtimit të informacionit lidhur me personelin akademik dhe ndihmës akademik të paraqitur në tabelat përmbledhëse dhe CV e stafit, GVJ konstatoi se numri i stafit dhe i kualifikimit të tij është i qëndrueshëm duke përmbushur kriteret e përcaktuar në IAL për kategoritë Profesor, Doktor dhe Master Shkencor. Secila lëndë jepet nga specialistë të fushës përkatëse, të cilët janë me grada shkencore e tituj akademikë. <i>Evidencë 97. TABELA PERMBLEDHESE ASCAL Msc Teknik laboratory (Tabelat 6).</i>

	<i>Evidencë 92. Sylabuse MASTER SHKENCOR TEKNIK LABORATORI firmosur.</i> <i>Evidencë 96. CV e personelit akademik.</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Në programin Master Shkencor në Teknik Laboratori janë angazhuar personel akademik efektiv dhe me kontratë, të cilët janë përgjegjës për mbulimin e moduleve/lëndëve të programit të studimit dhe që zotërojnë tituj akademik, grada dhe master shkencor. GVJ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e vënë në dispozicion lidhur me planet mësimore, ngarkesën mësimore vjetore si edhe CV e stafit, konstatoi se anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohen në mësimdhënie janë në përputhje të plotë me fushën e programit të studimit dhe profilin e lëndëve/moduleve që mbulojnë të cilat pasqyrohen qartë edhe në syllabuset e tyre. GVJ konstatoi se personeli akademik me kohë të plotë mbulon rreth 29 % të ngarkesës mësimore për programin e studimit duke mos qënë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. 2022-2024 PAE 425 (28.8 %) + PAK 1049 (71.2 %) = 1474 (100%) 2021-2023 PAE 425 (28.8 %) + PAK 1049 (71.2 %) = 1474 (100%) 2020-2022 PAE 425 (28.8 %) + PAK 1049 (71.2 %) = 1474 (100%) Rekomandim: Të rishikohet shpërndarja e ngarkesës mësimore e cila duhet të mbulohet nga personeli akademik efektiv për të ruajtur raportin PAE/PAK në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. <i>Evidencë 97. TABELA PERMBLEDHESE ASCAL Msc Teknik laborator.</i> <i>Evidencë 96. CV e personelit akademik</i> <i>Evidencë 91. Plan i mesimor 2023-2024.</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e	Bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar në drejtorinë e burimeve njerëzore si edhe tabelat e karrierës akademike dhe shkencore, në raportet vjetore të departamentit ku zhvillohet programi i studimit, CV e stafit, GVJ konkludon se ka qëndrueshmëri dhe progres të personelit akademik falë edhe mbështetjes institucionale të promovimit të tij.

punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Mbështetja logjistike, shëndetësore dhe sociale reflektohet në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale pasi pjesa më e madhe e stafit akademik janë njëkohësisht pjesë e stafit mjekësor të QSUNT apo qëndrave të tjera spitalore në bashkëpunim me UMT. Gjithashtu, nga kontrolli i kontratave të punës dhe respektimit të praktikave të punësimit u konstatua se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. <i>Evidencë 159. Model kontrate pedagoget e jashtëm</i> <i>Evidencë 160. Model kontrate personel akademik.</i> <i>Evidencë 163. Praktikë e punësimit të personelit akademik në UMT.</i> <i>Evidencë 97. TABELA PERMBLEDHESE ASCAL Msc Teknik laborator.</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore si edhe shqyrtimit të evidencave të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, GVJ u informua mbi procedurën dhe praktikën e punësimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, me modelin e kontratave të punës dhe gjithashtu verifikoi përmbajtjen e dosjes së PAE dhe PAK. Gjatë këtij verifikimi dosja përmbante konkretisht dokumentacionin e mëposhtëm: • Formatin europass të CV. • Fotokopje e pasaportës ose ID, adresën e banimit. • Formular vetë deklarami/Dëshmi penaliteti, Pozicioni i punës. • Diplomat e noterizuara me listat e notave përkatëse: Bachelor, Master, Doktoratë, Specializim, Dëshmi Titulli Shkencor. • Kualifikimet. • Librezën e punës. • Procedurën e punësimit. Dosjet përditësohen periodikisht në fillim të çdo viti akademik. Institucioni disponon një procedurë të rekrutimit dhe punësimit të PAE/PAK bazuar në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, akteve ligjore dhe nënligjore të arsimit të lartë, Statutit e Rregullores së UMT. Punësimi realizohet me procedurë të konkurrimit të hapur duke garantuar një proces transparent në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit.

	Çdo vit departamentet përcaktojnë ngarkesën mësimore, planifikimin e personelit që përfshihet në programin e studimit dhe nevojat për staf akademik nëse ka, të cilat i paraqiten dekanatit që ia përcjell rektoratit dhe më pas kalojnë për miratim në senat. Pas miratimit njësia kryesore bën shpalljen publike të pozicioneve të punës për PAE/PAK duke e publikuar njoftimin në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik si edhe në faqen web të UMT. Kandidatët informohen nëpërmjet faqës zyrtare të njësisë kryesore për kriteret përgjithshme/specifike të punësimit, dokumentacionin e nevojshëm, afatet kohore si edhe tabelën e pikëzimit. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit, drejtuesi i njësisë kryesore ngre komisionin ad/hoc për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Komisioni ad/hoc kryen vlerësimin e kandidatëve nëpërmjet 2 fazave, shqyrtimit të dokumenteve/dosjes dhe intervistës. Në përfundim të fazës së parë komisioni ad/hoc i përcjell sektorit të burimeve njerëzore listën e kandidatëve të skualifikuar me arsyet përkatëse, të cilët brenda një afati kohor mund të bëjnë ankimim. Vetëm kandidatët e kualifikuar në fazën e parë vijnë me fazën e dytë të intervistës për të cilën njoftohen mbi datën dhe orën. Procedura mbyllet dhe vendimi i komisionit i përcillet rektoratit, i cili harton kontratën e punës në bazë të legjislacionit në fuqi dhe kodit të punës. Performanca e stafit akademik vlerësohet jo vetëm në momentin e rekrutimit por vazhdimisht nëpërmjet pyetësorëve të studentëve dhe formularëve të vlerësimit të pedagogut. <i>Evidence 162. Procedurat e punësimit të personelit akademik, ndihmes..., administrativ UMT.</i> <i>Evidence 163. Praktikë e punësimit të personelit akademik në UMT</i> <i>Evidence 164. Praktika për planifikimin dhe realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik.</i> <i>Evidence 160. Model kontrate personel akademik.</i> <i>Evidence 155. Shembull Vlerësimi i performances se stafit administrativ.</i> <i>Evidence 156. Formular raporti për realizimin e veprimtarisë akademike</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e	Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit GVI evidentoi angazhimin e personelit ndihmës akademik të cilët asistojnë në realizimin e orëve laboratorike dhe kujdesen për mirëmbajtjen e laboratorëve që lidhen me programin e studimit Msc Teknik Laboratori.

orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Personeli ndihmës akademik dhe ai me kohë të pjesshme që angazhohen në veprimtarinë mësimore është i mjaftueshëm, i përket profilit teknik laborator dhe zotëron të gjitha kualifikimet dhe kompetencat për realizimin me cilësi të orëve laboratorike. <i>Evidence 97. TABELA PERMBLEDHESE ASCAL Msc Teknik laborator.</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë takimit me përfaqësues të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në vizitën institucionale si edhe bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se UMT nëpërmjet kësaj drejtorie disponon, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit Master i shkencave në Teknik Laboratori të FSHMT, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat që lidhen me aktivitetin dhe ngarkesën mësimore, aktivitetin kërkimor shkencor dhe të çdo angazhimi tjetër të stafit akademik përdoren për tu pasqyruar në analiza dhe raporte vjetore të departamentit dhe drejtorisë së burimeve njerëzore në kuadër të vlerësimit të performancës dhe vetëvlerësimit në procese të ndryshme. Zyra e Burimeve njerëzore disponon dosjet personale të stafit akademik së bashku me marrëveshjet e realizimit të ngarkesës mësimore si edhe dosjet personale të stafit jo akademik. Të dhënat ruhen në regjistrin themeltar të stafit, por edhe elektronikisht të cilat përditësohen çdo vit nga Zyra e Burimeve Njerëzore përfshirë këtu edhe ndryshimet e vendit të punës nëse ka apo tërheqjen e librezës së punës nga individ. Nëpërmjet dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ u njoh me të dhënat tabelore të personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore në çdo semestër/vit akademik dhe kualifikimin përkatës. <i>Evidence 111. Analize vjetore Zyra e burimeve njerezore.</i> <i>Evidence 82. Raporti vjetor FSHMT 2023.</i> <i>Evidence 97. TABELA PERMBLEDHESE ASCAL Msc Teknik laborator.</i> <i>Evidence 156. Formular raporti per realizimin e veprimtarise akademike</i>

Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi se FSHMT disponon laboratorë të dedikuar për zhvillimin e praktikave laboratorike për programin Msc në Teknik Laboratori të mirëmbajtura dhe të mirë pajisura në të cilat angazhohen personel akademik të profilit Teknik Laboratori me eksperiencë disa vjeçare në fushën e laboratorit. Gjithashtu, GVJ evidentoi se FSHMT dhe UMT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me QSUNT, ISHP, Poliklinikën qëndrore dhe institucione të tjera për realizimin e praktikës laboratorike të programit Teknik Laboratori. Marrëveshjet kanë si qëllim jo vetëm realizimin e praktikave profesionale por edhe zhvillimin e studimeve kërkimore të studentëve, punimin e diplomave, njohjen e tregut të punës dhe krijimin e lidhjeve për mundësi punësimi në të ardhmen. Mbikëqyrësit e praktikave profesionale janë njëkohësisht edhe personel shëndetësor në këto laboratorë (CV). <i>Evidence 117. Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultetet - UMT.</i> <i>Evidence 46. Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS.</i> <i>Evidence 45. Lista e projekteve kombetare te aplikuara dhe te fituara.</i> <i>Evidence 92. Sylabuse Msc Teknik Laboratori _firmosur.</i> <i>Evidence 96. CV-te e personelit akademik te angazhuar ne Msc. Teknik laborator.</i> <i>Evidence 13. Ditari i praktikës profesionale teknik laborator msc.</i>
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Institucioni ka një procedurë të mirë përcaktuar që koordinohet nga përgjegjësit e departamenteve në bashkëpunim me dekanatin dhe titullarin e lëndës për shpërndarjen e praktikës profesionale në bazë të marrëveshjeve me institucionet pritëse duke angazhuar personelin e atij shërbimi si mbikëqyrës i praktikës profesionale. Mbikëqyrësit e praktikave në mjediset spitalore të angazhuar si staf akademik me kohë të pjesshme bashkëpunojnë ngushtë me stafin akademik efektiv sipas shërbimeve klinike përkatëse. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve/raportin përfundimtar të praktikës si dhe marrin pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. <i>Evidence 13. Ditari i praktikës profesionale teknik laborator msc.</i> <i>Evidence 11. Praktike per miratimin e planeve mesimore.</i>

Konkluzione	– Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike përgjegjës për programin e studimit Master Shkencor në Teknik Laboratori përmbush kërkesat ligjore në fuqi në lidhje me personelin akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, i cili ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. – Rekrutimi i stafit realizohet sipas legjislacionit në fuqi të arsimit të lartë, statutit dhe rregullores së institucionit UMT. Institucioni disponon një fond fizik dhe elektronik të të dhënave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit si dhe kryen përditësimin e këtyre të dhënave çdo vit akademik. – Në këtë program studimi anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë që angazhohen në mësimdhënie janë në përputhje të plotë me fushën e programit të studimit dhe profilin e lëndëve/moduleve që mbulojnë. – Raporti PAE/PAK është 29/71 duke mos qënë në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Rekomandohet që të rishikohet shpërndarja e ngarkesës mësimore e cila duhet të mbulohet nga personeli akademik efektiv për të ruajtur raportin PAE/PAK në përputhje me kornizën ligjore në fuqi – Institucioni disponon laboratorë të dedikuar për zhvillimin e praktikave laboratorike dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore për realizimin e praktikës profesionale, të konstatuara nga GVJ që janë aktive. – Gjatë kryerjes së praktikës profesionale në mjediset spitalore studentët mbikëqyren nga staf akademik me kohë të pjesshme me profil teknik laboratorik të cilët marrin pjesë edhe në procesin e vlerësimit të praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------




Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ ka vizituar mjediset mësimore dhe infrastrukturën në shërbim të mësimdhënies dhe aktivitetit shkencor, mjedisit të bibliotekës, shërbimit të teknologjisë së informacionit, si edhe zyrat e administratës dhe personelit akademik në mbështetje të veprimtarisë mësimore dhe shërbimit ndaj studentëve. Aktiviteti mësimor zhvillohet kryesisht në FSHMT, i cili përbëhet nga dy godina me një infrastrukturë të përshtatshme dhe në përmbushje të standardeve për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ u njoh me të dhënat për zhvillimin e infrastrukturës, investimet, planimetritë dhe sipërfaqët në funksion të procesit akademik, stafit dhe studentëve. GVJ konstatoi se FSHMT ka në dispozicion 25 salla leksioni ku njëra prej tyre është 200 m² e cila shërben për zhvillimin e konferencave, workshop-eve, leksioneve të hapura etj., 15 salla seminari, 1 bibliotekë dhe salla leximi ku mundësohet akses i internetit, 14 zyra për personelin akademik dhe 24 për administratën. FSHMT disponon gjithashtu zyrën e informacionit për studentët, zyrën e shërbimit informatik IT si edhe arkivën. Organizimi i orarit mësimor realizohet në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Në takimin me stafin dhe drejtuesit GVJ u informua se procesi mësimor për programin e ciklit të parë zhvillohet paradite, kurse për ciklin e dytë pasdite. Vendndodhja e FSHMT është brenda mjedisit të QSUT që i jep mundësinë studentëve që krahas procesit mësimor teorik të zhvillojnë edhe aftësimin praktik. <i>Evidence 90. Te dhena per zhvillimin e infrastukturës dhe investimet.</i> <i>Evidence 118. Infrastruktura ne funksion te mesimdhënies, Universiteti i Mjekesise, Tirane.</i> <i>Evidence 119. Lista e aseteve infrastrukturore te UMT dhe planimetrite</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë	Mjediset mësimore të FSHMT janë të mjaftueshme dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik duke marre në konsideratë jo vetëm kapacitetet e posteve në raport me numrin e studentëve, por edhe mjetet didaktike dhe të kancelarisë në funksion të procesit mësimor.

realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi se Godina 1 e FSHMT ka 6 auditorë me kapacitet 330 vende uljeje, 10 salla seminari me 50 vende uljeje, 4 laboratorë me 30 vende uljeje, si dhe 15 zyra administrative. Godina 2 ka 11 auditorë me kapacitet 780 vende uljeje, 14 salla seminari me 50 vende uljeje, 3 laboratorë me 70 vende uljeje, si dhe 21 zyra administrative. Sallat e leksioneve janë të pajisura me kondicionerë dhe video projektorë dhe në shërbim të stafit akademik dhe administrativ janë në dispozicion edhe projektorë portabël dhe mjete kancelarie. Mjediset e FSHMT kanë shërbime tualeti, sistem të mbrojtjes kundër zjarrit të cilat u konstatuan edhe gjatë vizitës në institucion. Ndriçimi natyral dhe artificial është i mjaftueshëm për realizimin e aktivitetit akademik. Vendndodhja gjeografike e favorizon FSHMT për të shfrytëzuar në mbështetje të veprimtarisë mësimore edhe mjediset e UMT dhe QSUNT. <i>Evidence 90. Te dhena per zhvillimin e infrastukturës dhe investimet.</i> <i>Evidence 118. Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies, Universiteti i Mjekesise, Tirane.</i> <i>Evidence 119. Lista e asetëve infrastrukturore te UMT dhe planimetrite</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	FSHMT disponon 2 laboratorë të dedikuar për programin Msc Teknik Laboratori. GVJ vizitoi mjediset e laboratorëve të cilat ishin të pajisur me mjetet e nevojshme për aftësimin praktik të studentëve sipas natyrës specifike të programit si mikroskop për ekzaminime të ndryshme, lama, fotometër, etj. Studentët aftësohen të marrin gjak nga njëri-tjetri dhe të bëjnë ekzaminime të thjeshta biokimike në bazë të parimit "learning by doing". Në dispozicion të studentëve të programit Msc Teknik Laboratori janë edhe laboratorë në varësi të departamenteve të tjera si laboratorët e infermierisë, laborator i imazherisë digjitale, laborator i anatomisë radiologjike. <i>Evidence 117. Lista e laboratoreve didaktike ne te 3 Fakultete</i> <i>Evidence 90. Te dhena per zhvillimin e infrastukturës dhe investimet.</i> <i>Evidence 118. Infrastruktura ne funksion te mesimdhenies, Universiteti i Mjekesise, Tirane.</i> <i>Evidence 119. Lista e asetëve infrastrukturore te UMT dhe planimetrite.</i>

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	FSHMT disponon një laborator të teknologjisë së informacionit në funksion të programit Msc Teknik Laboratori dhe i dedikuar veçanërisht imazherisë dixhitale me karakteristika për të përpunuar imazhe mjekësore. Ky laborator është i aksesueshëm me një data basë literaturë elektronike e përditësuar me materiale të viteve të fundit. Institucioni ka përmirësuar vazhdimisht infrastrukturën laboratorike nëpërmjet investimit të drejtpërdrejtë por edhe falë pjesëmarrjes në projekte. <i>Evidence 38: Shembull Propozim projekti laborator imazherise dixhitale</i> <i>Evidence 90. Te dhena per zhvillimin e infrastukturës dhe investimet.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Institucioni, në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), disponon mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. FSHMT, edhe pse zotëron kapacitetet e duhura për të zhvilluar praktikën profesionale, bashkëpunon me institucione të tjera të arsimit të lartë si dhe me klinika private laboratorike të cilët vënë në dispozicion të studentëve personel të kualifikuar për udhëheqjen e studentëve në praktikën institucionale. <i>Evidence 101. Lista e bashkepunime me institucione te tjera_FSHMT.</i> <i>Evidence 112. Liste e Sherbimeve te QSU.</i> <i>Evidence 48. Shembull marreveshje bashkepunimi me IAL nderkombetare.</i> <i>Evidence 46. Memorandume bashkepunimi UMT me MShMS</i>
Konkluzione	– Institucioni siguron mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik të studentëve. – FSHMT zotëron laboratorë të dedikuar për programin Msc Teknik Laboratori që përmbajnë aparatura dhe mjete të nevojshme për aftësimin praktik të studentëve sipas natyrës specifike të programit. – Në funksion të programit të studimit është laborator i teknologjisë së informacionit i dedikuar veçanërisht për imazherinë dixhitale.

	– Institucioni në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera disponon mjedise të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	FSHMT siguron literaturë bazë dhe ndihmëse në dispozicion të studentëve në programin e studimit Msc Teknik Laboratori qoftë si fond fizik, qoftë duke aksesuar bibliotekën dixhitale në mbështetje të mësimdhënies dhe mësim nxënies. Studentëve u rekomandohet gjithashtu ndjekja e revistave apo aksesimi online i teksteve. Kjo u konstatua edhe gjatë takimit me studentët dhe stafin në vizitën institucionale. <i>Në shumicën e rasteve pedagogët u referojnë studentëve si literaturë bazë leksione në versionin power point ose të printuar si cikël leksionesh.</i> Biblioteka disponon fond fizik të librave mësimore, postë interneti dhe kompjuterë që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës në mbështetje të procesit mësimor. Gjatë takimit me stafin në vizitën institucionale por edhe nga dokumentacioni në dispozicion GVJ konfirmoi se ndërveprimi i studentëve me pedagogun e lëndës në periudhën e pandemisë u realizua nëpërmjet platformës elektronike të UMT, google classroom, etj. <i>Evidence 113. Biblioteka FSHMT.</i> <i>Evidence 114. Bibliotekat online - lista dhe pershkrim.</i> <i>Evidence 115. Komunikimi zyrtar per U-Library</i> <i>Evidence 23. Shembull_nderfaqë_g_classroom.</i> <i>Evidence 92. Sylabuse MASTER SHKENCOR TEKNIKE LABORATORI_firmosur.</i>

Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.

Në takimin me përgjegjësit e departamenteve, u deklarua se çdo fillim viti akademik në mbledhjen e departamentit kërkohet prej pedagogëve përditësimi i literaturës me botime të 5 viteve të fundit, i cili duhet pasqyruar në syllabuset e lëndëve. Titullari i lëndës dorëzon në njësinë përgjegjëse syllabusin e lëndës ku jepet informacioni mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar. **Gjatë shqyrtimit të syllabuseve dhe kurrikulës, GVJ evidentoi se literatura bazë e detyruar në disa lëndë nuk ishte e përditësuar me botime të 5 viteve të fundit.**

Në syllabuse ajo referohet si *"leksione të përgatitur nga pedagogu"*, *"leksione ppt"* ose si tekst mësimor pa dhënë detaje si viti i botimit, emri i shtëpisë botuese, ISBN, numri i botimit ose i volumit etj., në mungesë të plotë të mënyrës së paraqitjes të një reference bibliografike. Edhe kur evidentohet literaturë si tekst mësimor i miratuar sipas procedurës së botimit të paraqitur në rregulloren e institucionit, në disa prej lëndëve ajo ishte e vjetruar dhe konkretisht në lëndet:

2000 – Psikologji Shëndeti

2002 – Metodologji e Kërkimit Shkencor

2008 – Testet Laboratorike në Geriatri

2010 – Shkrim Akademik

2011 – Imunologji e Avancuar dhe Diagnostike

2015 – Bioetikë

Gjithashtu, gjatë vizitës në bibliotekë dhe shqyrtimit të referencës që ka të bëjë me informacionin mbi bibliotekën e FSHMT-së u evidentua literaturë mjekësore kryesisht e vjetruar. Aksesimi online ose në bibliotekën dixhitale si edhe literatura e rekomanduar në syllabuse përmbush standardin për botime të viteve të fundit dhe janë tekste kryesisht me autorë dhe gjuhë të huaj.

Rekomandim: GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar me botime të viteve të fundit dhe pasurimin e fondit fizik të bibliotekës me literaturë mjekësore të përditësuar brenda 5 viteve të fundit, mundësisht edhe në gjuhën shqipe.

GVJ rekomandon modelin e një reference bibliografike me detajet e duhura në përshkrimin e literaturës bazë në syllabuse.

Evidencë 92. Syllabuse MASTER SHKENCOR TEKNIKE LABORATORI_firmosur.

Evidencë 113. Biblioteka FSHMT.

Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UMT disponon një bibliotekë qendrore universitare me botime të mbi 70 viteve histori të mjekësisë shqiptare si një trashëgimi e vyer që përditësohet në mënyrë periodike. Në bibliotekën qendrore ruhet një numër i madh vëllimesh të librave mjekësore, botimeve shkencore, teksteve mësimore të personelit akademik, disertacioneve të mbrojtura në UMT. Këto të fundit janë në versionin elektronik në faqen zyrtare të UMT, të cilat mund të aksesohen lehtësisht nga cilido i interesuar. FSHMT, si pjese e UMT, disponon gjithashtu një bibliotekë mësimore që funksionon në përputhje me nenin 30, të Ligjit Nr. 8576, datë 03.02.2000, Neni 30, “Për Bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë vizitës institucionale GVJ evidentoi se biblioteka e FSHMT përmban një sallë leximi me hapësirë të bollshme dhe të dedikuar për studentët duke u garantuar atyre mundësi të barabarta të shfrytëzimit të literaturës sipas programit të studimit. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ evidentoi se UMT ka krijuar Këshillin Botues si organ kolegjal i cili shqyrton, diskuton dhe miraton botimet e personelit akademik për tekstet mësimore, si dhe artikujt në revistën shkencore të UMT dhe të fakulteteve. Staf i dhe studentët botojnë pa kosto në revistat shkencore të UMT dhe fakulteteve respektive, përfshirë FSHMT. <i>Evidence 183. Rregullore-mbi-organizimin-dhe-funksionimin-e-Keshillit-te-Botimeve-UMT-VSA-nr. 42-datë-29.04.2022.</i> <i>Evidence 182. Rregullore mbi botimet mesimore-shkencore ne UMT.</i> <i>Vizita e ambienteve ne FSHMT</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës së ambienteve në institucion, GVJ evidentoi se Biblioteka e FSHMT është e pajisur jo vetëm me fond fizik si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore, por ajo disponon gjithashtu edhe katalogun elektronik të bibliotekës, i cili aksesohet online në linkun https://ulibrary.rash.al/, me klikim në biblioteka online në faqen kryesore të UMT. Kërkimi elektronik kryhet duke kërkuar titujt në bazë të emrit, autorit, apo vitit të botimit. Çdo pedagog/student anëtarësohet falas dhe pas hapjes së kartelës së regjistrimit pajisen edhe me librezë anëtarësimi.

	GVJ vlerësoi se pavarësisht kërkesave buxhetore të përvitshme për pasurimin e bibliotekës, nevojitet pasurimi i mëtejshëm i saj me botime të 5 viteve të fundit dhe me tituj të rinj. GVJ rekomandon që fondi fizik i bibliotekës duhet të pasurohet vazhdimisht me botime të viteve të fundit dhe me tituj të rinj në funksion të literaturës së rekomanduar për programin Msc Teknik Laboratori. <i>Evidence E3.1 Biblioteka FSHMT.</i> <i>Evidence E3.2 Bibliotekat online - lista dhe pershkrim.</i> <i>Vizita institucionale</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Studentët e FSHMT/UMT kanë akses falas në bibliotekën fizike dhe online të institucionit në funksion të programit mësimor. Në takimin me studentët në vizitën institucionale GVJ u informua se biblioteka fizike dhe online e FSHMT shfrytëzohet në mënyre të barabartë dhe pa pagesë edhe për studentët e fushës së teknikut të laboratorit. Bazuar në dokumentacion, UMT është pjesë e ULIBRARY të vënë në dispozicion nga RASH ku studentët mund të gjejnë dhe aksesojnë literaturën e dëshiruar nga salla e bibliotekës por mund ta aksesojnë atë online në çdo kohë. Studentët kanë akses gjithashtu edhe në librari të tjera online si: Hinari, Telemedicine, Albanian Health foundation. <i>Evidence 115: Komunikimi zyrtar per U-Library</i> <i>Evidence 142.Pr.sc të shërbimeve të RASH.</i> <i>Evidence 113.Biblioteka FSHMT.</i> <i>Evidence 114.Bibliotekat online - lista dhe pershkrim.</i> http://hinarilogin.research4life.org www.telemedicine.al/index.php/components/virtual-electronic www.albanianhealthfund.org/missions/medical library <i>Vizita institucionale</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e FSHMT është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët, fakt që u evidentua nga grupi i GVJ në vizitën institucionale. Gjithashtu FSHMT disponon bibliotekën elektronike si pjesë përbërëse e telemjekësisë për studentët, specialistët, personelin akademik të FSHMT/UMT, si dhe për personelin mjekësor të strukturave spitalore. <i>Evidence 114.Bibliotekat online - lista dhe pershkrim.</i> <i>Evidence 113.Biblioteka FSHMT.</i>

	http://www.telemedicine.al/index.php/components/virtual-electronic-library/ <i>Vizita institucionale</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e FSHMT është në dispozicion të studentëve për literaturë bazë dhe suplementare, fizike dhe online. Ajo funksionon dhe organizohet sipas rregullores së fakultetit. GVJ konstatoi gjatë vizitës institucionale se orari i shërbimit të bibliotekës është nga ora 08:00 deri në orën 18:00, në çdo ditë të javës, orar ky i përshtatshëm me oraret e programit të studimit dhe nevojave të studentëve. FSHMT ka punonjës të veçantë për bibliotekën në shërbim të mirëmbajtjes dhe nevojave të studentëve. <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT.</i> <i>Reference 24: Udhezues biblioteka online</i> <i>Evidence 113. Biblioteka FSHMT</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qënë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	FSHMT planifikon çdo vit buxhet për pasurimin e fondit fizik të bibliotekës dhe vitet e fundit sidomos pas periudhës së pandemisë ka rritur investimet për përmirësimin e infrastrukturës elektronike të bibliotekës. Departamentet propozojnë kërkesat buxhetore për pasurimin e fondit fizik dhe online të bibliotekës. Bazuar në këto kërkesa Biblioteka i drejtohet administratorit të fakultetit për sigurimin e botimeve të reja dhe aksesin në libraritë online nëpërmjet abonimit. Gjatë bisedës me studentët dhe stafin në vizitën institucionale u deklarua prej tyre se ata shfrytëzojnë në mënyrë të kënaqshme veçanërisht informacionin dixhital si edhe atë fizik të bibliotekës. <i>Evidence 88: Te dhena Financiare per alokim buxheti FSHMT (3 vite)</i> <i>Evidence 52. Praktike per miratimin e buxhetit vjetor UMT.</i> <i>Evidence 53. Procedura per miratimin e buxhetit vjetor.</i> <i>Evidence 54. Procedura e hartimit te projekt buxhetit afatmesem.</i> <i>Vizita institucionale</i>
Konkluzione	– FSHMT siguron literaturë bazë dhe ndihmëse në dispozicion të studentëve si fond fizik dhe akses dixhital në mbështetje të mësimdhënies dhe mësim nxënies. – Biblioteka është në funksion të programit mësimor për studentët, personelin akademik të FSHMT/UMT, si edhe për personelin mjekësor të strukturave spitalore.

	– UMT disponon një bibliotekë qendrore universitare e biblioteka në çdo fakultet, përfshirë bibliotekën e FSHMT që përditësohet në mënyre periodike. Biblioteka e FSHMT ka hapësira të bollshme dhe të dedikuara për studentët sipas programit të studimit. – Institucioni siguron shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekën fizike dhe online të fushës së programit të studimit. Orari i shërbimit të bibliotekës është 08:00–18:00 çdo ditë të javës, orar ky i përshtatshëm me oraret e programit të studimit dhe nevojave të studentëve. – Fondi fizik i bibliotekës dhe literatura bazë e detyruar në disa lëndë, në syllabuse nuk është e përditësuar me botime të 5 viteve të fundit dhe shpesh referohet si "leksione të përgatitur nga pedagogu i lëndës", "Leksione në PowerPoint". – Literatura bazë e detyruar në syllabuse shpesh ka mungesë të plotë të mënyrës së paraqitjes të një reference bibliografike. – GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar me botime të viteve të fundit duke qënë se institucioni e disponon aksesin online prestigjioz për literaturë mjekësore dhe pasurimin vazhdimisht të fondit fizik të bibliotekës me tituj të rinj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	UMT disponon sistem të dedikuar të menaxhimit të veprimtarive akademike dhe mësimdhënies, informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin Easy-Web. Platforma UMT Easy-Web është një sistem multifunksional që menaxhon jo vetëm aktivitetin akademik, mësimor por edhe atë trajnues veçanërisht trajnimin dhe edukimin në distancë për të gjithë profesionistët e shëndetit duke integruar në të edhe kontributin e profesionistëve në diasporë. Platforma mbështet një proces të kombinuar (blended learning) të mësimin online e me prezence fizike. Disa nga funksionet e sistemit Easy-Web janë si vijojnë: - Administrimi i pedagogëve dhe studentëve në nivel lënde.

	- Komunikimi me pedagogët. - Menaxhimi i leksioneve online. - Menaxhimi i detyrave/projekteve. - Menaxhimi i leksioneve të lëndës. - Menaxhimi i seminareve/praktikave/laboratorëve. - Menaxhimi i të dhënave të përgjithshme të lëndës. - Menaxhimi i provimeve. - Sistemi i vlerësimit të studentëve. - Ngarkimi i materialeve të detyrave/projekteve. - Menaxhimi i llogarisë personale. - Zoom dhe Google Meet, etj. Që prej periudhës së pandemisë dhe në vazhdim institucioni ka zhvilluar më tej kapacitetet e veta të teknologjisë së informacionit duke bashkëpunuar me kompaninë ARKIT dhe AADF për të përfshirë komponentë të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë si: vlerësimin e performancës në nivel individ, njësie e strukture, në nivel institucional, publikime simulative në mjekësi për edukim dhe trajnim, akses në data bazat kryesore mjekësore online për qëllime simulimi. <i>Evidence 148. Pershkrim funksionaliteteve të platformes EasyWeb LMS.</i> <i>Evidence 150. Permbledhje Manuale EasyWeb.</i> <i>Evidence 151. Marrëveshje me RASH për shërbime në fushën e IT.</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës/akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion por edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GJVJ verifikoi se institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, të cilat aksesohen nga stafi dhe studentët.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Në regjistrat e sekretarisë por edhe tashmë në sistemin e ri Pitagora të sekretarisë mësimore mundësohet menaxhimi i detyrimeve akademike të studentëve, administrohen dhe ruhen të dhëna, informacione dhe dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet, rezultatet e tyre gjatë viteve të studimit si edhe të dhëna për stafin akademik, ndihmës/akademik, administrativ dhe programet e studimit kurrikular.

	Gjithashtu, institucioni disponon sistemin e përzgjedhjes së studentëve që aplikojnë në programet e UMT, sistemin elektronik të dedikuar për pikëzimin dhe renditjen e aplikantëve. Një tjetër sistem informatike që UMT përdor si rezultat i bashkëpunimit dhe partneritetit në projekte është sistemi i regjistrimit të të diplomuarve pas përfundimit të studimit "GRADUA" me koordinator kryesor Universiteti Bujqësor i Tiranës - Kamëz. UMT ka llogari të posaçme dhe përdor shërbimet e ASCAL Management System [AMS] nëpërmjet të cilit UMT administron dhe menaxhon të gjithë informacionin dhe arkivin elektronik që lidhet me të dhënat e institucionit, strukturën akademike, administrative dhe shërbimeve, programet e studimit dhe të dhënat e detajuara për to, studentët aktivë që ndjekin studimet, stafin akademik në kohë reale, fushën e studimit, kualifikimet dhe të dhëna të tjera të cilat përditësohen dhe raporton në mënyrë të vazhdueshme. <i>Evidence 149. Pershkrim i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA.</i> <i>Evidence 142. Pr.sc të shërbimeve të RASH.</i> <i>Evidence 43. Nderfaqë_Sistem elektronik i dedikuar për pikezimin dhe renditjen e aplikanteve</i> <i>Evidence 141. Nderfaqë ASCAL_AMS.</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni nëpërmjet sistemit elektronik të të dhënave UMT Easy-Web, siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente për të gjithë studentët dhe stafin akademik (PAE/PAK), të cilët kanë edhe profilin e tyre në këtë sistem. Institucioni u ka vendosur në shërbim studentëve dhe stafit adresat e-mail zyrtar@umed.edu.al të cilat shërbejnë për komunikim interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Përveç Easy-Web institucioni siguron akses edhe në libraritë online si "E-Research", "Training 4 ALL", "Virtual University", "U-Library", nga ku mund të përpunohen të dhënat dhe përcillet informacion në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në QSHA dhe në rrjetin e institucioneve të arsimit të lartë të menaxhuar nga Rrjeti Akademik Shqiptar. <i>Evidence 142. Pr.sc të shërbimeve të RASH.</i> <i>Evidence 20. Emaille_zyrtare_umed.png</i> <i>Evidence 143. Nderfaqë web UMT.</i> <i>Evidence 150. Permbledhje Manuale EasyWeb.</i>

	<i>Evidence 151. Marrëveshje me RASH per sherbime ne fushen e IT. Vizita institucionale, takim me staf dhe studente</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në sistemin e menaxhimit kanë llogari sekretaria mësimore dhe autoritetet drejtuese duke krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, por gjithashtu mundësi për raportime dhe të dhëna për organet drejtuese. Gjithashtu informacioni mundësohet edhe nëpërmjet faqës zyrtare të FSHMT dhe UMT, të cilat pasqyrojnë veprimtarinë administrative, akademike, institucionale, zgjedhore, programin e transparencës, kulturore e sociale, të gjitha ciklet dhe programet e studimit, disertacionet e doktoratave të mbrojtura, etj. Përveç sistemeve të sipërpërmendura, forma të komunikimit interaktiv janë edhe përdorimi i e-mail-eve zyrtare të institucionit, google classroom, google site, google meet pa limit për personelin akademik dhe studentët e programit të studimit. Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës si dhe specialisti i IT në Rektoratin e UMT asistojnë teknikisht dhe janë njëkohësisht përgjegjës për sigurinë e informacionit e ruajtjen e tij. <i>Evidence 41. Nderfaqë UMED google education</i> <i>Evidence 12. Nderfaqë Facebook_FSHMT.</i> <i>Evidence 74: Shembul Vendim Rektorati Per implementimin e platformes online Easyweb LMS ne UMT</i> <i>Evidence 40. Nderfaqë sistemi PITAGORA.</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Institucioni disponon faqen zyrtare http://umed.edu.al/ në të cilën pasqyrohen aktivitetet në nivel njësie kryesore. FSHMT disponon faqen zyrtare https://fshmt.edu.al/ e cila përditëson periodikisht aktivitetet e organizuara nga departamentet dhe stafi akademik, programin mësimor, strukturën e vitit akademik, orarin mësimor, etj. Nëpërmjet kësaj platforme studentët, partnerët dhe gjithë të interesuarit informohen në lidhje me thirrje, njoftime, kërkesa apo mundësi të ndryshme që ofrohen nga institucioni. Faqja zyrtare në web është në gjuhën shqipe dhe angleze. <i>Evidence 41. Nderfaqë UMED google education.</i> <i>Evidence 12. Nderfaqë Facebook_FSHMT.</i> <i>Evidence 143. Nderfaqë web UMT.</i>
Konkluzione	– <i>Institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit UMT Easy-Web dhe e vendos atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i>

	– Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik, sekretarinë mësimore, autoritetet drejtuese dhe studentët e programit të studimit. – Sistemi Easy-Web ka në shërbim të studentëve dhe stafit, adresat e-mail zyrtar@umed.edu.al., të cilat shërbejnë për komunikim interaktiv ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. – Përveç Easy-Web institucioni disponon sistemin Pitagora të sekretarisë mësimore, sistemin “GRADUA” të regjistrimit të diplomuarve si edhe siguron akses në libraritë online. – Institucioni disponon faqen zyrtare http://umed.edu.al/ në të cilën pasqyrohen aktivitetet në nivel njësie kryesore në dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni UMT harton çdo vit akademik Raportin Vjetor i cili është dokumentacioni kryesor përmbledhës i analizës vjetore të veprimtarisë akademike, shkencore dhe financiare të çdo njësie kryesore dhe strukturave të tjera të UMT. Për hartimin e Raportit Vjetor të institucionit ngrihet një grup pune i përbërë nga përfaqësues të strukturave të ndryshme përfshirë dhe ato të menaxhimit financiar. Ky raport diskutohet në një mbledhje të hapur të Senatit Akademik dhe me pas publikohet në faqen elektronike zyrtare të institucionit dhe një kopje e tij dërgohet në MAS. E gjithë procedura e hartimit të Raportit Vjetor bazohet në Udhëzimin nr. 5, datë 19.02.2018, i ndryshuar të MAS. Fondet për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi miratohen nga Bordi i Administrimit dhe burojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e universitetit. Shpërndarja bëhet në bazë të kërkesave buxhetore të planifikuara në fillim të çdo viti akademik nga njësitë kryesore.

	<i>Evidence 88. Te dhena Financiare per alokim buxheti FSHMT.</i> <i>Evidence 110. Analize vjetore zyra e finances.</i> <i>Evidence 79.1. Raporti Vjetor UMT 2021-2022.</i> <i>Evidence 75. Vendim i perbashket Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit per veprimtarine e UMT.</i> <i>Evidence 54. Procedura e hartimit te projekt buxhetit afatmesem.</i> <i>Evidence 82. Raporti vjetor FSHMT 2023.</i>
Kriteri 2.Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	FSHMT harton çdo vit akademik buxhetin në bazë të kërkesave dhe planifikimeve të departamenteve, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit. Buxheti përfshin pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, shpenzimet e personelit në veprimtari të ndryshme shkencore si pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare apo mobiliteti të miratuara nga departamenti. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se laboratorët i përmbushnin standardet për bazën materiale në funksion të programit të studimit dhe pozita gjeografike e institucionit që është brenda QSUNT krijon mundësi për shfrytëzimin e laboratorëve në praktikimin e studentëve. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se institucioni ka investuar nëpërmjet kërkesave buxhetore të përvitshme për materiale dhe pajisje laboratorike në mbështetje të programit të studimit, për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe mbështetjen e stafit në aktivitete të ndryshme shkencore (evidence 90). <i>Evidence 52. Praktike per miratimin e buxhetit vjetor UMT.</i> <i>Evidence 90. Te dhena per zhvillimin e infrastukturës dhe investimet.</i> <i>Evidence 180. Rregullore per hartimin, zbatimin, menaxhimin e Projekteve UMT.</i> <i>Evidence 5.1 Praktike Rimbursimi per stafin akademik.</i> <i>Evidence 137. Praktike per miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar.</i> <i>Evidence 88. Te dhena financiare per alokim buxheti FSHMT.</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e	Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.

financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Bazuar në RVB dhe dokumentacion, GVJ evidentoi se struktura përgjegjëse për auditimin e brendshëm e ngritur nga UMT është Njësia e Auditit të Brendshëm [NJAB], e cila ushtron veprimtari të pavarur, siguron zbatimin e duhur dhe respektimin e kërkesave ligjore, politikave etj., siguron vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave të kontrollit të brendshëm. GVJ konstatoi se UMT përdor dhe instrumente të tjerë të jashtëm (audit i jashtëm) për procesin e mbikëqyrjes dhe vlerësimit, për përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm. <i>Evidence 50: Praktika e ndjekur për auditim nga njesi audituese e jashtme (UNICEF)</i> <i>Evidence 51: Praktika e ndjekur për auditim nga Njesia e Auditit te Brendshem</i> <i>Evidence 169. Raporti i Vleresimit te Brendshem Institucional _UMT</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni informon dhe raporton njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Ky informim realizohet jo vetëm me hartimin e Raportit Vjetor të UMT/FSHMT por edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit që mundëson raportimin në kohë reale për veprimtaritë që kryhen nga njësitë. Nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi jo vetëm shpenzimet financiare në bazë të kërkesave dhe planifikimit që bën çdo fakultet në mbështetje të veprimtarisë akademike por edhe të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit, grantet dhe projektet ndërkombëtare. GVJ ka gjetur disa të dhëna që rimbursojnë pedagoget në punët e tyre kërkimore shkencore. GVJ ka evidentuar gjithashtu buxhetin afatmesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. <i>Evidence 79.1. Raporti Vjetor _UMT_ 2021-2022.</i> <i>Evidence 54. Procedura e hartimit te projekt buxhetit afatmesem.</i> <i>Evidence 82. Raporti vjetor FSHMT 2023.</i> <i>Evidence 36. Platforma _eUMT_VSA.</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet	Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Këto kapacitete bazohen në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit, tarifa regjistrimi, buxheti i shtetit, dhe projektet.

financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	<i>Evidence 52. Praktike për miratimin e buxhetit vjetor UMT</i> <i>Evidence 53. Procedura për miratimin e buxhetit vjetor</i> <i>Evidence 54. Procedura e hartimit të projekt buxhetit afatmesëm</i> <i>Evidence 89. Të dhënat për bursat e studentëve.</i> <i>Evidence 90. Të dhëna për zhvillimin e infrastrukturës dhe investimet.</i>			
Konkluzione	– UMT harton çdo vit akademik një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarrëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. – Fondet burojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e universitetit. Shpërndarja bëhet në bazë të kërkesave buxhetore të planifikuara në fillim të çdo viti akademik nga njësitë kryesore. – FSHMT harton çdo vit akademik buxhetin në bazë të kërkesave dhe planifikimeve të departamenteve, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit. – Institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në të ardhurat që siguron nga tarifat e shkollimit, tarifa regjistrimi, buxheti i shtetit, grante dhe projekte.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe	Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike kanë hartuar Statute dhe Rregullore në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

84

procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	përputhje me legjislacionin në fuqi në të cilat përshkruhen qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Bazuar në Statutin e UMT, Rregulloren FSHMT, Rregulloren e Departamenteve që mbulojnë programin e Teknik Laboratori, GVJ evidentoi se FSHMT zbaton politika të pranimit të studentëve duke respektuar kriteret bazë të pranimit, kriteret për zgjedhje, kuotat e planifikuara për kandidatët vendas, kandidatët nga vende shqip folëse, për kategoritë e marginalizuara, etj. Gjithashtu në këto dokumente përcaktohen qartë procedurat e transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Në funksion të informimit të studentëve nga regjistrimi në diplomim janë në dispozicion sekretaritë mësimore në nivel departamenti dhe fakulteti, zyra e këshillimit të karrierës si edhe stafi akademik. Për studentët e regjistruar organizohen ditët informative gjatë të cilave studentët pajisen me përparësen e bardhë si simbol për profesionet e fushës mjekësore. Studentët gjithashtu marrin informacion nëpërmjet Rregullores së FSHMT dhe Departamentit lidhur me organizimin e programeve, diplomimin, etj. <i>Evidence 1. Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë.</i> <i>Evidence 2. Rregullore-e-Universiteti te Mjekësisë Tirane.</i> <i>Evidence 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori.</i> <i>Evidence 137. Praktike per miratimin e kuotave cikli i parë dhe i integruar.</i> <i>Evidence 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.</i> <i>Evidence 108.1. Aktiviteti zyra e karrieres.</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	UMT dhe FSHMT siguron mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët për student sipas programeve të studimit. Bazuar në dokumentacion, GVJ evidentoi se UMT ka ngritur komisione ad-hoc të përbëra nga përfaqësues të çdo fakulteti që zbatojnë bazuar në kriteret, procedurat e përzgjedhjes së studentëve të rinj. Studentët kanë mundësi të njëjta për informim, kandidim në forume drejtuese, konkurrim për bursa, pjesëmarrje në mobilitete në kuadër të projekteve Erasmus apo pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme promovionale. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente dhe meritokraci. <i>Evidence 132. Procedura dhe praktika e pikezimit dhe renditjes se aplikanteve ne prog. e ciklit I dhe te integruar.</i>

	<i>Evidence 137. Praktike per miratimin e kuotave cikli i parë dhe integruar.</i> <i>Evidence 136. Praktike per miratimin e kriterëve të pranimit cikli i parë dhe integruar.</i> <i>Evidence 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori.</i> <i>Evidence 171. Lista e mobiliteteve hyrese dhe dalese & analize statistikore FSHMT.</i> <i>Evidence 130. Politika dhe praktika per fitimin e bursave të studentëve dhe perjashtimi nga tarifa vjetore e studimit.</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriterë të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Në fillim të çdo viti akademik, pas kërkesës dhe udhëzimeve të MAS, Departamentet propozojnë dhe përcaktojnë numrin e kuotave dhe kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve, të cilat dërgohen në UMT, miratohen në Senat dhe më pas nga MAS. I gjithë informacioni publikohet në faqen zyrtare të UMT/FSHMT. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedurat e regjistrimit dhe transferimit të studentëve sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. <i>Evidence 138. Raporti i grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritese 23-24.</i> <i>Evidence 25.1. Praktike per miratimin e kriterëve të pranimit cikli i parë dhe integruar.</i> <i>Evidence 25.2. Per-miratimin-e-kriterëve-te-pranimit-C1-dhe-PICD-ne-UMT-2023-2024.</i> <i>Evidence 25.3. Per-disa-shtesa-dhe-ndryshime-ne-VSA-nr.17-Kriteret-e-pranimit...2023-2024.</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Procedura për miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në programet e UMT bazohet në Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, në Statutin e UMT neni 12, 26, 42 dhe Rregulloren e UMT. Institucioni zbaton të gjitha kërkesat ligjore në lidhje me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për të përfunduar procesin e regjistrimit, i cili dorëzohet në sekretarinë mësimore përkatëse. Rregullorja e departamenteve, rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset paraqesin qartë dhe në mënyrë të detajuar programin mësimor, format e mësimdhënies, mënyrën e kontrollit të dijeve, detyrat/projektet e kursit, procesin e diplomimit, etj. Gjithashtu në rregulloren e departamentit paraqiten qartë rregullat

	për ndërprerjen e studimeve, transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme. Informacionet e mësipërme janë të publikuara dhe lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të UMT dhe FSHMT. Në takimin me studentët gjatë vizitës institucionale, GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur në lidhje me informimin dhe komunikimin me sekretariatë mësimore, zyrën e këshillimit të karrierës dhe aksesimit të informacionit në faqen web të FSHMT. <i>Evidence 1. Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë.</i> <i>Evidence 2. Rregullore-e-Universiteti te Mjekesise Tirane.</i> <i>Evidence 21. Rregullore Msc Teknik Laboratori.</i> <i>Evidence 139. Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave te pranimit ne c1, PICD dhe te ciklit te dyte ne UMT.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	FSHMT organizon ditët e hapura informuese për programet e studimit, kriteret e përgjithshme e të veçanta të tij dhe disponon një kalendar të këtyre aktiviteteve. Informacioni përcillet dhe pasqyrohet përmes faqës zyrtare të web (https://fshmt.edu.al/), e cila përditësohet vazhdimisht duke iu ofruar studentëve dhe të interesuarve një informacion të detajuar jo vetëm për programet dhe kurrikulën, por edhe në lidhje me aktivitetet studentore, akademiko-shkencore, sociale, kulturore etj. Gjithashtu, FSHMT vendos në dispozicion të studentëve dhe kandidatëve të interesuar materiale informuese si broshura dhe fletëpalosje, të cilat reflektojnë zhvillimin e institucionit dhe programeve të tij. FSHMT merr pjesë në panairët e organizuara nga dhoma e tregtisë në qytetet e Shqipërisë që i japin mundësinë këtij institucioni të promovojë programet që ofron dhe eventet e ndryshme që organizon në shërbim të studentëve. <i>Evidence E17. Broshure Teknike Laboratori.</i> <i>Evidence E22.1 Urdher rektori grupi i punes per informim maturantesh.</i> <i>Evidence E22.2 Kalendari per informimin e maturanteve 2023.</i> <i>Evidence 108.1. Aktiviteti zyra e karrieres.</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të	UMT planifikon kuota të dedikuara për studentët që vijnë nga kategori të veçanta sociale, studentë me aftësi të kufizuara/veçanta; studentë romë, ballkanas, egjiptian, studentët me statusin e jetimit, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, etj., në përputhje me strategjitë kombëtare përkatëse.

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	UMT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara duke ofruar njëkohësisht mbështetje të vazhdueshme veçanërisht mbështetje financiare në kuadër të politikave mbështetëse për arsimin gjithëpërfshirës. <i>Evidence 139. Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në c1, PICD dhe të ciklit të dytë në UMT.</i> <i>Evidence 137. Praktike per miratimin e kuotave cikli i parë dhe i integruar</i> <i>Evidence 138. Raporti i grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritese 23-24.</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	UMT harton dhe publikon kriteret dhe kuotat për kategoritë e studentëve nga trojet përpara çdo viti akademik bazuar në historikun e kërkesave gjatë viteve paraardhëse. Këto kritere janë në përputhje me aktet nënligjore të MAS. UMT në kuadër të politikave mbështetëse për arsimin gjithëpërfshirës është pjesë e projekteve ndërkombëtare dhe konkretisht në projektin IDEA, me objektiv kryesor rritjen e kapaciteteve manaxheriale, njerëzore dhe infrastrukturore në Shqipëri, Kosovë dhe Mal të Zi. <i>Evidence 139. Procedura per miratimin e kriterëve dhe kuotave të pranimit në c1, PICD dhe të ciklit të dytë në UMT.</i> <i>Evidence 138. Raporti i grupit të punës për verifikimin e kapaciteteve pritese 23-24.</i>
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Çdo vit akademik, UMT harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës financiare për studentët me mesatare të lartë hyrëse në Universitet, për studentët me aftësi të kufizuar, studentët me një prind, fëmijë të ish të dënuarve, fëmijë të policëve të rënë në detyrë, etj. Këto vendime merren nga Bordi i Administrimit të UMT. Studentët e interesuar për fitimin e mbështetjes financiare duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm në zyrat e protokollit të cilat me shkresë shoqëruese të Dekanit të Fakultetit, depozitohen dhe shqyrtohen në Bordin e Administrimit. Kjo procedurë bazohet në Statutin dhe Rregulloren e UMT, ndërsa kostot financiare rimbursohen nga buxheti i shtetit për llogari të UMT. <i>Evidence 89. Te dhenat per bursat e studentëve.</i> <i>Evidence 1. Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë.</i>

	<i>Evidence 2. Rregullore-e-Universiteti te Mjekesise Tirane.</i>			
Konkluzione	– UMT/FSHMT ndjekin dhe zbatojnë politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. – Çdo vit akademik, UMT mbështet studentët me bursa dhe ndihmë financiare, kryesisht studentët ekselentë dhe shtresat në nevojë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	FSHMT, nëpërmjet rregullores së departamenteve, rregullores së programit të studimit dhe syllabuseve, disponon për studentët e programit të studimit informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Gjithashtu, për të ndjekur ecurinë dhe rezultatet akademike të studentëve, institucioni siguron informacion zyrtar edhe nëpërmjet sistemit të menaxhimit, i cili aksesohet nga stafi akademik me kohë të plotë. Në rregullore, studenti gjen informacion për shkallen e frekuentimit të detyruar të programit të studimit: 1. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 50%. 2. Frekuentimi i seminareve/ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75%. 3. Frekuentimi i punëve laboratorike, detyrave të kursit dhe mësimit praktik është i detyrueshëm në masën 100%. Kur studenti nuk ka frekuentuar mbi 50% dhe/ose 25% për pikat 1 dhe 2 ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimit në vitin pasardhës me të njëjtin detyrim frekuentimi. Për pikën 3, nëse studenti nuk ndjek qoftë edhe një seancë mësimi, atij i krijohet një mundësi për ta shlyer frekuentimin e detyruar përpara përfundimit të semestrit.

	Në rast të përsëritjes së mungesave, studenti i ndjek ato në vitin pasardhës. Gjatë bisedës me studentët në vizitën institucionale, GVJ u informua se studentët njihen me kriteret e vlerësimit për secilën lëndë edhe në orën e parë të leksionit ku pedagogu përkatës bën prezantimin e syllabusit. Gjatë vizitës në sekretari, GVJ verifikoi regjistrat e frekuentimit të procesit mësimor nga studentët e çdo grupi mësimor, i cili plotësohet në çdo orë mësimore nga pedagogu përkatës. Në rregullore studenti gjen informacion në lidhje me kriteret e kalimit nga një vit në tjetrin: 1. Studenti i vitit të parë kalon në vitin e dytë nëse ai ka marrë jo më pak se 30 kredite të vitit të parë, e vlefshme për ciklin e parë dhe të dytë të programit të studimit. 2. Për programin e studimit të ciklit të parë, studenti i vitit të dytë kalon në vitin e tretë nëse ai ka marrë jo më pak se 90 kredite. <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT.</i> <i>Evidence 6. Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidence 21. Rregullore Msc teknik laborator.</i> <i>Evidence 92. Sylabuse MASTER SHKENCOR TEKNIKE LABORATORI_firmosur.</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Zyra e Sekretarisë Mësimore të FSHMT informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Rregullorja e departamenteve dhe e programit të studimit ka nene specifike për procedurat e transferimit, ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësinë e ndjekjes së programeve të dyta. Në nivel departamenti ngrihet një komision ad-hoc, i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme, shqyrton kërkesën e studentëve për transferimin e krediteve. Kreditet e transferuara të studentëve hyjnë në fuqi me miratimin e Rektoratit. Për t'u diplomuar, studentët e transferuar duhet të fitojnë të paktën 50% të totalit të krediteve në UMT. <i>Evidence 134. Procedura e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit I, II, III (SPA).</i> <i>Evidence 98.1. Tabela me statistikat e studentëve_msc. (regjistrim, transferim, diplomim_2020-2023).</i> <i>Evidence 109. Analize vjetore sekretaria mesimore.</i> <i>Evidence 21. Rregullore Msc teknik laborator.</i>

Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.

Kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit janë të specifikuara në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentëve mbështetet në vlerësimin semestral/vjetor të punës në auditor, rezultateve të praktikave, laboratorëve, seminareve, detyrave, projekteve etj., por provimi është forma kryesore për kontrollin e dijeve të përvetësuar.

Studenti gjen informacion të detajuar edhe në syllabuset e lëndëve, gjithashtu për çdo paqartësi kërkon ndihmë në sekretarinë mësimore ose tek pedagogu përkatës.

Syllabusi i çdo lënde të programit të studimit përcakton mënyrën dhe kriteret e vlerësimit të studentëve.

Kontrolli i dijeve të përfituara realizohet nëpërmjet:

1. Provimit të Ndërmjetëm (15 % e notës përfundimtare).
2. Provimit Përfundimtar (80% e notës përfundimtare).
3. Komponentë të tjerë (5–10% e notës përfundimtare), ky komponent përbëhet nga një kombinim i detyrave të kursit, rasteve studimore, punës në laborator, etj.

Forma të tjera të kontrollit të dijeve bazuar në syllabuset e programit të studimit Msc Teknik Laboratori janë:

- ❖ Në pjesën më të madhe të lëndëve vlerësimi me Provim të Ndërmjetëm (në disa raste mungon) 15% / Seminar ose Praktikë 5% / Provimi Përfundimtar 80%.
- ❖ Në lëndën Komunikim Profesional mungon vlerësimi në të gjitha detyrimet respektive dhe pesha e kontrollit të vazhdueshëm shkon 100% për Provimin Përfundimtar.
- ❖ Në disa lëndë të tjera kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet Provimit të Ndërmjetëm 15% / Frekuentimi 5% / Aktivizimi 5% / Detyra e Kursit 5% / Provimi Përfundimtar 70%.
- ❖ Algoritma Diagnostikë dhe Laboratorikë / Epidemiologji, etj., Provim të Ndërmjetëm ose Praktika dhe Detyrë Kursi 10% / Provimi Përfundimtar 90%.
- ❖ Një formë totalisht e re e vlerësimit të kontrollit të vazhdueshëm konstatohet në lëndët: Shkrim Akademik – Provimi i Ndërmjetëm 30% / Seminar 10% / Provimi Përfundimtar 60%.
- ❖ Në lëndën Metodologji e Kërkimit Shkencor - Kolokiume 10% / Seminare 10% / Detyrë Kursi 20% / Provim Final 50% (90% në total).

	❖ Ekzaminimet Laboratorike në Pediatri dhe Urgjencë Pediatrike, etj, nuk paraqitet fare vlerësimi i kontrollit të vazhdueshëm. - Bazuar në të dhënat e mësipërme, GVJ konstatoi <i>mungesën e një formati të njëjtë vlerësimi midis lëndëve të ndryshme si edhe mungesën e zhvillimit të Provimit të Ndërmjetëm</i> në pjesën më të madhe të Syllabuseve çka do të lehtësonte procesin e të nxënies tek studentët dhe do të konsistonte në një kontroll të dijeve të vazhdueshëm përgjatë gjithë semestrit apo vitit akademik. <i>GVJ rekomandon institucionin të hartojë një udhëzues për unifikimin e procesit të vlerësimit me të gjithë komponentët e domosdoshëm të vlerësimit në nivel institucional</i>, duke lejuar në këtë mënyrë studentët të kenë mundësinë të identifikojnë mangësitë dhe ti plotësojnë ato përpara përfundimit të lëndës në fund të semestrit apo vitit akademik. Kontrolli i dijeve behet me shkrim/me goje/i kombinuar. Mënyrat e vlerësimit dhe detyrimet i bëhen të ditura studentëve në fillim të procesit mësimor, kurse piket e fituara dhe vlerësimet gjatë vitit i bëhen të njohura para provimit. Në takimin me studentët, GVJ konstatoi se studentët ishin të kënaqur me transparencën e vlerësimit dhe kishin të drejtën për rishikimin e tezës së provimit. <i>Evidence 21. Rregullore Msc teknik laborator</i> <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT.</i> <i>Evidence 92. Syllabuse MASTER SHKENCOR TEKNIKE</i> <i>LABORATORI_firmosur.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Rregullorja e departamenteve dhe e programit të studimit Msc Teknik Laboratori përcakton qartë kriteret dhe procedurat e diplomimit. Sipas rregullores, studimet e ciklit të dytë Master Shkencor përmbyllen me punim/temë diplome. Bazuar në këto rregullore, Departamenti, si strukturë përgjegjëse për realizimin e këtij programi studimi, informon studentët lidhur me kriteret e diplomimit, procedurën e vlerësimit, mundësinë e ankimimit dhe rivlerësimit me qëllim që t'u krijojë atyre kushtet e nevojshme për realizimin me sukses të këtij procesi. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion (diploma dhe suplementi i diplomës), GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit, objektivat formuese dhe karakterizuese të tij.

	<i>Evidence 21. Rregullore programi mp. Teknik Laboratori</i> <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT.</i> <i>Evidence 6. Rregullore Departamenti _DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidence 22.2. Format diplome Msc. teknik laborator.</i> <i>Evidence 22. Format suplementi Msc teknik laborarori.</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike stafi akademik dhe administrativ i FSHMT organizon ditë të hapura (open day) për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit dhe infrastrukturën e institucionit. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizon gjurmimin e studentëve dhe luan rol në informimin e tyre për çdo paqartësi edhe gjatë frekuentimit të vitit akademik. Institucioni publikon broshura, fletëpalosje si edhe përditësime në faqen zyrtare web, rrjetet sociale të UMT, FSHMT me qëllim promovues dhe informues të programeve të studimit. <i>Evidence E17. Broshure Teknike Laboratori</i> <i>Evidence 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.</i> <i>Evidence 108.1. Aktiviteti zyra e karieres.</i>			
Konkluzione	– Institucioni vendos në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e vlerësimit të dijeve dhe diplomimit në programin e studimit Master Shkencor në Teknik Laboartori. – GVJ rekomandon institucionin të hartojë një udhëzues për unifikimin e procesit të vlerësimit me të gjithë komponentët e domosdoshëm të vlerësimit në nivel institucional. – Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UMT/FSHMT informon publikun dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit duke organizuar ditë të hapura dhe duke publikuar broshura dhe informacione të përditësuara në faqen zyrtare web të universitetit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët që ndjekin programin Msc Teknik Laboratori informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes zyrës së sekretarisë mësimore, platformës E/UMT, takimeve me stafin akademik, faqes zyrtare në rrugë elektronike apo broshurave informuese të publikuara. Kandidatët e interesuar mund të gjejnë fizikisht dosjen e programit të studimit pranë zyrave të shërbimit të studentëve, dosje ku mund të gjejnë informacion mbi objektivat formuese të programit, planet mësimore, syllabuset, rregulloren, suplementin e diplomës etj. <i>Evidence 36. Platforma eUMT_VSA.</i> <i>Evidence 188. Rregullore e sekretarisë mesimore.</i> <i>Vizita institucionale – Takimi me sekretarinë, stafin dhe studentet</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni disponon dokumentacion për programin e studimit/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese i organizuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Studenti gjen informacion për organizimin dhe shpërndarjen e lëndëve në semestra, kreditet për secilën prej tyre, klasifikimin e lëndëve sipas llojit të veprimtarisë formuese. Studenti merr informacion gjithashtu nga syllabuset çdo fillim semestri si edhe nga faqja zyrtare web e institucionit. <i>Evidence 86. PROGRAMI Msc Teknik Laboratori 2020-2022.</i> <i>Evidence 91. Plan mesimor 2023-2024.</i> <i>Evidence 92. Syllabuse Master Shkencor teknik laborator, firmosur.</i> <i>Evidence 143. Nderfaqë web UMT.</i> <i>Evidence E17. Broshure Teknike Laboratori</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Gjatë vizitës institucionale, në takimin me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, GVJ kërkoi informacion për mundësitë e punësimit të studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon Panairin e Punës, në të cilin janë të ftuar të marrin pjesë partnerët prej vitesh në UMT. Panairi Vjetor i Punës është tregues kryesor mbi mbështetjen për punësimin e studentëve për arsye të pjesëmarrjes të një numri të

	konsiderueshëm institucionesh/kompani të cilat ofronin mundësi punësimi dhe praktike për studentët e të gjitha programeve të studimit. Për më tepër, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstatoi se Zyra e Karrierës organizon gjatë vitit një numër të konsiderueshëm aktiviteteve me natyrë orientuese e këshilluese të studentëve drejt tregut të punës. <i>Evidence 107. Manuali i keshillimit të karrierës fshmt.</i> <i>Evidence 108. Aktivitete të Zyres së Karrierës FSHMT.</i> <i>Evidence 120. Te dhena për Alumni nga Udherat profesionale.</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se studentët marrin pjesë edhe në ditët e hapura të organizuara nga institucioni në fillim të çdo viti akademik, ku gjatë vizitave të tyre në ambientet e universitetit informohen në lidhje me zyrat dhe shërbimet e ndryshme që ato ofrojnë. Gjithashtu, GVJ në takimin me studentët konstatoi se studentët ishin të mirë informuar për infrastrukturën, organizimin e programit si syllabuset, oraret mësimore, organizimin e praktikave profesionale dhe orëve të laboratorit. Në shërbim të studentëve janë Biblioteka, Zyra e Këshillimit dhe Sekretaria Mësimore. <i>Evidence E17. Broshurë Teknike Laboratori.</i> <i>Evidence 118. Infrastruktura në funksion të mesimdhënie, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	UMT disponon sistemin e menaxhimit Pitagora përmes të cilit studentëve u ofrohet informacion në lidhje me programin e studimit. Zyra IT u siguron studentëve një emër përdorimi dhe kod për të pasur akses në listën e tyre të notave, mungesat e tyre si dhe situatën e tyre financiare. Informacioni dhe aksesit në platformën Pitagora është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. <i>Evidence 149. Përshkrim i funksionaliteteve të sistemit PITAGORA.</i> <i>Evidence 40. Nderfaqë sistemi PITAGORA.</i>
Konkluzione	– Institucioni mundëson përfshirjen e studentëve në aktivitete informuese dhe mbështetëse për orientimin dhe promovimin e tyre drejt tregut të punës. – FSHMT për programin e studimit Msc në Teknik Laboratori siguron infrastrukturën e nevojshme dhe informacion të

	përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, organizimin e syllabuseve, literaturën e nevojshme, orarin e mësimi, praktikave profesionale dhe orët laboratorike, dhe aktiviteteteve jashtë kurrikulare. – Institucioni disponon sistem të menaxhimit të brendshëm të informacionit lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	FSHMT disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve sipas programit të studimit, të diplomuarit dhe të dhënat e punësimit të tyre. Gjatë vizitës institucionale në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se sekretaria disponon regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e lëshimit të diplomave, regjistrin me të dhënat akademike, të cilat depozitohen në institucion dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Në takimin me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumni si edhe të Drejtorisë së Kurrikulave, GVJ u informua se ata disponojnë informacion të përditësuar çdo vit mbi punësimin e studentëve, emrat e kompanive/institucioneve ku ata janë pozicionuar, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me të diplomuarit dhe Alumni. Këto të dhëna mblidhen, analizohen dhe pasqyrohen në raportet vjetore të këtyre strukturave zyrtare. <i>Evidence 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.</i> <i>Evidence 108.1. Aktiviteti zyra e karrieres.</i> <i>Evidence 109. Analize vjetore sekretaria mesimore.</i> <i>Evidence 188. Rregullore e sekretarise mesimore.</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi,	Institucioni disponon sistem menaxhimi që mundëson dhe ruan të dhënat e studentëve të regjistruar në programin e studimit, studentët që diplomohen, studentë që ndërpresin përkohësisht ose në mënyrë të përhershme studimet. Ky sistem menaxhohet nga sekretaria mësimore e cila i përdor këto të dhëna për raportime të ndryshme apo analiza statistikore në

si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	zbatim të udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ASCAL-it apo QSHA-së, etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi gjithashtu se sekretaria disponon dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor, listat e studentëve frekuentues, dokumente të transferimit, regjistrimit në programe të dyta dhe të çregjistrimit të tyre. <i>Evidence 32. Sherbimet per studentet_kerkesa_FSHMT</i> <i>Evidence 33. Sherbimet per studentet – Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike.</i> <i>Evidence 109. Analize vjetore sekretaria mesimore.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit EasyWeb LMS. Aksesit në arkivin elektronik është i dedikuar dhe administrohet nga personeli informatikë që ka rektorati dhe fakultetet. Kjo platformë përdoret lehtësisht edhe nga sekretaria mesimore, si njësi e autorizuar për hedhjen, verifikimin dhe ruajtjen e të dhënave. Në kuadër të ruajtjes së të dhënave personale, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në përputhje me aktet nënligjore në fuqi dhe rregulloren e UMT. Në vizitën institucionale në sekretarinë mesimore të FSHMT, GVJ inspektoi dokumentacionin e arkivuar dhe u informua se sekretaria disponon dokumentacion në dy formate, fizik (kopja në letër) dhe elektronik. Të dhënat e studentëve ruhen në versionin zyrtar dhe skanohen në formatin elektronik. <i>Evidence 147: Pershkrim i funksionaliteteve te platformes E-UMT</i> <i>Evidence 43: Nderfaqë_Sistem elektronik i dedikuar per pikezimin dhe renditjen e aplikanteve</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe	UMT ka ngritur dhe zhvilluar struktura të posaçme si Njësia e Auditit të Brendshëm [NJAB] të cilat kryejnë kontrolle periodike pranë të gjitha njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, departamentet, sistemin e menaxhimit të brendshëm) të cilat bëjnë vlerësimin e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët, veprimtarinë e tyre përkatëse, sigurojnë zbatimin e duhur dhe respektimin e kërkesave ligjore të dala nga organet kolegjiale apo drejtuese të institucionit.

të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ evidentoi disa nga rezultatet e auditimit të brendshëm në raportet vjetore të institucionit dhe shqyrtimit të dokumenteve të tjera të vënë në dispozicion. <i>Referenca 50: Praktika e ndjekur për auditim nga njësi audituese e jashtme (UNICEF)</i> <i>Referenca 51: Praktika e ndjekur për auditim nga Njësia e Auditit të Brendshëm</i> <i>Evidence 79.1. Raporti Vjetor _UMT_ 2021-2022.</i>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Bazuar në dokumentacion, GVJ gjeti raporte analitike të hartuara nga njësia bazë dhe departamentet në formën e analizës vjetore. Këto raporte ofrojnë informacion mbi veprimtarinë mësimore, kërkimore/shkencore, financiare, monitorimin e provimeve dhe diplomimit, etj. Sekretaria mësimore harton gjithashtu një raport analitik mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Zyra e Karrierës dhe Alumnit harton raporte vjetore mbi profilet e studentëve të ardhur dhe aktualë dhe shkallën e punësimit të tyre. Gjatë takimit me përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, GVJ u informua se gati 97% e studentëve të FSHMT janë punësuar në kompani të ndryshme prestigjioze. Gjatë takimit u deklarua gjithashtu se të dhëna për punësimin merren edhe nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë dhe se ka një interes të shtuar të studentëve për punësim jashtë vendit. <i>Evidence E13. Punësimi dhe cilësia e studentëve</i> <i>Evidence 120. Të dhëna për Alumni nga Udhërat profesionale.</i> <i>Evidence 107. Manuali i karrierës së studentëve FSHMT</i> <i>Evidence 108. Aktivitete të zyrës së karrierës FSHMT</i> <i>Evidence 82. Raporti vjetor FSHMT 2023.</i> <i>Evidence 85. Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGj.</i> <i>Vizita institucionale</i>
Konkluzione	– Institucioni disponon statistika vjetore për numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mos përfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. – Njësia bazë dhe strukturat në shërbim të studentëve hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, shoqëruar me masat e ndërmarra për përmirësimin e këtyre treguesve konkretë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë [LAL 80/2015, neni 54, 55], Statutin e UMT dhe rregulloren e FSHMT, institucioni garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se ka 2 përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik të UMT, 1 student në përbërjen e NJSBC në nivel rektorati. Gjithashtu studentët janë organizuar në Këshilla Studentorë në nivel universiteti dhe fakulteti, të cilat funksionojnë edhe si tutoriat studentor. Këshillat studentore e bazojnë aktivitetin e tyre në Statutin dhe rregulloren e Këshillit Studentor. Studentët janë pjesëmarrës në hartimin e RVB, gjë që u konstatua jo vetëm nga përbërja e komisionit në dokumentacion, por edhe në takimin me përfaqësues të GVB në vizitën institucionale. <i>Evidence 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT</i> <i>Evidence 126. Rregullore e zgjedhjeve të Këshillit Studentor në UMT</i> <i>Evidence 124. Lista e aktiviteteve të Këshillit Studentor UMT_FSHMT</i> <i>Evidence 125. Përberja e Këshillit Studentor UMT.</i> <i>Evidence 127. Statuti i Këshillit Studentor UMT</i> <i>Evidence 4.1. Urdher për ngritjen e GVB.</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale,	Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në zgjedhjet për organet dhe autoritet drejtuese, si Senati Akademik, NJSBC, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, etj. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se studentët plotësojnë çdo vit akademik pyetësorët duke dhënë vlerësimin e tyre mbi procesin akademik.

konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Ata konfirmuan gjithashtu se marrin pjesë aktive në aktivitete promociionale dhe projekte studimore në bashkëpunim me pedagogët e tyre, gjë që është lehtësisht e verifikueshme në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ. Në RVB theksohet se studentët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në evidentimin e problematikave të mësimdhënies online gjatë periudhës së pandemisë. Ata kanë treguar gatishmëri dhe asistencë për studentë që kanë pasur probleme gjatë tërmetit të Nëntorit 2019 apo për studentë dhe familjarë të tyre të prekur nga Covid-19. Studentët kanë kontribuar në miratimin e një sërë vendimesh në kuadër të diskutimeve të Paktit për Universitetin që synonte t'i jepte zgjidhje kërkesave të studentëve dhe problemeve me arsimin e lartë në Shqipëri. <i>Evidence 1. Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidence E13. Punesimi dhe cilesia e studentëve. Tabela per Aktivitetin shkencor i IAL.</i> <i>Evidence 27. Pyetësi i studentëve ne FSHMT 23</i> <i>Evidence 28. Rezultatet e pyetësorit te studentëve 2023</i> <i>Evidence 62. Pyetësor mbi perdorimin e pajisjeve teknologjike nga studentet per mesimin online.</i> <i>Evidence 124. Lista e aktiviteteve Keshilli Studentor UMT.</i> <i>Evidence E1. Aktiviteti shkencor i studentëve teknik laborator.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	FSHMT përdor një sërë mekanizmash për përfshirjen e studentëve në përmirësimin e programit të studimit. Këshilli studentor është organi ku studentët diskutojnë problematikat në procesin e mësimdhënies dhe kanë të drejtën e rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit bazuar edhe në rregulloren me të cilën funksionon këshilli. Studentët shprehin opinionin e tyre në lidhje me kurrikulën dhe programin mësimor edhe nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar prej tyre. <i>Në RVB theksohet se nuk ka ndryshim të kurrikulës në 3 vitet e fundit. GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që lidhet me praktikën për miratimin e planeve mësimore evidentoi ri konfirmim të planit mësimor të pandryshuar për programin master shkencor në Teknik laborator.</i> Gjatë takimit me studentët, ata vlerësuan se programi përmbush pritshmërinë e tyre dhe i përkatit për tregun e punës, gjithashtu vlerësuan raportin teori/praktike dhe cilësinë e mësimdhënies.



	Institucioni në bashkëpunim me këshillat studentore kontribuon në përmirësimin e jetës profesionale dhe sociale të studentëve nëpërmjet mbështetjes me kapacitete akademike dhe bursa financimi. <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT.</i> <i>Evidence 127. Statuti i Keshillit Studentor UMT</i> <i>Evidence 126. Rregullore e zgjedhjeve të Keshillit Studentor në UMT</i> <i>Evidence 27. Pyetësi i studentëve në FSHMT 23</i> <i>Evidence 28. Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023</i> <i>Evidence 130. Politika dhe praktika për fitimin e bursave të studentëve dhe përjashtimi nga tarifa vjetore e studimit.</i> <i>Evidence 11. Praktike për miratimin e planeve mesimore.</i> <i>Vizita institucionale, takimi me studentet</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloren e FSHMT dhe të departamentit përcaktohet qartë procedura e ankimimit të studentit për rezultatin e provimit. Kur studenti ka kryer ankimim për vlerësimin, i drejton kërkesë me shkrim Komisionit të Provimit brenda 24 orëve, i cili është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin. Nëse studenti nuk bie dakord me vlerësimin e komisionit të provimit depoziton ankesë zyrtare tek drejtuesit e departamenteve, të cilët bëjnë verifikimet e duhura së bashku me komisionin e provimit dhe njofton studentin për vendimin e marrë. Kur studenti nuk është dakord edhe me vendimin e njësisë bazë, depoziton ankesë me shkrim në sekretarinë e dekanit brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit. Ankesa shqyrtohet nga dekani dhe në rastin kur kërkesa miratohet, Dekani ngre një komision ad-hoc për rishikimin e tezës. Korigjimi i tezës me anë të sistemit CleanScore e ka bërë më transparent këtë proces. Kjo u konfirmua edhe në takimin me studentët, të cilët ishin të kënaqur me procedurën dhe transparencën e zhvillimit të provimeve. <i>Evidence 31. Procedura e provimeve dhe kontrollit të dijeve.</i> <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT</i> <i>Evidence. 6 Rregullore Departamenti_DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidence 64. Praktike për monitorimin e sezonit të Vjeshtës FSHMT</i> <i>Evidence 65. Procedurë për monitorimin dhe verifikimin e dokumentacionit të provimeve</i> <i>Evidence 145. Relacion cleanscore.</i>

Konkluzione	– Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e UMT dhe Rregulloren e FSHMT, institucioni garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese. – Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në zgjedhjet për organet dhe autoritet drejtuese, si: Senati Akademik, NJSBC, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, etj., si edhe përmes vlerësimit të opinionit të tyre në lidhje me kurrikulën, cilësinë e mësimdhënies, raportit teori/praktikë dhe pjesëmarrjes në aktivitete shkencore dhe promovionale. – GVJ evidentoi se nuk ka ndryshim të kurrikulës në 3 vitet e fundit dhe se FSHMT përdor një sërë mekanizmesh për përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit. – Në rregulloren e FSHMT dhe të Departamenteve përcaktohet qartë procedura e ankimimit të studentit për rezultatin e provimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni disponon procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. Në shërbim të informimit të studentëve janë Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni, Zyra e IT, etj. <i>Evidence 181. Rregullore e funksionimit NjsBC-UMT.</i> <i>Evidence 107. Manuali i keshillimit te karrieres fshmt.</i> <i>Evidence 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.</i> <i>Evidence 188. Rregullore e sekretarise mesimore.</i> <i>Evidence 33. Sherbimet per studentet_FSHMT.</i> <i>Evidence 178. Rregullore-Për-Administrimin-Financiar-Kontabilitetin-dhe-Kontrollin-në-UMT</i>

Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve është funksional dhe bazohet në misionin dhe detyrimet e strukturave përgjegjëse të përmendura në kriterin 1. Këto struktura mbështesin dhe informojnë studentët në lidhje me aktivitetin akademik, karrierën që do të ndjekin, licencimin dhe akreditimin e programeve, etj. Në takimin me studentët, ata u shprehen të kënaqur lidhur me disponibilitetin e këtyre strukturave për informim dhe shërbime. <i>Evidence 181. Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.</i> <i>Evidence 188. Rregullore e sekretarise mesimore.</i> <i>Evidence 33. Shërbimet për studentet_FSHMT</i> <i>Evidence 107. Manuali i keshillimit te karrieres fshmt.</i> <i>Takimi me studentet</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në institucion funksionon Zyra për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni e cila informon dhe mbështet studentët për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Ky sektor gjithashtu organizon dhe koordinon aktivitete shkencore si trajnime, seminare, konferenca studentore, orë leksioni të hapura nga lektorë të ftuar, promovon aftësitë dhe prijet e studentëve në fusha të tjera si letërsi, art, etj. Gjithashtu harton Guidën Studentore, materialet udhëzuese për maturanët, të dhënat statistikore mbi numrin e studentëve aktualë, studentëve të diplomuar, zhvillimin e strategjive për punësim, etj. <i>Evidence 107. Manuali i keshillimit te karrieres fshmt.</i> <i>Evidence 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.</i> <i>Takimi me studentet</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në takimin me përfaqësues të Zyrës se Karrierës por edhe në shqyrtimin e dokumentacionit, GVJ verifikoi se kjo njësi disponon të dhëna për të diplomuarit mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit, ndjek integrimin e tyre në tregun e punës dhe mban kontakte me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të e-mail-it me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni hartojnë raporte statistikore mbi numrin e studentëve të punësuar dhe i vendos në dispozicion të organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. <i>Evidence 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.</i> <i>Evidence E13. Punesimi dhe cilesia e studentëve.</i>

Konkluzione	– FSHMT disponon procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatorë të institucionit. Në funksion të informimit janë Sekretaria Mësimore, Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës dhe Alumni, Zyra e IT, Departamenti i Financë Kontabilitetit. – Zyra e Karrierës dhe Alumnit realizon informimin e studentëve dhe shërbime të tjera nga momenti regjistrimit deri në diplomimin e tyre. Ajo mban kontakte me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të e-mail-it dhe disponon data basë për të diplomuarit mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të cilat përditësohen vazhdimisht duke hartuar njëkohësisht edhe raporte statistikore. – Informacioni i Alumnit i vihet në dispozicion departamentit përkatës me qëllim bashkëpunimin për interesa të përbashkëta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se UMT ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Strategjia e mësimdhënies, mësim nxënies dhe metodave të vlerësimit e hartuar për periudhën 2021-2024 ka si qëllim arritjen e objektivit për ekselencë në mësimdhënie dhe konfirmon rishikimin e kurrikulave për të gjitha programet sipas nevojave të tregut.

	Për arrijten e këtyre objektivave dhe në kuadër të strategjisë për ndërkombëtarizimin është bërë e mundur mobiliteti i stafit në universitete prestigjioze për të përfutur përvoja akademike ndërkombëtare dhe për të implementuar metoda inovatore të mësimdhënies dhe të të nxënit me në qëndër studentin. Në RVB theksohet se Përgjegjësit e Departamenteve i kushtojnë vëmendje trajnimit të personelit akademik që jep mësim për herë të parë duke ofruar njohuri mbi kurrikulat, mënyrën e përgatitjes së programeve të lëndëve dhe shpjegimin e rregulloreve të institucionit. <i>Evidence 170: Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	UMT ka miratuar dhe ka funksional struktura të sigurimit të cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin në mënyrë periodike të programeve të studimit dhe performancës në mësimdhënie dhe inovacion të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Këto struktura përgjegjëse përfshijnë Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC), Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Departamentet përkatëse në secilin Fakultet. GVJ evidentoi se FSHMT ka ngritur një komision ad-hoc për garantimin e cilësisë në nivel fakulteti. Bazuar në dokumentacion dhe në takimet me përfaqësues të zyrave, GVJ evidentoi se FSHMT ka vetëm 1 përfaqësues në NJSBC e UMT. Në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore NJSBC me monitorim të KPSSC zhvillon dy herë në vit pyetësorët e studentëve për matjen e performancës dhe cilësisë në mësimdhënie. Rezultatet e pyetësorëve u bëhen të ditur autoriteteve drejtuese në rektorat, dekanat, departament si edhe pedagogëve përkatës duke analizuar nevojat dhe sugjerimet e studentëve. <i>Evidence 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT.</i> <i>Evidence 27: Pyetësi i studentëve ne FSHMT 23</i> <i>Evidence 28: Rezultatet e pyetësorit te studentëve 2023</i> <i>Evidence 69: Perberja e NJSBC-VSA nr.103, dt.20.10.2020</i> <i>Evidence E 20.3 Perberja e NJSBC ne FSHMT.</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e	Statuti i UMT sanksionon të drejtën e studentëve për të qënë pjesë e strukturave përgjegjëse për sigurimin dhe standardet e cilësisë, por edhe të komisioneve të tjera në nivel institucional, njësie bazë dhe departamenti.

metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Studentët përfshihen në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve. Gjithashtu, institucioni gjurmon pakënaqësitë ose kërkesat e ndryshme të studentëve nëpërmjet zhvillimit online/onsite të peticioneve/ankimeve të tyre me natyrë akademike dhe administrative. Në këtë mënyrë, studentët japin kontributin e tyre në zhvillimin institucional dhe sigurimin e cilësisë. <i>Evidence 1. Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë</i> <i>Evidence 61. Procedurë ankimi i studentit për vlerësimin</i> <i>Evidence 27: Pyetësi i studentëve në FSHMT 23</i> <i>Evidence 28: Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Institucioni dhe njësitë bazë të tij hartojnë raporte dhe analiza vjetore për vlerësimin e veprimtarisë dhe performancës akademike në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë e sanksionuar në nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 80/2015: "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë". Vlerësimi i performancës së stafit akademik përfshin mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe aktivitetin administrativ apo mbështetës. Detyrimet akademike dhe aktivitetet e parashikuara në planin vjetor të punës deklarohen nga stafi nëpërmjet një formulari standard të vlerësimit, i cili dorëzohet tek drejtuesit e njësive bazë. Njëkohësisht, në kuadër të transparencës, KPSSC dhe NJSBC publikojnë raportet përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të UMT. Gjithashtu, siç u theksua edhe me lart, NJSBC bën publike rezultatet e pyetësorëve të studentëve duke adresuar sugjerimet e tyre në mbështetje të rritjes së cilësisë dhe standardeve të mësimdhënies. <i>Evidence 155: Shembull Vlerësimi i performancës së stafit administrativ</i> <i>Evidence 156: Formulari raporti për realizimin e veprimtarisë akademike</i> <i>Evidence 28: Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023</i> <i>Evidence 79: Raport vjetor UMT 2020-21</i> <i>Evidence 82. Raport vjetor FSHMT 2022-2023</i>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të	Institucioni përdor instrumente dhe mekanizma të brendshëm për vlerësimin e stafit akademik, të cilat kanë për qëllim nxitjen e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe promovimin e praktikave më të mira.

praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi disa instrumente për vlerësimin e stafit akademik siç janë <i>pyetësorët</i> e plotësuar nga studentët apo analizat statistikore nga NJSBC dhe fakultetet bazuar në rezultatet e tyre, <i>raporti vjetor</i> në nivel fakulteti dhe departamenti që vlerëson veprimtarinë mësimore, aktivitetin botues dhe kërkimor-shkencor të stafit akademik si edhe <i>raport vlerësimi i performancës individuale</i> me komentet dhe sugjerimet që i përcillen Rektoratit nga përgjegjësit e departamenteve të çdo njësie bazë. Në këto raporte janë promovuar shembuj të praktikave të mira dhe janë evidentuar adresimi i problematikave dhe janë përcaktuar objektivat për përmirësimin e këtyre problematikave. <i>Evidence 82: Raport vjetor FSHMT 2022-2023</i> <i>Evidence 85: Raport i aktivitetit i Departamentit 2022</i> <i>Evidence 28: Rezultatet e pyetesorit te studentëve 2023</i> <i>Evidence 155. Shembull Vleresimi i performances se stafit administrativ.</i> <i>Evidence 156. Formular raporti per realizimin e veprimtarise akademike.</i> <i>Evidence E2.1 Aktiviteti shkencor stafi akademik teknik laborator.</i> <i>Evidence 14. Shembull formulari i performances 2023.</i>			
Konkluzione	– UMT ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. – Institucioni ka miratuar dhe ka funksionale, struktura të sigurimit të cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për vlerësimin dhe monitorimin në mënyrë periodike të programeve të studimit. Kjo njësi, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore zhvillon dy herë në vit pyetësorët e studentëve për matjen e performancës dhe cilësisë në mësimdhënie. – Sistemi i sigurimit të brendshëm funksionon në nivel institucional dhe njësie bazë. – Institucioni përdor instrumentë dhe mekanizma të brendshëm për vlerësimin e stafit akademik. GVJ gjeti raporte që promovojnë shembuj të praktikave të mira, adresim të problematikave dhe përcaktim të objektivave për përmirësimin e problematikave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë, UMT ka ndërtuar politika dhe procedura si edhe ka ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UMT. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ gjeti evidence të formatit të pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve administrative, formatin për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrativ. Gjithashtu në RVB theksohet roli i komisioneve të ngritura në nivel institucional për veprimtari të ndryshme në shërbim të institucionit, si: Këshilli i Etikës, Komisioni i Përhershëm i Promovimit të Personelit Akademik, Njësia Sigurimit të Cilësisë për FSHMT, etj. <i>Evidence 1. Statuti-i-Universitetit-të-Mjekësisë-Tiranë.</i> <i>Evidence 2. Rregullore-e-Universiteti te Mjekësisë Tirane.</i> <i>Evidence 14. Shembull formulari i performances 2023.</i> <i>Evidence 27. Pyetësori i studentëve_fshmt_23.</i> <i>Evidence 62. Pyetësori mbi përdorimin e pajisjeve teknologjike nga studentet për mesimin online.</i> <i>Evidence 71. Perberja e Këshillit të Etikës.</i> <i>Evidence E 20.1 Perberja e Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik.</i> <i>Evidence E 20.6 Perberja e Këshillit të Botimeve.</i> <i>Evidence E 20.3 Perberja e NJSBC në FSHMT.</i> <i>Evidence E 20.4 Perberja e Komisionit të përhershëm për dhenien e grades Doktor në FSHMT.</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen	UMT ka ngritur Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ku funksionon edhe NJSBC. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është ngritur me vendim senati dhe është organ kolegjal me një mandat 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Ajo e bazon aktivitetin e saj në legjislacionin në fuqi, në Standardet Shtetërore të Cilësisë, Statutin dhe Rregulloren e UMT, Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, vendimet e senatit, urdhrat e brendshëm dhe kodin e cilësisë miratuar me VKM.

studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Politikat për sigurimin e cilësisë janë përshkruar edhe në Planin e Zhvillimit Strategjik 2021-2024 të UMT. NJSBC ka përmbushur detyrimin ligjor për të hartuar një raport vjetor për veprimtarinë e saj. Ajo funksionon si një strukturë e pavarur dhe e përhershme pranë institucionit dhe ushtron një sërë aktivitete: – Bën mbledhjen e të dhënave sipas treguesve sasiorë dhe cilësorë për institucionin dhe programet e studimit. – Organizon vlerësimin periodik në të gjitha fushat apo specifike të sigurimit të cilësisë. – Krijon një sistem dokumentacioni për sigurimin e cilësisë dhe përditëson procedurat e ndryshme në funksion të sigurimit të cilësisë. – Realizon vlerësimin për stafin akademik me anë të anketimeve dhe pyetësorëve të studentëve, merr në konsideratë vlerësimin për performancën e stafit në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor, mbështetjen administrative. – Kryen analizën e pyetësorëve institucionale. – Bashkërendon dhe asiston procesin e vlerësimit të brendshëm në të gjitha nivelet, etj. <i>Evidence 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT.</i> <i>Evidence 170. Plani-Strategjik-i-Zhvillimit-të-UMT-së-2021-2024.</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ, bazuar në dokumentacion dhe në takimin me përfaqësues të NJSBC, evidentoi se institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë, si: sondazhet me studentët, vlerësimin e performancës së personelit akademik, takime/trajnime me ekspertë të fushës, vëzhgime të procesit mësimor dhe monitorimit të provimeve, etj. Vetëvlerësimi apo vlerësimi i jashtëm institucional i UMT, kanë qënë dhe janë gjithashtu procese të rëndësishme që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë dhe mekanizmave të sigurimit të saj brenda institucionit. <i>Evidence 169: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT maj 2022</i> <i>Evidence 67: Shembull Pyetësor_Vlerësim i studentëve për lëndet e programit të studimit formular</i> <i>Evidence 68: Shembull Pyetësor Vlerësim i studentëve për UMT formular</i> <i>Evidence 14. Shembull formulari i performances 2023.</i>

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	FSHMT përdor tregues të qartë, të matshëm në vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpërmjet plotësimit të formularit të performancës së stafit akademik dhe administrativ. Ky vlerësim bëhet nga përgjegjësit e departamenteve dhe përfshijnë vlerësimin për veprimtarinë akademike për çdo pedagog, vlerësimin e aktivitetit shkencor të stafit akademik nëpërmjet evidentimit të artikujve të botuar dhe prezantimeve orale kombëtare dhe ndërkombëtare, vlerësimin e aktivitetit administrativ të tyre, korrektësinë në kryerjen e dhe realizimin e shërbimeve ndaj studentëve, respektimin e afateve kohore të këtyre aktiviteteve dhe të rregullores së fakultetit. <i>Evidence 14: Shembull formulari i performances 2023</i> <i>Evidence 155: Shembull Vlerësimi i performances se stafit administrativ</i> <i>Evidence 27: Pyetësi i studentëve fshmt_23.</i> <i>Evidence 28: Rezultatet e pyetësorit të studentëve 2023</i>			
Konkluzione	– Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, standardeve të hapësirës evropiane të sigurimit të cilësisë, UMT ka ndërtuar politika dhe procedura si edhe ka ngritur struktura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UMT. – Njësia e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë është ngritur me vendim senati dhe funksionon si një strukturë e pavarur dhe e përhershme pranë institucionit duke ushtruar një sërë aktivitete bazuar në rregulloren e NJSBC. – Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrativ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor	Në funksion të akreditimit të programit të studimit të ciklit të dytë, FSHMT monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike ecurinë e

mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	programit duke përdorur mekanizma e procese formale të dokumentuara. Gjatë takimit me drejtues të institucionit dhe përfaqësues të NJSBC, GVJ konstatoi se FSHMT përdor disa mekanizma për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, si: – Monitorime të procesit mësimor nga përgjegjësit e departamenteve, të cilët në analizën vjetore evidentojnë arritjet, dobësitë dhe planin e masave për përmirësim. – Monitorime nga NJSBC në nivel institucional. – Realizim sondazhesh dhe mbledhje informacioni nga studentët nëpërmjet pyetësorëve. – Vlerësime dhe monitorime nga komisione ad/hoc të ngritur nga dekani si Njësia e Sigurimit të Cilësisë për FSHMT. – Nisja e procesit të përditësimit të programeve çdo fund viti akademik sipas udhëzimeve të MAS për rishikimin kurrikular rreth 20% nga Drejtoria e Administrimit Akademik dhe Kurrikulës së UMT. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se drejtuesi i departamentit të DRSHIKIOGJ me shkresë drejtuar dekanes së FSHMT nuk ka propozuar ndryshime në ciklin e dytë Master Shkencor në Teknik Laboratori, por vetëm disa ndryshime në ciklin e parë. Bazuar në shkresën zyrtare nr. 1123 Prot., të datës 09.09.2022 është <i>ri konfirmuar e pandryshuar kurrikula për ciklin e dytë Msc Teknik Laboratori.</i> <i>Evidence 84. Analiza vjetore 2021-2022 DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidence 85. Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidence 28. Rezultatet pyetesorit studentet_23.</i> <i>Evidence E6.2 Propozimet per ndryshim te planeve mesimore.</i> <i>Evidence 56. Procedura, afatet dhe dok. per hapjen e programeve te reja, riorganizimin dhe miratimin periodik te planeve</i> <i>Evidence 11. Praktike per miratimin e planeve mesimore.</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe	FSHMT, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore që është një përmbledhje e analizës së çdo departamenti dhe përfshin veprimtarinë akademike me rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, arritjet më të mira, mangësitë e mundshme dhe masat e marra për adresimin e tyre. NJSBC si strukturë përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë, analizon dhe vlerëson përputhshmërinë e programit të studimit me standardet shtetërore të cilësisë për programet dhe për

përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	institucionin. Bazuar në rezultatet e vlerësimit, NJSBC ka hartuar planin e masave për rritjen e cilësisë me strukturat përgjegjëse dhe afatet e realizimit. <i>Evidence 80. Raport vjetor FSHMT 2020-2021.</i> <i>Evidence 81. Raport vjetor FSHMT 2021-2022</i> <i>Evidence 82. Raporti vjetor FSHMT 2023.</i> <i>Evidence 84. Analiza vjetore 2021-2022 DDRSHIKIOGJ.</i> <i>Evidence 85. Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ</i> <i>Evidence 76: Plan veprimi 2021-2023 per Rritjen e Cilesise se Arsimit te Larte</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	UMT ka përdorur një sërë mekanizmash dhe metoda të drejtpërdrejta në kuadër të vlerësimit, realizimit dhe mbarëvajtjes të cilësisë së programit të studimit, si: përfshirja e studentëve në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit, procesi i vetëvlerësimit si një strategji për reflektim dhe përmirësim, iniciativa për rishikim të kurrikulave me qëllim përmirësimin e programit të studimit, procedura për monitorimin e dokumentacionit dhe sezonit të provimeve në kuadër të transparencës së vlerësimit për të identifikuar dhe minimizuar paragjykimet e mundshme gjatë këtij procesi. Nga ana tjetër departamentet e FSHMT analizojnë mbarëvajtjen e programit të studimit duke reflektuar vlerësimin e tij në raportin e analizës vjetore. Në analizën vjetore të FSHMT, në të cilin ofrohet programi Msc në Teknik laborator janë analizuar këto elementë: – Cilësia në mësimdhënie. – Transparenca në provime. – Veprimtaria shkencore dhe akademike e departamentit. – Kurrikulat dhe programet. – Strategjia e imazhit. – Detyrat për vitin e ardhshëm akademik. Gjithashtu institucioni disponon informacion mbi rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera, të cilat gjenden në tabelat përmbledhëse. <i>Evidence 28: Rezultatet e pyetesorit te studentëve 2023</i> <i>Evidence 67: Shembull Pyetesor_Vleresim i studentëve per lendet e programit te studimit_formular</i>

	<i>Evidence 169. Raporti i Vleresimit te Brendshem Institucional UMT</i> <i>Evidence 97. TABELA PERMBLEDHESE ASCAL Msc Teknik laborator.</i> <i>Evidence 109. Analize vjetore sekretaria mesimore.</i> <i>Evidence 85. Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGj.</i>
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Institucioni ka përdorur një numër instrumentash për të vlerësuar realizimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. GVJ e evidentoi këtë vlerësim nëpërmjet informacionit të përpunuar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni si edhe rezultatet e pyetësorëve të studentëve. Përmes kësaj zyre bëhet gjurmimi i studentëve të cilët kanë përfunduar këtë program studimi dhe evidentohen pozicionet e punësimit dhe kualifikimeve të mëtejshme. Njëkohësisht institucioni analizon rezultatet e pyetësorëve të studentëve me qëllim përmirësimin në vazhdimësi. Studentët kanë marrë pjesë në sondazhin kombëtar të studentëve të organizuar nga ASCAL në vitin 2022, i cili ishte një mekanizëm për matjen e kënaqshmërisë së studentëve në lidhje me cilësinë në arsimin e lartë. Në RVB theksohet se studentët gjithashtu plotësojnë një anketë dalëse pas diplomimit ose ndërprerjes së studimeve me qëllim përfshirjen e tyre në vlerësimin e stafit dhe përmirësimin e programeve të studimit. <i>Evidence 108. Aktivitete te Zyres se Karrieres FSHMT.</i> <i>Evidence E13. Punesimi dhe cilesia e studentëve.</i> <i>Evidence 108.1. Aktiviteti zyra e karrieres.</i> <i>Evidence 27: Pyetesori i studentëve ne FSHMT 23</i> <i>Evidence 67: Shembull Pyetesori Vleresim i studentëve per lendet e programit te studimit formular</i> <i>Evidence 68: Shembull Pyetesori Vleresim i studentëve per UMT formular</i>
Konkluzione	– FSHMT përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit. Disa nga instrumentet e përdorur janë vlerësimi i performancës së stafit akademik dhe ndihmës/akademik, pyetësorët e studentëve për vlerësimin e programeve dhe cilësisë në mësimdhënie, raporte dhe analiza vjetore në nivel departamenti dhe fakulteti, monitorime nga NJSBC në nivel institucional. – Drejtuesi i departamentit të DRSHIKIOGJ me shkresë drejtuar dekanes së FSHMT nuk ka propozuar ndryshime në ciklin e dytë

	<i>Msc në Teknik Laboratori dhe është ri konfirmuar e pandryshuar kurrikula për ciklin e dytë Msc në Teknik Laboratori.</i> <i>– Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit analizon në raportet vjetore rezultatet e procesit të anketimit të studentëve me qëllim përmirësimin e programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Ne statutin dhe rregulloren e UMT përshkruhet qartë përbërja e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që garanton përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Kjo strukturë përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 4 janë përfaqësues të personelit akademik me kohë të plotë nga çdo fakultet, 1 përfaqësues i rektoratit, 1 përfaqësues i Këshillit studentor të UMT dhe 1 ekspert i jashtëm. Mandati i anëtarëve është 4 vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje. Përfaqësimi i studentëve në këtë strukturë e bën efektive kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit. <i>Evidence 1: Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidence 2: Rregullore e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë</i> <i>Evidence 181. Rregullore e funksionimit NjSBC-UMT.</i> <i>Evidence 69. Perberja e NjSBC - VSA nr.103, dt.20.10.2020 ndryshuar.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton	Në rregulloret e UMT dhe FSHMT janë përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Disa nga aspektet që garantojnë sigurimin e cilësisë dhe ushtrimin e përgjegjësisë së aktorëve të përfshirë në këtë proces lidhen me: – Hartimin dhe përditësimin e një programi cilësor të përshtatshëm me kërkesat e tregut të punës.

ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	– Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës në funksion të cilësisë së programit të studimit. – Vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore. – Përcaktimin e procedurave të përshtatshme për monitorimin e cilësisë, vlerësimin e brendshëm në departamente dhe fakultete, zbatimin e detyrave nga auditi i jashtëm dhe hartimin e planit të masave. GVJ, gjatë takimit me përfaqësues dhe drejtues të veprimtarisë akademike në institucion si Dekani i FSHMT, drejtuesit e departamenteve, përfaqësues të stafit akademik, studentë, anëtarë të grupit të vetëvlerësimit, përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës, konstatoi se të gjithë këta aktorë kanë ushtruar me përgjegjësi detyrat e tyre duke bashkëpunuar, koordinuar dhe bashkëvepruar konform rregullave për të realizuar në mënyrë korrekte procesin e akreditimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Nga ana tjetër studentët referuan se janë të përfshirë përmes pyetësorëve, përfaqësuesve të tyre në këshillin studentor për adresimin e problematikave dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm duke dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e programit të studimit dhe sigurimin e cilësisë. <i>Evidence 169: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional UMT maj 2022</i> <i>Evidence 2. Rregullore-e-Universiteti të Mjekësisë Tirane.</i> <i>Evidence 5. Rregullore FSHMT.</i> <i>Evidence 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe ndjek një politikë të transparencës në lidhje me proceset e ndryshme të cilësisë duke rritur seriozitetin, besimin dhe përgjegjshmërinë e gjithësecilit në mbarëvajtjen e programit të studimit. NJSBC koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit me të gjitha njësitë bazë të institucionit. Në zbatim të rregullores, njësia bazë garanton përfshirjen e të gjitha strukturave përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentëve. <i>Evidence 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT.</i> <i>Evidence 79.1: Raport vjetor UMT 2021-22</i> <i>Evidence 81: Raport vjetor FSHMT 2021-2022</i>

	<i>Evidence 82: Raport vjetor FSHMT 2022-2023</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Procesi ciklik i vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës i cili është hartuar nga UMT në zbatim të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe realizohet në bashkëpunim mes KPSSC dhe NJSBC. Anëtarët e komisioneve të lartpërmendura përbëhen nga anëtarë të stafit akademik me eksperiencë dhe integritet, të cilëve u respektohet liria, etika akademike dhe kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. GVJ konstatoi se pyetësi i vlerësimit të programit të studimit është plotësuar duke respektuar anonimitetin dhe nuk janë referuar ankesa nga stafi apo studentët për pabarazi dhe diskriminim. <i>Evidence 172: Rregullore e funksionimit të Këshillit të Etikës – UMT</i> <i>Evidence 72: Kodi i Etikës-UMT</i> <i>Evidence 181: Rregullore e funksionimit NJSBC-UMT</i> <i>Evidence 21. Rregullore programi Bsc. Teknik Laboratori.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që lidhet me përbërjen e NJSBC, GVJ konstatoi se në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, institucioni ka përfshirë edhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Institucioni, për të rritur sigurimin e brendshëm të cilësisë, përdor komentet/sugjerimet/vërejtjet si nga studentët ashtu edhe nga personeli akademik por edhe reagime nga burime të jashtme si komunitetet profesionale, në të cilat janë punësuar të diplomuarit e UMT në funksion të përmirësimit të programit të studimit dhe lidhjes me kërkesat e tregut të punës. <i>Evidence 1: Statuti i Universitetit të Mjekësisë Tiranë</i> <i>Evidence 69. Perberja e NJSBC - VSA nr.103, dt.20.10.2020 ndryshuar.</i>
Konkluzione	– Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e UMT, është ngritur dhe funksion Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila përbëhet nga 7 anëtarë. Gjithë përfshirja, veçanërisht përfaqësimi i studentëve në këtë strukturë e bën efektive kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.

	– NJSBC koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit me të gjitha njësitë bazë të institucionit. – Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmangët çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. – Në procesin e vlerësimit dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, institucioni ka përfshirë edhe ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit të cilët japin ekspertizën e tyre në lidhje me përmirësimin e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UMT www.umed.edu.al. Gjithashtu, statuti i UMT, rregulloret, raportet vjetore, vendimet e organeve kolegjiale, raportimet periodike të rektoratit që lidhen me procesin mësimor dhe sigurimit të cilësisë së mësimdhënies, janë të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit. <i>Evidence 176: Rregullore-për-Hetimin-Administrativ-të-Sinjalizimit-dhe-Mbrojtjen-e-Konfidencialitetit-në-UMT</i> <i>Evidence 181: Rregullore e funksionimit NjsBC-UMT.</i> <i>Faqja e webit te UMT</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC realizon pyetësorët e studentëve dhe publikon rezultatet e tyre në kuadër të transparencës dhe duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale (ligji 9887/10.03.2008). Gjithashtu, FSHMT bën publike në faqen zyrtare të fakultetit (www.fshmt.edu.al) rezultatet e vlerësimit të programit të studimit. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm dhe adreson gjetjet apo rekomandimet e lëna në raportet repsektive.

	<i>Evidence 169: Raporti i Vleresimit te Brendshem Institucional _UMT</i> <i>Evidence 79: Raport vjetor UMT 2020-21</i> <i>Evidence 79.1: Raport vjetor UMT 2021-22</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	FSHMT harton planin e masave për përmbushjen e detyrimeve të lëna të cilat pasqyrohen në raportet vjetore. Gjithashtu, në kuadër të procesit të akreditimit institucional, rezultatet e këtij vlerësimi të brendshëm u raportohen rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve të cilëve u lihet për detyrë përmbushja e rekomandimeve të dala nga ky proces. <i>Evidence 80: Raport vjetor FSHMT 2020-2021</i> <i>Evidence 81: Raport vjetor FSHMT 2021-2022</i> <i>Evidence 82: Raport vjetor FSHMT 2022-2023</i> <i>Evidence E21. Praktike e auditimit te brendshem ne FSHMT.</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ evidentoi se raportet vjetore shoqërohen me plane masash ose adresim problematikash të cilat synojnë përmirësimin e mangësive të identifikuar me impakt rritjen e cilësisë së programit të studimit. <i>Evidence 80: Raport vjetor FSHMT 2020-2021</i> <i>Evidence 81: Raport vjetor FSHMT 2021-2022</i> <i>Evidence 82: Raport vjetor FSHMT 2022-2023</i> <i>Evidence E21. Praktike e auditimit te brendshem ne FSHMT.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Në takimin me përfaqësues të NJSBC, Zyrën e Karrierës dhe studentët, GVJ u informua se institucioni organizon aktivitete periodike me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Kjo reflektohet edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion ku jepen të dhëna për një sërë aktiviteteve të zyrës së karrierës dhe këshillit studentor. Gjithashtu, NJSBC dhe përfaqësuesi në FSHMT vazhdimisht organizon takime me strukturat e fakultetit për të rritur efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të saj. <i>Evidence 108: Aktivitete te zyres se karrieres FSHMT</i> <i>Evidence 124: Lista e aktiviteve Keshilli Studentor UMT_FSHMT</i>
Konkluzione	– Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e

	<i>studimit janë transparente dhe janë bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të UMT.</i> <i>– Në kuadër të procesit të akreditimit institucional, rezultatet e këtij vlerësimi të brendshëm u raportohen rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve të cilëve u lihet për detyrë përmbushja e rekomandimeve të dala nga ky proces.</i> <i>– Raportet vjetore të FSHMT shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</i> <i>– Institucioni organizon aktivitete periodike me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Teknik Laboratori” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Mjekësisë Tiranë.”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. UMT është një institucion i mirë konsoliduar që operon prej shumë vitesh në fushën e arsimit të lartë në Shqipëri, ku në përbërje të tij ka një staf akademik me përvojë dhe kualifikime të përshtatshme akademike dhe profesionale duke kontribuar ndjeshëm në fokusimin e aktiviteteve akademike në nevojat reale dhe zbatimin praktik të njohurive të përftuara në përgatitjen e gjeneratave të reja të profesionistëve në shkencat mjekësore.
2. Bashkëpunimet me një numër të konsiderueshëm institucionesh arsimore dhe shëndetësore, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, krijojnë mundësi për shkëmbime institucionale që mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të programit të studimit.
3. UMT inkurajon vazhdimisht avancimin profesional të stafit akademik përmes organizimit të konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mbështetjes financiare për aktivitete të ndryshme shkencore dhe trajnuese.
4. Krijimi dhe zbatimi i një sistemi të brendshëm të menaxhimit (LMS) në UMT u mundëson studentëve akses të menjëhershëm në programin e studimit, arritjet akademike dhe realizon një ndërveprim pozitiv me stafin akademik.

Pika të dobëta:

1. Mungon personeli efektiv i mjaftueshëm dhe me kualifikimet e nevojshme, duke mos përmbushur standardet e përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, sipas të cilave personeli akademik efektiv (PAE) duhet të përbëjë 70% të stafit të përgjithshëm, krahasuar me personelin e angazhuar me kontratë (PAK).
2. Bazuar në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, mungon pozicioni i Koordinatorit të Programit si strukturë, një rol ky që mbikëqyr zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e përcaktuara.
3. Mungon gjithashtu pozicioni i Përgjegjës të Grup-Lëndëve, i cili, sipas udhëzimeve të MAS, është i rëndësishëm për të ndihmuar në koordinimin efikas mes personelit me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, si dhe për kontrollin dhe miratimin periodik të syllabuseve, etj.



4. Nuk është realizuar përditësimi i syllabuseve me literaturën bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar, përfshirë tekste në gjuhën angleze të botuara nga shtëpi botuese prestigjioze dhe që datojnë brenda pesë viteve të fundit.

Rekomandime:

1. Institucioni të angazhohet në rekrutimin e personelit të ri efektiv me kualifikimet e nevojshme, për të përmbushur standardin e kërkuar nga MAS, sipas të cilit personeli akademik efektiv (PAE) duhet të përbëjë të paktën 70% të stafit të përgjithshëm, krahasuar me personelin me kontratë (PAK) (*Aktualisht, për vitin akademik 2023-2024, ky raport është 29% PAE dhe 71% PAK*).
2. Rishikimi i shpërndarjes së lëndëve dhe moduleve sipas kategorive përkatëse në përputhje me përqindjet e lejuara në VKM Nr. 41, datë 21.01.2018, ku është konstatuar se:
 - *Kategoria A (Lëndë Bazë) ka një tejkalim të krediteve nga 5%-10% (1 ECTS).*
 - *Kategoria C (Lëndë Ndërdisiplinore) nuk arrin minimumin e krediteve 12%-20% (4 ECTS).*
3. Programi, dokumentacioni dhe syllabuset duhet të përgatiten edhe në gjuhën angleze, duke lehtësuar kështu transferimin e studentëve dhe duke ndihmuar në përdorimin e literaturës ndërkombëtare në fushën e diagnostikës laboratorike.
4. Institucioni të caktojë si elemente të rëndësishëm “Përgjegjësin e Grup-Lëndëve” dhe “Koordinatorin e Programit”, role që do të ndihmojnë në konsultimin periodik të syllabuseve, koordinimin efikas të personelit dhe mbikëqyrjen e ecurisë së programit të studimit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat.
5. Institucioni të hartojë një udhëzues për unifikimin e veprimtarive akademike në nivel institucional si edhe të procesit të vlerësimit me të gjithë komponentët e domosdoshëm të vlerësimit duke siguruar kontroll të vazhdueshëm të njohurive dhe mundësinë për studentët që të identifikojnë dhe plotësojnë mangësitë përpara përfundimit të semestrit.
6. Institucioni të hartojë një dokument periodik analitik për vlerësimin e përfitimeve nga zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit.
7. Institucioni në të ardhmen të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës laboratorike të avancuar, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe inovacionet bashkëkohore për lëndët profesionale, ose të sigurojë këtë përmes marrëveshjeve të veçanta të bashkëpunimit.
8. Krijimi i Bordit të Tregut të Punës ose i Strukturave të tjera të ngjashme, të cilat do të luanin një rol kontribues të rëndësishëm në këshillimin për karrierën të studentëve edhe për propozime të përmirësimeve në kurrikulë.

9. Përditësimi i syllabuseve me literaturën bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar (rekomandohet përfshirja e dy teksteve), me botime të pesë viteve të fundit në gjuhën angleze nga shtëpi botuese të njohura, duke e cituar literaturën si referencë bibliografike. Ndërkohë institucioni të pasurojë fondin fizik e online të bibliotekës në funksion të përshtatjes së programit me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e studimeve të ciklit të dytë.
10. Nxitja e aplikimit nga personeli akademik dhe studentët për të marrë pjesë në mobilitete dhe projekte kombëtare e ndërkombëtare, si Erasmus+ KA1.

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in "Laboratory Technique" provided by the Higher Education Institution "University of Medicine Tirana".

Strengths and affirmations:

1. UMT is a well-established institution that has been operating for many years in the field of higher education in Albania, where it has an academic staff with experience and appropriate academic and professional qualifications, contributing significantly to the focus of academic activities on real needs and the practical application of knowledge acquired in the preparation of new generations of professionals in medical sciences.
2. Collaborations with a significant number of educational and health institutions, both within the country and abroad, create opportunities for institutional exchanges that support the further development of the study program.
3. UMT continuously encourages the professional advancement of academic staff through the organization of national and international scientific conferences, as well as financial support for various scientific and training activities.
4. The creation and implementation of an internal management system (LMS) at UMT provides students with immediate access to the study program, academic achievements and achieves a positive interaction with academic staff.

Weaknesses:


1. There is a lack of sufficient effective personnel with the necessary qualifications, failing to meet the standards set by the Ministry of Education and Sports, according to which effective academic staff (APE) should constitute 70% of the total staff compared to the engaged personnel by contract (APC).



2. Based on the instructions of the Ministry of Education and Sports, the position of Program Coordinator as a structure is missing, a role that oversees the development and progress of the study program and professional practices in accordance with the established objectives.
3. There is also a lack of a position of Head of Group-Subjects, which, according to the instructions of the MAS, is important to assist in efficient coordination between full-time and part-time staff, as well as for periodic control and approval of syllabuses, etc.
4. The syllabuses have not been updated with the basic mandatory and recommended literature, including texts in English published by prestigious publishing houses and dating back to the last five years.

Recommendation:

1. The institution should engage in recruiting new effective staff with the necessary qualifications, to meet the standard required by the Ministry of Education, according to which effective academic staff (APE) should constitute at least 70% of the total staff, compared to contract staff (APC) (*Currently, for the academic year 2023-2024, this ratio is 29% APE and 71% APC*).
2. Review the distribution of subjects and modules according to the relevant categories in accordance with the percentages allowed in the Council of Ministers No. 41, dated 21.01.2018, where it was found that:
 - Category A (Core Subject) has an excess of credits of 5%-10% (1 ECTS).
 - Category C (Interdisciplinary Subject) does not reach the minimum of credits of 12%-20% (4 ECTS).
3. The program, documentation and syllabuses should also be prepared in English, thus facilitating the transfer of students and assisting in the use of international literature in the field of laboratory diagnostics.
4. The institution should designate as important elements the "Subject Group Leader" and the "Program Coordinator", roles that will assist in the periodic consultation of syllabuses, efficient coordination of personnel and supervision of the progress of the study program and professional practices in accordance with the objectives.
5. The institution should draft a guideline for the unification of academic activities at the institutional level as well as the assessment process with all necessary assessment components, ensuring continuous control of knowledge and the opportunity for students to identify and fill in gaps before the end of the semester.
6. The institution should draft a periodic analytical document for the assessment of the benefits from the implementation of cooperation agreements.



7. The institution should focus in the future on improving the advanced laboratory infrastructure, in line with technological developments and contemporary innovations for professional subjects or ensure this through special cooperation agreements.
8. Creation of the Labor Market Board or other similar structures, which would play an important contributing role in advising students on their careers and proposing improvements to the curriculum.
9. Updating the syllabus with the basic mandatory and recommended literature (the inclusion of two texts is recommended), with publications of the last five years in English from well-known publishing houses, citing the literature as a bibliographic reference. Meanwhile, the institution should enrich the physical and online library funds to adapt the program to the demands of the labor market and the standards of second-cycle studies.
10. Encouraging applications from academic staff and students to participate in national and international mobilities and projects, such as Erasmus+ KA1.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

